



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni ad hoc me 6 anëtarë për përzgjedhjen e kandidatëve për krijimin e institucioneve të rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.06.2017, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Vasilika Hysi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 25 maj.
2. Miratimi i kalendarit për zhvillimin e seancës/ave dëgjimore publike me kandidatët e listës për votim që konkurrojnë për Kolegjin e Apelimit, të përcjellë nga Komisioni *ad hoc* për Verifikimin e Kandidatëve”.

Marrin pjesë:

Vasilika Hysi, Eduard Halimi, Flamur Noka, Ervin Bushati, Vangjel Tavo dhe Albana Vokshi.

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi- Përshëndetje!

Sot zhvillohet mbledhja e dytë e komisionit *ad hoc* me 6 anëtarë për përzgjedhjen e kandidatëve për krijimin e institucionit të rivlerësimit sipas ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Rendi i ditës ka dy çështje. E para, është miratimi i procesverbalit të datës 25 maj. E kemi dërguar me *e-mail*. Kush është dakord?

Miratohet.

E dyta, është miratimi i kalendarit për zhvillimin e seancave dëgjimore publike me kandidatët për listën për votim që konkurrojnë për Kolegjin e Apelit që ka përcjellë komisioni *ad hoc* i verifikimit të kandidatëve.

Në konsultim edhe me nënkryetarin e komisionit, zotin Halimi, me qëllim që të mos i lëmë kandidatët të presin gjatë, një pjesë prej tyre kanë qenë edhe në intervistat që zhvilloi komisioni i përzgjedhjes, seanca dëgjimore me ta sugjerohet të jetë sot në orën 11.00. Ndërkohë stafi, sekretariati teknik i komisionit i përbërë nga këshilltarët që janë të ulur krahas nesh ka bërë të gjitha njoftimet e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret formale dhe që konkurrojnë për Kolegjin e Apelit.

Ju keni marrë një listë të komisionit *ad hoc* për verifikimin e kandidatëve, lista përbëhet nga 68 anëtarë, jo të gjithë kandidatët janë kandidatë për Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Nga kjo listë stafi i Kuvendit ka nxjerrë në një listë të posaçme të gjithë kandidatët që kanë konkurruar vetëm për Kolegjin e Posaçëm të Apelit ose që kanë konkurruar për të tria pozicionet.

Numri i kandidatëve që konkurrojnë për Kolegjin e Apelit është 34, nga të cilët kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre 32, ndërkohë që 1 person ndodhet në SHBA dhe nuk ka mundësi të paraqitet. Personi i dytë nuk i është përgjigjur telefonatës, ose telefoni del i fikur, ndërkohë që ka edhe njoftimin me *e-mail*. Urojmë dhe shpresojmë që të jetë në orën 11:00. Jeni dakord me zhvillimin e seancës dëgjimore publike me kandidatët në orën 11:00? Kundër? Nuk ka. Dakord.

Faleminderit!

Lidhur me procedurën në këtë fazë para se të fillojmë pjesën e seancave dëgjimore do të doja të sillja në vëmendjen tuaj, se secilit prej jush i është lënë në dispozicion dosja e çdo kandidati, ku do të gjeni të gjithë dokumentacionin që kandidati ka aplikuar, shkresën përcjellëse të institucionit të Avokatit të Popullit. Do të doja të sillja në vëmendjen tuaj që në

vlerësimin që bën komisioni ynë do të ketë parasysh disa kritere, të cilat janë të përcaktuara në nenin 6 të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por njëkohësisht, do të kemi parasysh edhe nenin, germën “c” të Kushtetutës ku flet për kriteret e përgjithshme. Pra, kriteret e përgjithshme i kemi te Kushtetuta, ndërsa kriteret më specifike janë në ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Krahas kritereve formale juridike ligji kërkon të mbajmë në konsideratë titujt shkencorë në fushën e së drejtës, përvojën e veçantë të kandidatit në sfera të caktuara të së drejtës, si në profesion, përvojën studimore dhe profesionale jashtë shtetit shqiptar, notën mesatare jo më pak se 8, kur ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve. Të gjitha këto në harmoni edhe me kërkesat e tjera që i ka Kushtetuta dhe ligji. Në një dosje nga sekretaria e komisionit ju është vënë në mënyrë të përmbledhur edhe CV-ja e çdo personi, por edhe të gjithë informacionin e detajuar nëpër dosjet që keni pranë zyrave tuaja. Keni ndonjë pyetje?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Në fakt, kemi ndjekur edhe mbledhjen e mëparshme të komisionit, që do të bënte vlerësimin e kandidaturave. Është një proces shumë i rëndësishëm ai i seancave dëgjimore sot dhe më pas ai i përzgjedhjes, misioni që ka ky komision, pasi qytetarët duhet të marrin ata kandidatë dhe ata anëtarë të komisionit të vetingut, të cilët të kenë integritet dhe besimin e publikut. Ky është një proces shumë i rëndësishëm, pavarësisht se ne jemi krahë të ndryshëm politikë dhe do na duhet të përzgjedhim nga ajo listë, është shumë e rëndësishme që t’u themi qytetarëve se zgjodhëm ata njerëz, të cilët përmbushnin jo vetëm kriteret formale, që janë juristë me këtë, apo me atë mesatare, por të kenë edhe besimin e publikut, do të thotë që të mos kenë pasur në të kaluarën përfshirje politike, në çështjet politike, të mos jenë bërë objekt i debateve politike në mënyrë që të mos thonë nesër: “As Partia Socialiste, as Partia Demokratike dhe as Lëvizja Socialiste për Integrim të kapin drejtësinë”. Duke pasur parasysh edhe qëndrimin e komisionit, do të çmoj që ata kandidatë, të cilët kanë qenë të përfshirë në procese politike do të ishte mirë të mos ishin fare në seancën dëgjimore.

Zotit Ndoka do të doja t’ia jepja fjalën për të shprehur edhe një herë qëndrimin e atij komisioni, pasi do të ishte shumë e udhës që komisioni i mëparshëm të kishte bërë një përzgjedhje, Partia Socialiste mund të kishte thënë që: “Këta tre personave që janë në listë nuk kanë besimin publik për të qenë, sepse mund të kenë pasur afilacion me Partinë Demokratike, me LSI-në” apo edhe ne mund të kishim bërë të njëjtën gjë, në mënyrë që të krijojmë besimin publik, sepse as ne nuk duam të shikojmë njerëz, të cilët janë të afilacionit

politik të Partisë Demokratike, as ju nuk duhet të çoni në atë komision njerëz që janë të afilacionit politik të PS-së dhe as të LSI-së. Nëse do të kishin bërë këtë proces, do të ishte mirë që të përzgjidheshin një grup kandidatësh, që të kishin ruajtur kriteret formale, por të mos kishin afilacion as me PD-në, as me PS-në, as me LSI-në. T'u themi qytetarëve që këta 27 vetë nuk janë as të njëjës palë dhe as të palës tjetër.

Zoti Noka ka qenë në atë komision, e ka ndjekur, sepse unë e kam ndjekur vetëm nëpërmjet medias.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Halimi!

Po, zoti Noka.

Flamur Noka - Faleminderit, zonja kryetare!

Siç e kemi bërë me dije ky proces ka rezultuar fatkeqësisht i përçudnuar. Ky është një proces për drejtësinë, i cili mund të konsiderohet jetik dhe ndihemi shumë keq që pa filluar mirë është përçudnuar nga ana e maxhorancës dhe e Kryeministrit Rama. Arsyeja është shumë e thjeshtë. Ajo që kemi bërë publike disa ditë më parë në Komisionin e Verifikimit, po të shikoni tërësinë e listës së aplikantëve, të aspirantëve, të cilët presupozohet se do të bëjnë vetingun e të gjithë sistemit gjyqësor, do të bëjnë vetingun edhe profesional të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe anëtarëve të Gjykatës së Lartë, presupozohet se këta duhet të ishin një nivel shumë i lartë i përgatitjes profesionale, por po them se shumica e tyre janë në nivel nën mesataren. E kam thënë dhe vazhdoj ta them, i kam parë emër për emër, i kam studiuar emër për emër gjatë kësaj periudhe, sepse kam qenë në të dyja komisionet: edhe në Komisionin e Rivlerësimit edhe në komisionin e sotëm, jam konsultuar me specialistë emër për emër për të kontrolluar CV-të, dosjet e tyre, niveli është i mjerueshëm, ka vetëm një standard që është standard i aplikuar nga maxhoranca: 99% e listës janë nivel mjeran për të kaluar në sitë nivelin profesional të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që vetëm një 1% mund të kenë kritere profesionale, por që janë të ngarkuar maksimalisht politikisht si anëtarë, militantë aktivistë të Partisë Socialiste.

Më vjen keq të bëj parashikimin, nuk jam këtu për të bërë profetin, por po ju them: Edi Rama nëpërmjet Avokatit të Popullit me këtë listë që na ka paraqitur sot ka paracaktuar gjithçka. Produkti që do të votojë treshja e maxhorancës është ky: Albana Shtylla, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e propozuar nga Partia Socialiste. Mbajeni mend, do të jetë fituese! Ina Rama, prokurore politike, njeri i afërt i Edi Ramës dhe e Partisë Socialiste që nuk lënë vend ku hapet një konkurs pa e futur si fanti spathi, aq është dashuria e madhe e PS-së dhe Edi Ramës për Ina Ramën, Sokol Çomo, ish-zëvendësministër i PS-së. Po e them sot,

ditën që do të votojë ky komision, kjo është treshja që do të përzgjidhet nga maxhoranca. Këta do të bëjnë vetingun e sistemit të drejtësisë. E paracaktuar që ditën e parë që kanë filluar aplikimet tek Avokati i Popullit. Jua përsëris: mos e merrni si profeci, por merreni si një gjë që do të dalë, sepse është e vërtetë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati- Faleminderit!

Më vjen keq që po e nisim me një paragjykim një proces kaq të rëndësishëm, aq me tepër kur në 99% e 34-rës, nuk e di pastaj 1% sa i bie, i bie që asnjë nuk është, sepse nuk ka 1% 34-ra, aq më tepër që po paragjykojmë qytetarë të ndershëm, të ndërgjegjshëm që kanë ardhur, janë paraqitur, kanë dhënë në këtë tavolinë CV-të e tyre personalitetin, integritetin e tyre dhe t'i paragjykojmë sot në këtë mënyrë, aq më tepër kur janë njerëz që kanë kaluar ndoshta edhe më parë sitën e PD-së, duke iu vënë epitete nga më të ndryshme, qoftë nga fusha e shkencës, e artit, e filmave dhe të gjithë kronologjisë, etnologjisë dhe folklorit artistik që ka mundur kryetari i vërtetë i PD-së, zoti Sali Berisha. Pra, më vjen keq që fillojmë me një proces, i cili paragjykohet në këtë mënyrë nga PD-ja. Për më tepër nuk është mirë që ne në rolin e ligjvënësit dhe të një procesi kaq të rëndësishëm ku na shikojnë, na ndjekin të gjithë qytetarët të paragjykojmë njerëz profesionistë që kanë CV shumë të mira, që janë paraqitur, që duan të shikojnë ndryshime në sistemin e drejtësisë së Shqipërisë. Janë njerëz idealistë, kanë ardhur duke e ditur se edhe mund të përbalten nga politika, dhe kjo ka ndodhur, sepse që kur ka nisur ky proces në fillim, PD-ja është përpjekur të ndikojë sa më shumë në proces, që të ulë pjesëmarrjen, e kanë bërë këtë gjë që në fillim, duke i dekurajuar qytetarët shqiptarë, duke dekurajuar shqiptarët e ndershëm, sepse çdo njeri që e dinte se do të hynte pastaj në gojën e politikës do të vihej në pikëpyetje, në dyshim integriteti moral, qytetar, profesional, kur ne nuk jemi këtu as trupë gjyqësore. Nuk e di se mund të ketë gjyqe morale, ndoshta mund të ketë pasur në kohën e Enver Hoxhës dhe mund të ketë reminishenca sot këtu, pasi ne nuk kemi të drejtë të flasim për njerëz të cilët do të vijnë, do të intervistohen. Ju keni shumë të drejtë t'u bëni të gjitha pyetjet që keni për ta, por t'i marrim sot në një gjyq të hapur popullor moral si në kohën e Enverit, para kamerave dhe të themi pa ardhur, pa u paraqitur, pa i dëgjuar : këta janë njerëz që i përkasin një force apo një force tjetër politike, duhet të kemi parasysh se në Shqipëri votojnë të gjithë qytetarët shqiptarë, një herë votojnë për një forcë, një herë për një forcë tjetër, pra të gjithë janë qytetarë me bindje politike, vota është politike, në momentin që voton ke një bindje, për këtë ose për atë. Vota ndryshon, keni qenë ju në pushtet, jemi ne, do të vazhdojmë të jemi ne në pushtet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E shikon si paragjykon? Pse paragjykon?

Më lejoni ta mbaroj, sepse nuk ju ndërpreva!

Të mos jemi të ngutur si në këtë rast dhe të presim procesin të shkojë mirë. Më vjen keq, por që në fillim PD-ja është përpjekur ta ulë shumë grupin e njerëzve që mund të aplikonin, duke thënë që në fillim, duke bërë kokën e dashit, ndaj një trupe shumë të nderuar profesionale qytetarësh shqiptarë, të cilët me idealizëm duan që më në fund të shikojnë reformën në drejtësi. Janë afruar që në fillim duke e ditur edhe baltën që do të mbanin mbi supe, nën supe, në të gjitha krahët nga politika. Nuk e meritojnë, sepse janë ata që nesër do të bëjnë sistemin e drejtësisë, janë ata që e duan sistemin e drejtësisë, janë ata që në fund fare që janë votuesit dhe taksapaguesit që ne na mbajnë në punë dhe na kanë vendosur këtu, jo pse jemi më të mirët dhe më të zgjuarit, por, sepse këto janë detyrat dhe t'i paragjykojmë sot pa ardhur, pa i dëgjuar fare dhe të flasim me terma, që në mendimin tim unë i mbaj mend nga diktatura: “të përçudnuara”, “të përdhunuara”.

Më vjen keq që PD-ka ka sot këtë retorikë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Po, zoti Noka.

Flamur Noka – Zoti Bushati, faleminderit!

Unë nuk dua të bëj replikë apo debat me ty, për arsye, se nuk të vë faj, sepse nuk e di ti se çfarë kemi bërë në komisionin tjetër, ti nuk ke qenë, sot po vjen në komision. Unë që flas kështu, së bashku me zonjën kryetare kemi bërë seanca dëgjimore, mbledhje pas mbledhje në një komision tjetër, dhe të gjitha CV-të e 67 pretendentëve të kualifikuar nga Avokati i Popullit, duke përfshirë edhe trefishin e tyre, që janë skualifikuar, ne i kemi kaluar një për një, i kemi parë një për një dhe i kemi marrë në pyetje një për një, i kemi dëgjuar në seanca dëgjimore një për një.

Pra, ty nuk të fajësoj, sepse është seanca e parë dhe nuk i njeh, ndërsa ne i kemi parë. E kam thënë dhe po e përsëris: duke përjashtuar militantët e partisë tuaj, se po e them këtu, të kualifikuar pranë Avokatit të Popullit keni edhe anëtarë të asamblesë së Partisë Socialiste, në listën 67- she. Mos shih ato 20 a 30 sepse janë 67. Pra, ka anëtarë të asamblesë.

Ne si opozitë, nuk mund të rrimë pa bërë transparencën e një procesi e pastaj dhe të listës. Sa i takon transparencës së procesit, janë marrë në telefon 99 % e personave që kanë aplikuar, janë marrë në telefon dhe janë porositur nga njerëz pranë partisë tuaj që të shikojnë e të aplikojnë. Janë marrë me porosi, po them.

E dyta, unë bëra një përjashtim. Bëra edhe një profeci, që uroj të mos më dalë, se unë nuk jam profet, por kam frikë se do të më dalë. kam frikë se ti do të votosh njërin nga këto të tre që thashë. Dhe do ta votosh me urdhër politik, pavarësisht se mund të mos duash.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është ajo që them unë, ndaj uroj që të mos dalë profecia ime. Ama po ju them edhe një gjë tjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja ku e keni kryetarin e komisionit, i cili ka qenë bashkë me mua në komisionin tjetër, ku kemi bërë seancat dëgjimore me të gjithë.

Zonja kryetare, a mendoni se 99 % e asaj liste është në gjendje të kontrollojë, të bëjë vetingun e të gjitha dosjeve të Gjykatës Kushtetuese, në aspektin profesional? Unë kam thënë një gjë dhe vazhdoj ta them: përbërja e pretendentëve për të bërë vetingun është e tillë, shumica e emrave që kanë aplikuar janë në një nivel... Unë nuk dua të hyj në integritetin personal i askujt, sepse as nuk më lejohet e as nuk ia lejoj vetes, ama për sa kohë ata do të bëjnë veting, në integritetin personal do t'i hyjmë çdonjërit.

Po t'i shohësh dosjet personale, zoti Bushati, flasin për formimet profesionale të çdonjërit nga pretendentët. Po ju them se, shumica e atyre që pretendojnë të bëjnë vetingun, janë njëlloj si të marr një infermiere që ka mbaruar dikur kursin e infermierisë me katërmujor, se dikur kështu ka qenë, pra të marrësh një infermiere që ka mbaruar kursin katërmujor të infermierisë, ta sjellësh në Tiranë që t'i bëjë veting profesional Profesor doktorë në shkencat e mjekësisë. Është njëlloj si të marrësh një nga ata pretendentët që keni futur ju në kualifikim, për t'u bërë veting profesional anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese e atyre të Gjykatës së Lartë.

Kjo është gjendja në të cilën e keni katandisur ju drejtësinë, e që ju e quani si drejtësia e re, që po pret Kryeministri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, absolutisht që jemi dakord t'i shqyrtojmë prapë, por unë dhe Vasilika i kemi parë të gjitha. Shpresoj dhe uroj që ju, zoti Bushati, të mos votoni njërin nga këta, ose Albana Shtyllën, ose Ina Ramën, ose Sokol Çomon, sepse i keni të ndarë: njërin ti, njërin zonja. I keni të ndarë. Ky është produkti që doni të na nxirrni ju. Ju falënderoj. Uroj që të mos dalë kështu.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Flamur Noka – Dhe pasi të nxirrni këtë produkt, më thoni a kemi pasur të drejtë ne si opozitë, kur kemi thënë se gjithçka që po bëhet, po bëhet për ta kapur drejtësinë Edi Rama.

Po doli kjo treshe, profecia e opozitës është absolute që ka dalë. Pse? Sepse kapje e drejtësisë është kjo. Në rast se s'dalin këta të tre, opozita e ka gabim dhe ju kërkon falje.

Kaq kisha.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Noka!

Unë ju ndoqa, dhe është e vërtetë që ne, së bashku, kemi qenë edhe në Komisionin e Verifikimit të Kritereve të kandidatëve, por do të doja ta bëja të qartë të gjithë publikut, nëpërmjet kolegëve të nderuar të medias, atyre që na ndjekin, se lista që ne kemi...

(Deputeti Noka ndërhyr pa mikrofon)

Më fal të mbaroj, të lutem!

Flamur Noka – Jo, nuk dua të të korrigjoj, por nuk kemi kolegë të medias këtu.

Vasilika Hysi – Përfaqësues të medias.

Flamur Noka – Po, përfaqësues të medias.

Vasilika Hysi – Ju nuk jeni koleg i tyre, por unë kam punuar me ta.

Flamur Noka – Vetëm nëse ke punuar si gazetar, se për të punuar me gazetarët kemi punuar të gjithë, por gazetarë s'ke punuar ndonjëherë.

Vasilika Hysi – Më fal, lista që ne kemi marrë si Komision i Verifikimit, është listë e ndërtuar në bazë të një konkurrimi të lirë të kandidatëve që plotësonin kriteret e përcaktuara në Kushtetutë, dhe kriteret në Kushtetutë i kemi përcaktuar së bashku. Në qoftë se sot ju nuk e mbani mend që më datën 22 korrik Kushtetuta mori edhe votën tuaj, 140 vota, pra edhe këto kritere kanë marrë 140 vota...

Flamur Noka – Jemi shumë të lumtur që kemi marrë pjesë në atë proces dhe që kemi votuar më 22 korrik.

Vasilika Hysi – Atëherë me 140 vota, ne vendosëm që aplikimi i kandidatëve do të bëhet te Presidenti, ose nëse Presidenti nuk e ushtron kompetencën e tij, tek Avokati i Popullit, edhe për këtë me 140 vota.

Vlerësimin e kritereve juridiko-kushtetuese, përsëri me Kushtetutë ia lamë ta bënte ose Presidenti ose Avokati i Popullit, dhe e bëri Avokati i Popullit. Po me Kushtetutë, thamë se, meqenëse qytetarët dhe kandidatët në përgjithësi, nuk kanë besim te politika, e kanë të drejtë të mos kenë besim te politika, atëherë thamë se do të sjellim...

Flamur Noka – Thua ti...

Vasilika Hysi –... se do të sjellim një mision, operacion ndërkombëtar të monitorimit...

Flamur Noka – O zonja kryetare...

Vasilika Hysi –... dhe operacioni ndërkombëtar i monitorimit...

(Deputeti Noka ndërhyt pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Më lerë të mbaroj...

Flamur Noka – Kur thua se qytetarët kanë të drejtë të mos besojnë të politika, dhe ti je e bindur për këtë, jep dorëheqjen nga politika, sepse s'je për politikë.

Vasilika Hysi – Të lutem, a të mbaroj unë, e pastaj mund të merrni fjalën?

Flamur Noka – Po sulmon vetveten. E kupton se kësaj i thonë të bësh vetëvrasje pa dashje.

Vasilika Hysi – Në rregull!

Flamur Noka – Mos bëj vetëvrasje pa dashje.

Vasilika Hysi – Ne në këtë Komision të Ligjeve nuk e kemi këtë lloj komunikimi, që kur flet një anëtar, aq më tepër kryetari, të ndërhyjë anëtar. Të lutem!

Flamur Noka – Më fal, ke të drejtë, por këtu nuk jemi në Komisionin e Ligjeve, sepse po vazhdon për inerci dhe të duket vetja sikur je në Komisionin e Ligjeve.

Vasilika Hysi – Epo, ky komision...

Flamur Noka – Zonja kryetare, nuk jemi në Komisionin e Ligjeve. Më lejo të të korrigjoj: nuk jemi në Komisionin e Ligjeve. Unë e kuptoj se të ka ngelur për inerci, por nuk jemi në Komisionin e Ligjeve.

Vasilika Hysi – Tashti, të lutem! Pra, në nenin B të Kushtetutës kërkuam të kemi asistencën e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. I gjithë ai proces që është kryer nga Avokati i Popullit, është bërë edhe me rekomandimin dhe mbikëqyrjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i cili ka dhënë rekomandimin dhe listën përkatëse.

Sa u takon kriterëve që ju përmendni, në lidhje me listën që Komisioni i Përzgjedhjes i paraqet komisionit tonë, ne kemi të drejtë që, në atë listë me 34 kandidatë, pasi t'i dëgjojmë me respekt, t'u bëjmë çdo lloj pyetjeje, për të krijuar bindjen se cilët janë kandidatët më të mirë, që të zgjedhim shtatë anëtarët dhe t'ia referojmë seancën për votim.

Prandaj do ta quaja të panevojshme që sot, pa dëgjuar kandidatët dhe pa i dhënë mundësi kolegët e tjerë, pra të respektojmë kolegët e tjerë, që nuk kanë pasur mundësi të dëgjojnë, që ta krijojnë vetë bindjen e tyre të brendshme, e jo për shkak të asaj që thoni ju dhe unë.

Nga ana tjetër, unë do të doja të theksoja se ne duhet të krijojmë besim te njerëzit, që ata të konkurrojnë e të kandidojnë. Me aq shumë zhurmë sa u bë për këto komisione dhe për shkak të formulës që u vendos në fund, për të pasur një përzgjedhje nga një komision i përbërë nga maxhoranca dhe opozita, padyshim që duhet të kemi pasur frenim të kandidatëve. Unë përsëri i vlerësoj, dhe po e them këtë edhe përpara se kandidatët të vijnë, i

vlerësoj jashtëzakonisht shumë që konkurruan, u paraqitën dhe paraqiten. Në të gjashtë këtu duhet të jemi shumë korrektë me ta, t'i respektojmë, t'i dëgjojmë, t'i vlerësojmë. Pa dyshim që nuk do të zgjidhen të gjithë, po për mua, dhe besoj se edhe ju e ndani këtë mendim, ne kemi pasur kandidatë që kanë studiuar jashtë dhe kanë ardhur me besimin për të kontribuar në bërjen e reformës në drejtësi.

A do të jenë vetëm këta që do ta bëjnë reformën? reforma në drejtësi nuk është vetëm rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve e prokurorëve. Reforma në drejtësi është tërësore, është tërësia e mekanizmave që ne po ngremë për të ndryshuar mënyrën se si organizohet dhe funksionon drejtësia, pa harruar dhe kulturën, mentalitetin e njerëzve.

Nuk është vetëm rivlerësimi kalimtar ai që do të luftojë korrupsionin, që do të rrisë eficiencën dhe do të bëjë një gjyqsor të pavarur. Të paktën ne të gjashtë këtu do të kontribuojmë dhe duhet ta vlerësojmë faktin e Kuvendi ka na dhënë besimin, që na beson në emër të 134 të tjerëve për të bërë përzgjedhjen dhe votimin e kandidatëve më të mirë.

Ne kishim mundësi, zoti Noka, ju dhe unë, nuk flas për kolegët e tjerë, që në Komisionin e Përzgjedhjes, me katër vota të kalonim nga lista e kandidatëve që nuk plotësonin kriteret formale nën gjykimin e Avokatit të Popullit, kandidaturat që ne do t'i gjykonim më të mirat. Unë e ushtrova këtë të drejtë për një kandidat. Nëse ju s'do të ishit larguar dhe të kishim vazhduar, kjo listë do të pasurohej me kandidatë të tjerë, që në gjykimin e atij komisioni, nëse do të merrnin katër vota mund të kalonin. Besoj se këtu biem dakord.

Gjë tjetër që do të doja të theksoja: aty ka figura që kanë kontribuar në sistemin e drejtësisë, dhe që pa dyshim që do të vijnë nga sistemi i drejtësisë. E kemi kërkuar vetë, të nderuar kolegë. Në Kushtetutë, te neni C kemi vënë si kriter që kandidatët duhet të kenë të paktën 15 vjet përvojë si gjyqtarë, si prokurorë, avokatë, noterë, profesorë, juristë në fushën e së drejtës, me kontribute brenda dhe jashtë vendit.

Atëherë, në rast se në Kushtetutë thamë se duhet të kenë jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet përvojë gjyqtarë e prokurorë, ku do ta bënin përvojën? Patjetër që në gjyqsor. A ka kandidatë të rinj? Padyshim që ka. Unë e vlerësoj faktin e shumë kandidatë të rinj, që kanë studiuar jashtë, kanë konkurruar për të tre pozicionet. Pra, nëse ne si komision nuk i votojmë në Kolegjin e Apelit, ata kanë një mundësi të konkurrojnë dhe të përzgjidhen në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si komisionerë publikë apo si anëtarë zëvendësues.

Kjo është për t'u vlerësuar dhe ne duhet t'i inkurajojmë. Ne duhet të përcjellim mesazhe, ndaj unë kam bindjen se ju, brenda vetes suaj, pavarësisht se çfarë thoni mediatikisht, jeni të mendimit se duhet të sjellim këtu kandidatët më të mirë, siç tha kolegu Halimi. Duhet të sjellim më të mirët. A kemi mundësi të zgjedhim shtatë më të mirët, më të

mirët e më të mirëve, për të rikthyer besimin e publikut te drejtësia, e të mos thonë se ky komision bëri këtë lloj përzgjedhjeje? Do të doja shumë që njerëzit të mos i përgojmë, të mos i paragjykojmë, sepse ne do të kemi mundësi të zgjedhim institucione të tjera këtu, dhe ata me të drejtë do të thonë: “Po ju, kush jeni, që na gjykoni?”. Kanë kontribuar në drejtësi, në prokurori, janë noterë, profesorë të nderuar në fushën e së drejtës.

Prandaj, për ta mbyllur, do të doja që ne, si komision, të garantojmë një proces sa më objektiv, transparent, dhe media do të jetë e pranishme. E dyta, të bëjmë përzgjedhjen më të mirë, kur të votojmë për shtatë anëtarët e kolegjit.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Në fakt, unë iu lashë të flisnit juve, Vasilika dhe zotin Noka, për shkak se keni zgjuar kandidatët dhe keni marrë një *feedback*. Unë dhe zoti Bushati mund të recitojmë vjersha të ndryshme, njëri për partinë e vet, ndërsa tjetri për të tijën, por nuk i kemi dëgjuar kandidatët. Do t’i dëgjojmë kandidatët, por ka një gjë të rëndësishme, shumë të rëndësishme, që është cilësia e kandidatëve dhe e atyre që do të përzgjidhen, domethënë e anëtarëve të Komisionit të Apelit. Është shumë e rëndësishme.

Për ta bërë të qartë edhe për publikun, këta persona do të bëjnë verifikimin e gjithë sistemit të drejtësisë për pasurinë, që është një komponent. Komponenti i dytë është ana profesionale. Pra, do të verifikojnë anën profesionale, cilësinë e vendimeve të gjyqtarëve të shkallës së parë, atyre të apelit, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, shikojmë cilësinë e vendimeve. E treta është figura e tyre etike. Pra, janë tre komponentë.

Po, unë bie shumë dakord me juve, zonja Hysi, edhe me ju, zoti Bushati, që atje jashtë ka kandidatë shumë më të mirë se këta, të cilët u frenuan. Pse u frenuan? U frenuan për shkak të konfliktit politik. Kështu është, apo jo? U frenuan për shkak të konfliktit politik. Cili ishte konflikti politik?

Po, është shumë e vërtetë. Le t’ua themi qytetarëve. Ne e miratuam me 140 vota Kushtetutën dhe ato kritere kushtetuese, por nuk e miratuam bashkë ligjin “Për vetingun”. Këtu e kishim konfliktin.

Tani, duke e lënë pas atë që ka kaluar, dhe për të shikuar përpara: çfarë duhet t’i japim ne publikut? Ne duhet t’i japim publikut, qytetarëve, besimin se ky komision do të nxjerrë më të mirët. A janë këta më të mirët në Shqipëri? vetë e pranojmë se nuk janë. A do të gjejmë nga ata? Le t’i dëgjojmë. Unë s’i kam dëgjuar, ju i keni dëgjuar.

Zoti Noka i bëri një sfidë anës tjetër, palës tjetër, kur tha se këta të tre juve do t'i votoni. Le t'i ngelet procesit që do të vijojë. E rëndësishme është që të gjenden kandidatë me integritet, t'i dëgjojmë ata që do të vijnë, e pastaj të vendosim. Sepse procesi më i rëndësishëm është besimi publik te këta komisionerë. A e kanë besimin publik? Ta kemi një herë ne besimin teka ata, sepse ne që jemi këtu përfaqësojmë vullnetin e popullit, të paktën deri më 9 shtator, përfaqësojmë bindjet e tyre, dhe ne t'ia përcjellim. Në qoftë se ne devijojmë, kjo pastaj është një çështje për të cilën do të na gjykojë publiku. Prandaj, në orën 11 fillojmë seancën, dhe vazhdojmë.

Vasilika Hysi – Fjalën e ka zoti Bushati.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, është një nga maxhoranca, një nga opozita, siç e ka Rregullorja.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Unë besoj e di dhe jam këtu në një komision që qytetarët e Shqipërisë, Kuvendi i Shqipërisë na ka besuar të jemi komisioni për vetingun. Nuk jemi as të orakullit së Delfit, as te ndonjë pikebastesh, kështu që këtë pikën tani as nuk e marr fare për sfidë, as nuk e fus si sfidë se s'di as të vë bast, se nuk kam vënë ndonjëherë në jetë, por me sa duket, me këto emra që hedh zoti Noka do t'i ndihmoj se do të ngelen në vëmendjen e publikut dhe po u jep një avantazh pa i dëgjuar dhe po paragjykon, dhe po i pararend një procesi që është shumë i rëndësishëm për qytetarët shqiptarë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushati!

Urdhëroni, zoti Noka!

Flamur Noka – Zonja kryetare,

Më vjen keq, por shumë nga ato që thatë ju në lidhje me komisionin e vlerësimit janë të pavërteta dhe nuk dua ta bëj këtë objekt debati. Unë kam të gjithë të drejtën në emër të PD-së dhe të opozitës të paragjykoj, për arsye se ai komision nxori një produkt tërësisht të paragjykuar. 67 pretendentë që kishte kualifikuar Avokati i Popullit erdhën sot në këtë komision dhe në komisionin tjetër do të vijnë.

Ndërkohë që ne së bashku dhe, të lutem, ma përgënjeshtro këtë po qe se nuk po them të vërtetën, zhvilluam seanca dëgjimore të pafundme me të gjithë pretendentët edhe të kualifikuar nga Avokati i Popullit, edhe të kualifikuar nga ONM-ja, por edhe ata të ishin të skualifikuar nga Avokati i Popullit dhe nga ONM-ja. Gjatë seancave dëgjimore konstatoam se kishte pretendentë, të cilët kishin kritere identike për të cilat Avokati i Popullit disa i kishte mbajtur në listë, disa i kishte rrëzuar. Është e vërtetë kjo apo jo?

Vasilika Hysi – Kolegët kanë të drejtë të zgjedhin, të dëgjojnë. Komisioni i parë e ka mbaruar punën. T'ua lemë kolegëve, Vokshi, Tavo e Bushati të gjykojnë vetë kur t'i dëgjojnë kandidatët?

Flamur Noka – Fatmirësisht apo fatkeqësisht, s'di ta them, jam në të dyja komisionet kështu që do të flas, që të bëj sqarim, sepse thashë që detyra nr.1 e opozitës në këtë proces është vetëm transparenca përballë qytetarëve dhe ligjit, kështu që unë do ta ushtroj këtë të drejtë dhe nuk ma ndalon askush.

Pra, në listën e pretendentëve, Avokati i Popullit për të njëjtin kriter disa i kishte mbajtur, sepse ishin anëtarë të Asamblesë së PS-së dhe strukturave të saj dhe disa të tjerë, të cilët mund të ishin më të majtë se ata, por nuk ishin strukturua, me të njëjtat kritere i kishte rrëzuar.

ONM-ja kishte dy raste që ishin konflikt interesi dhe i kishte kualifikuar si pa konflikt i interesi, dhe për këtë kemi rënë dakord të gjithë atë ditë. Sikundër se kishte edhe dy raste të tjera identike dhe i kishte kualifikuar me konflikt interesi.

Mbi bazën e kësaj, ne konstatuam në fund se ishin mbi 10 pretendentë që nuk i kishte kualifikuar Avokati i Popullit me pretendimin se nuk kishin dokumente dhe ata na paraqitën ne si komisionin të gjitha dokumentet.

Vota politike bëri të rrëzohen të gjithë. Të gjithë i rrëzuar megjithëse i plotësonin të gjitha kriteret të dokumentuara pranë komisionit.

Kjo më bën mua që të paragjykoj se ju keni marrë vendim politik, që jashtë asaj liste që keni përzgjedhur, nuk lejoni të hyjë tjetërkush.

Nuk jemi profetë ne të opozitës, por unë po ju them që të mos vërtetohet profecia jonë mos votoni këto të tre se ndryshe vërtetohet gjithë profecia e opozitës.

Ju keni qëllim kapjen e drejtësisë me këta tre anëtarë të PS-së, hierarkë të lartë në institucionet e shtetit të propozuar nga PS-ja.

A mundet ndonjëri prej jush të thotë këtë që them unë për ju, ta thotë për ne të opozitës: që PD-ja ka përcaktuar ndonjë? Kemi ditë që përpiqemi të shohim dosjet profesionale, pa asnjë kriter politik, ne si opozitë dhe po përpiqemi dhe e kemi shumë të vështirë të gjejmë individë profesionalisht në lartësinë e duhur për të bërë ekspertizën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë.

Nuk dua të bie në përsëritje, por jam i detyruar ta theksoj se shumica e pretendentëve, për sa i përket kriterit profesional dhe nivelit profesional nuk janë në një nivel të tillë për të gjykuar aspektin profesional të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, është njësoj si të marrësh një infermiere me kurs 4-mujor t'i bëjë vetingun

profesional profesor doktorëve të fakultetit të Mjekësisë. Ky është krahasimi për sa i përket nivelit profesional të shumicës që janë këtu dhe atyre të cilëve do t'ju bëjnë vetingun.

Përfundimisht këto, kemi vetëm 3 individë të spikatur politikisht që kanë bërë karrierë me mbështetjen e PS-së. Çfarë tregon kjo? E kemi parajgjykuar procesin që ditën e parë dhe do të tentoni kapjen. E bëni apo s'e bëni është puna juaj, por detyra jonë është transparencë përballë qytetarëve që në fund qytetarët të jenë në gjendje të gjykojnë që PD-ja dhe opozita ka pasur të drejtë që ditën e parë ka thënë se Edi Rama kërkon kapjen e drejtësisë.

Kjo treshe që do të rezultojë tregon qartë se ne kemi pasur të drejtë. Ky është synimi juaj, nuk është reforma në drejtësi, por kapja e drejtësisë. Votimi i para dy ditëve në komisionin e verifikimit e vërtetoi dhe ishte hapi i parë që e vërtetoi këtë gjë. Do të shohim më tutje se si do të vërtetohet përfundimisht kjo që them.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit!

E mbyllim pjesën e parë të mbledhjes.

Kemi 5 minuta pushim për t'i dhënë mundësi kandidatëve të paraqiten. Ju lutem, sekretaria e komisionit, të verifikojë nëse kandidatët kanë ardhur.

MBLEDHJA MBYLLET



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KUVENDI

Komisioni ad hoc me 6 anëtarë për përzgjedhjen e kandidatëve për krijimin e institucioneve të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.06.2017, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Vasilika Hysi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore publike me 34 kandidatët e listës për votim që konkurrojnë për Kolegjin e Apelimit, të përcjellë nga komisioni *ad hoc* për Verifikimin e Kandidatëve.

Marrin pjesë:

Vasilika Hysi, Eduard Halimi, Flamur Noka, Ervin Bushati, Vangjel Tavo dhe Albana Vokshi.

Të ftuar:

Arben Lena - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit

Albana Shtylla - Kolegji i Posaçëm i Apelimit

Alma Faskaj (Vokopola) - Për të gjitha pozicionet

Ardian Hajdari - Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe Komisioner Publik

Brunilda Bekteshi Vasha - Për të gjitha pozicionet

Elvis Zaimi - Për të gjitha pozicionet

Ermira Koçu Deçka - Kolegji i Posaçëm i Apelimit

Etleda Çiftja - Për të gjitha pozicionet

Etleva Papekaj - Për të gjitha pozicionet

Fatmira Luli - Për të gjitha pozicionet

Firdes Shuli - Për të gjitha pozicionet

Genci Bilali - Për të gjitha pozicionet

Genta Tafa (Bungo) - Për të gjitha pozicionet

Ina Rama - Kolegji i Posaçëm i Apelimit

Irena Nino - Për të gjitha pozicionet
Klara Mullaj - Për të gjitha pozicionet
Lindita Blinishti - Për të gjitha pozicionet
Luan Daci - Për të gjitha pozicionet
Lulzim Hamitaj - Për të gjitha pozicionet
Mimoza Tasi - Për të gjitha pozicionet
Natasha Mulaj - Për të gjitha pozicionet
Olsi Komici - Për të gjitha pozicionet
Pal Shkambi - Për të gjitha pozicionet
Pamela Qirko - Për të gjitha pozicionet
Rezarta Tahiraj - Kolegji i Posaçëm i Apelimit
Roland Ilia - Komision i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit
Shpresa Beçaj - Kolegji i Posaçëm i Apelimit
Sokol Çomo - Kolegji i Posaçëm i Apelimit
Suela Zhegu - Për të gjitha pozicionet
Suzana Pasha Hoti - Për të gjitha pozicionet
Valbona Sanxhaktari - Për të gjitha pozicionet
Vojo Malo - Për të gjitha pozicionet
Xhensila Pine - Për të gjitha pozicionet
Rezarta Schuetz - Kolegji i Posaçëm i Apelimit

Vasilika Hysi – Përshëndetje, kolegë!

Rifillojmë seancën dëgjimore.

Sekretariati i komisionit ju ka vënë përpara dokumentacionin e çdo kandidati dhe njëkohësisht keni një listë me emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale dhe konkurrojnë për Kolegjin e Apelimit. Lista përbëhet nga 34 anëtarë. Në listë keni kandidatë që do të votohen vetëm për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, por keni edhe kandidatë që do të votohen për të tria pozicione të tjera. Në bazë të ligjit, pas dëgjimit në seancën e sotme, ne do të votojmë për 7 anëtarët e Kolegjit të Apelimit dhe 2 zëvendësuesit, por kandidatët e tjerë, që kanë konkurruar për të tria pozicionet, do të dëgjohen edhe në komisionin *ad hoc* të përzgjedhjes së komisionerëve publikë dhe të anëtarëve të Kolegjit të Pavarur të Kualifikimit për t'u përzgjedhur dhe për t'u votuar si anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose si komisioner publik nëse ne nuk i votojmë në komisionin tonë.

Kemi vendosur rregullin që të thirren sipas rendit alfabetik, por do të bëjmë përjashtim për një zonjë, e cila është shtatzënë, dhe besoj kemi mirëkuptimin e të gjithëve, ndaj do t'ju lutesha të thirret Etleđa Çiftja.

Etleđa Çiftja – Po.

Vasilika Hysi – Përshëndetje, zonja Ekledja!

Ju keni konkurruar për të gjitha pozicionet.

Shumë shkurt, do t'ju bëja me dije qëllimin e kësaj seancë dëgjimore, meqenëse ju jeni dëgjuar edhe në Komisionin e Verifikimit me kërkesën e kolegëve për t'u njohur.

Komisioni ynë do të përzgjedhë 7 anëtarë për Kolegjin e Apelimit. Kriteret që duhet të plotësojë një anëtar për këtë kolegji, që është shumë i rëndësishëm, janë të parashikuara në nenin C të aneksit të Kushtetutës, por edhe në nenin 6.

Ne kemi përpara dosjen tuaj të përcjellë nga Avokati i Popullit. Njëkohësisht, kemi të gjithë informacion që ka përgatitur stafi sekretariatit të komisionit.

Do të prezantoni veten për 5 minuta. Ideja është të prezantoni jo aq kriteret formale për të cilat Komisioni i Verifikimit i ka parë, por kryesisht diçka më shumë pse ne duhet t'ju votojmë ju. Çfarë mund të ofroni ju më shumë se kandidatët e tjerë në Kolegjin e Apelimit, duke pasur parasysh kërkesat e nenit 6, paragrafi i parë dhe sidomos paragrafin e dytë të këtij neni.

Fjala është për ju.

Etleđa Çiftja – Faleminderit!

Mirëdita të gjithëve!

Së pari, faleminderit për radhën dhe që më dhatë mundësinë të shprehem për vete!

Unë kam kandiduar për të gjitha pozicionet, por sidomos për këtë pozicion, që e konsideroj si më të rëndësishmin. Bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016, kriteret për të cilat unë kam aplikuar formalisht janë të plotësuara dhe, siç edhe u shpreha gjatë seancës dëgjimore pranë komisionit *ad hoc*, mendoj se arsyet kryesore që më bëjnë mua ndryshe nga kandidatët e tjerë janë mosangazhimi në asnjë nga pushtetet ekzekutive, legjislative apo gjyqësore më parë, duke menduar që vetë fryma e ligjit është kthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

Duke pasur parasysh frymën dhe legjislacionin që ju keni miratuar, mendoj se mosqenia në asnjë nga këto sisteme nuk e komprometon absolutisht kandidaturën time, përkundrazi, krijon një besim shumë më të madh për zgjedhjen që do të bëhet, sidomos në Kolegjin e Apelit ose për seancën që jemi mbledhur sot.

Arsyeja e dytë është se unë kam punuar gjithmonë me kompani të huaja dhe për këtë fakt e kuptoj më shumë dhe bëhesh më i vetëdijshëm që duhet të kontribuosh me shumë për vendin tënd, që besimi i publikut, besimi i investitorëve të huaj të jetë sa më i lartë.

Besoj se kjo është një anë tjetër që unë e vlerësoj pozitive, duke i parë të tria sistemet e një shteti nga pozicioni i një investitori privat. Duke i parë nga kjo anë, mendoj se do t'i bënte mirë edhe sistemit të kishte kandidatët e këtij grupi. Ka edhe shumë kolegë të tjerë të nderuar, që mbase janë në të njëjtat pozita, por mendoj se mua më favorizon kjo gjë.

Së treti, eksperiencia që kam pasur me sistemin gjyqësor dhe me pushtetin ekzekutiv, patjetër duke e ushtruar detyrën time në privat, mendoj se është një anë tjetër, sepse pak a shumë ju jeni në dijeni të problemeve të sistemit dhe mendoni se ku mund të kontribuoni me integritetin tuaj.

Për sa i përket integritetit, është një armë e fortë dhe, duke i injoruar të gjitha të tjerat që shpjegova më lart, është pjesa më e fortë personale imja, pasi shpesh, edhe kur diskutoj me të huajt, them se unë kam lindur me integritet, pasi integriteti nuk blihet, ju lindni me atë me anë të familjes ose edukatës që keni në familje. Fakti që unë vij nga një familje e thjeshtë dhe me integritet, mendoj se më bën një kandidatë të preferuar në frymën e ligjit për të krijuar besimin e publikut te sistemi gjyqësor.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Etleda!

Keni pyetje, kolegë?

Zonja Vokshi, keni pyetje?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Zonja Etleda, ju keni qenë 16 vjet avokate, apo jo?

Etleda Çiftja – Po.

Eduard Halimi – E mbani mend sa çështje keni mbrojtur në Gjykatën Kushtetuese ose në Gjykatën e Lartë?

Etleda Çiftja – Duke qenë se jemi kompani private, i ndjekim në Shkallën e Parë dhe në Shkallën e dytë, dhe çështjet që janë në Gjykatën e Lartë i ndjekim me anë të studiove ligjore të jashtme.

Eduard Halimi – Po ju personalisht?

Etleda Çiftja – Personalisht kam ndjekur 2 çështje në Gjykatën e Lartë.

Eduard Halimi - Po në Gjykatën Kushtetuese?

Etleda Çiftja – Në Gjykatën Kushtetuese nuk kam ndjekur çështje.

Eduard Halimi – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Ka pyetje të tjera, kolegë?

Zonja Etleda, do të njoftoheni për votimin.

Faleminderit!

Etleda Çiftja – Faleminderit!

Mirupafshim!

Vasilika Hysi – Vazhdojmë me zotin Arben Lena dhe më pas me zonjën Albana Shtylla.

Arben Lena – Mirëdita!

Vasilika Hysi – Mirë se erdhët, zoti Lena!

Për ju është intervista e dytë. Jeni para komisionit që do të propozojë kandidatët që do të votohen për Kolegjin e Apelimit. Ne e kemi përpara dosjen tuaj dhe do të donim të dëgjonim pse ne duhet t'ju votojmë ju për në Kolegjin e Apelimit?

Ju keni konkurruar për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe për komisioner të pavarur të kualifikimit, por intervistat do të bëhen në dy komisione të ndryshme. Nëse ju fitoni në këtë komision, nuk do të votoheni për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Keni 5 minuta kohë për të folur për të veçantat tuaja, për të cilat ne duhet t'ju votojmë ju.

Arben Lena – Mendoj se një gjë e veçantë është eksperiencia. Unë kam punuar vetëm në këtë profesion që kur kam mbaruar shkollën. Kam punuar avokat nga viti 2001 dhe avokatia është një përvojë tepër e gjerë, pasi je i detyruar të studiosh në shumë fusha, jo vetëm në fushën penale. Kam marrë pjesë në shumë trajnime dhe konferenca të organizuara nga USAID-i, nga Dhoma Amerikane e Avokatisë apo nga OPDAT-i. Kam marrë pjesë në formimin dhe krijimin e projektit ballkanik të shtetit të së drejtës, i cili ka tri vjet që vepron

në Ballkan me qendër në Shkup. Ky projekt është drejtuar nga Dhoma Amerikane e Avokatisë me mbështetjen e USAID-it. Jam zgjedhur aktualisht në kryesinë e këtij viti.

Që nga viti 2007 e deri tani jam zgjedhur në mënyrë të vazhdueshme si anëtar i Këshillit Drejtues të Dhomës së Avokatisë. Prej vitit 2012 jam zgjedhur kryetar i Dhomës Rajonale të Avokatisë. Aktualisht jam edhe anëtar i Këshillit Drejtues i Dhomës së Avokatisë.

Kam marrë pjesë në studime që kanë të bëjnë kryesisht në të metat krahasuese të Kodit të Procedurës Penale në kuadër të këtij projekti, i cili është një studim që ka të bëjë me dëmin që shkaktojnë këto të meta për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky studim ka përfunduar vjet, ku unë kam qenë koordinator i avokatëve të Shqipërisë, dhe është botuar në Serbi, meqenëse ka qenë drejtuese Dhoma Kombëtare e Serbisë. Studimi përfshinte 5 shtete të Ballkanit, Bosnjën, Serbinë, Maqedoninë dhe Shqipërinë. Mendoj se me përvojën që kam, mund të arrij.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Keni lidhje ose aktivitete politike të deklaruara, që ne duhet t'i dimë, sepse është paragjykuar nga kolegët e kraut tjetër që shumë nga anëtarët kanë lidhje politike, kanë pasur eksperiencë ose të shkuar politike.

Arben Lena – Nuk kam dhe nuk kam pasur asnjëherë lidhje politike, nuk kam pasur asnjë funksion politik, qoftë shtetëror apo partiak dhe nuk kam as tani.

Vasilika Hysi – Zoti Lena, kam një pyetje.

Gjatë gjithë karrierës suaj ju keni qenë fillimisht asistent prokuror dhe më pas avokat. Keni pasur raste të ankimimeve nga ana e qytetarëve në Dhomën Kombëtare të Avokatisë?

Arben Lena – Jo, nuk kam pasur raste të ankimimeve në drejtimin tim.

Vasilika Hysi – Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Kur e keni mbrojtur anglishten?

Arben Lena – Anglishten nuk e kam mbrojtur, pasi, duke qenë avokat, nuk kam pasur nevojë ta mbroja, pasi më është dashur gjithmonë.

Eduard Halimi – Dakord.

Arben Lena – Të gjitha projektet ku kam marrë pjesë kanë qenë në anglisht.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Do të njoftoheni për votimin.

Ditën e mirë!

Arben Lena – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Po, zoti Halimi, për procedurë.

Eduard Halimi – A e ka ligji që duhet të ketë mbrojtur anglishten? Si e kanë kaluar?

Vasilika Hysi – Në nenin 6 në ligj thuhet “zotëron shumë mirë gjuhën angleze”. Nuk e di si e ka vlerësuar Avokati i Popullit dhe ONM-ja, por, nëse dëshironi, mund t’i bëni ndonjë pyetje anglisht.

(Diskutime pa mikrofon.)

Eduard Halimi – Ka një problem në këtë pjesë, sepse Kushtetuta parashikon që kandidatët duhet të kenë mbrojtur anglishten. Nuk e vlerësojmë ne nëse di apo jo anglisht. Vetëm Ervinin e kemi cilësuar në parlament që di mirë anglisht, por kjo nuk ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E ka vlerësuar doktori.

Kriteri ligjor thotë se, nëse e njih apo nuk e njih gjuhën, e certifikon Universiteti i Gjuhëve të Huaja, nuk e certifikojmë ne. Lika, ti mund t’i bësh pyetje anglisht dhe greqisht, por të duash, por nuk do të thotë që duhet...

Këtë çështje duhet ta zgjidhni.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Halimi!

Mirë se erdhët, zonja Shtylla!

Ju keni konkurruar vetëm për pozicionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Ne e kemi CV-në, dokumentacionin dhe dosjen tuaj.

Shumë shkurt, pse duhet t’ju votojmë?

Albana Shtylla – Ju falënderoj për këtë seancë dëgjimore dhe për mundësinë që po më jepni për t’u shprehur për arsyen pse duhet të më votoni!

Besoj se vetë eksperiencia ime profesionale prej 25 vjetësh meriton, duke e lënë mënjanë modestinë, një kurorëzim në organe të tilla të rëndësishme të sistemit të drejtësisë.

Së dyti, e konsideroj edhe një sfidë. Gjatë jetës sime profesionale më kanë pëlqyer sfidat, pavarësisht se, sa kam dëgjuar këto kohë, mund të kem marrë edhe kosto, por sërish, të them të drejtën, nuk tërhiqem. Pra, e konsideroj si një sfidë për të qenë pjesë e këtyre organeve, për të vazhduar dhe për të ushtruar me përgjegjshmëri dhe përgjegjësi maksimale, sipas Kushtetutës dhe ligjit, kompetencat që janë parashikuar për këto organe në Kushtetutë dhe në ligj.

Nga ana tjetër, reformimi i sistemit të drejtësisë, në fakt, jo vetëm një sfidë imja, por besoj se një sfidë e të gjithë vendit, një sfidë për të reformuar dhe për ta konsideruar tashmë një kapitull të mbyllur pjesën e problematikave që ajo ka mbartur në vijim dhe më tej hapjen e një horizonti të ri për qytetarët shqiptarë për drejtësi efektive dhe eficiente për ta.

Së fundi, mendoj se pavarësisht diskutimeve që mund të jenë bërë këto organe kërkojnë njerëz, që kërkojnë një lloj dinjiteti dhe kërkojnë të kenë një lloj angazhim të sfidueshëm për të treguar që nuk jepen para presioneve, para ndërhyrjeve apo edhe mënyrave të tjera, që mund të përdoren për të dhënë vendimmarrjen e tyre.

Unë mendoj se këto janë arsye kryesore mbi të cilat mbështes motivimin tim.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Shtylla!

Keni pyetje kolegë?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Zonja Shtylla, unë nuk kam asgjë lidhur me pjesën profesionale, sepse ju njoh kur ju keni punuar në kohën kur unë kam drejtuar ministrinë. Unë kam vetëm një shqetësim, të cilin e kam bërë publike edhe herë të tjera lidhur me afilacionin tuaj politik. Kjo është konkluduar në momentin kur ju keni qenë anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku para 4 vjetësh keni marrë një urdhër politik që të braktisnit KQZ-në, dhe ju e keni braktisur atë. Vendim i mirë, të pëlqen apo nuk të pëlqen, kjo nuk ka rëndësi, por ju për ne keni këtë afekt politik.

OMN-ja ka dhënë një qëndrim të saj in lidhur me qëndrimin tuaj në këtë proces. A mendoni se e keni besimin publik? A e zotëroni besimin publik kur njëra palë thotë se ju jeni e palës tjetër, kur OMN-ja thotë se duhet të ikni, sepse ka konflikt interesi? Cila është përgjigjja juaj lidhur me këtë gjë?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Halimi!

Po, zonja Shtylla.

Albana Shtylla – Falënderoj zotin Halimi për konfederatat profesionale!

Në fakt, gjënë më të shtrenjtë unë kam karrierën time profesionale. E kam thënë edhe në momentin kur kam dhënë dorëheqjen si anëtare e KQZ-së. Madje nëse ju do t'u drejtoheshit rekordeve, qoftë mediatike, ajo që kam thënë është : “Për 25 vjet (në atë kohë, në fakt, kanë qenë 21 vjet) kam ndërtuar me thonj dhe kam mbajtur me thonj karrierën time profesionale”, sepse e kam pasur gjënë më të shtrenjtë me të cilën kam investuar në jetën time.

Lidhur me dorëheqjen, unë e sqarova edhe herën e kaluar, nuk e pranoj në asnjë rast që ka qenë një dorëheqje e motivuar politikisht, ka qenë një akt individual përgjegjshmërie dhe përgjegjësie, i cili mbështetej në situatën që u krijua në atë periudhë lidhur me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, për në KQZ-në po flas unë, për tryezën e KQZ-së.

Në qoftë se do t'u referoheni procesverbaleve të KQZ-së të asaj periudhe, sepse mua më pëlqen të flas për akte të shkruara, do të konstatoj se anëtarët e asaj tryeze filluan të etiketoheshin si anëtarë të kësaj apo të asaj partie.

Unë e ritheksoj: pavarësisht se kam qenë një kandidaturë e propozuar nga një subjekt politik, siç mund të jenë edhe sot kandidatura të tilla, nuk do të dëshiroja të përmendja shembuj të fundit si zonja Ballanca në detyrën e Avokatit të Popullit është e propozuar ndërkohë të paktën nga një subjekt politik. Jam mëse e sigurt që kolegja e nderuar nëse do të dëgjojë këto debate që bëhen lidhur me individë të caktuar për afilimin e tyre politik do të ndihet...

Flamur Noka - Mos përmendni emra të tjerë.

Albana Shtylla - Zoti Noka, të lutem, të mbaroj...

Flamur Noka – Zonjë, mos të ërmend emra që nuk kanë lidhje me procesin.

Vasilika Hysi – Ta dëgjojmë zonjën Shtylla.

Flamur Noka – Zonja le të flasë për vete, mos të ...

Albana Shtylla – Pra, do të ndihet e riskuar në karrierën e saj profesionale. Karriera profesionale nuk është e lidhur me partitë politike, është e lidhur me atë që individi ndërton çdo ditë.

Besimin te publiku e kam treguar disa herë besoj edhe gjatë ushtrimit të detyrës kur ju keni qenë ministër. Zoti Noka më njeh, sepse kam ardhur në komision, pavarësisht presioneve që mund të kem pasur, për qëndrime të tilla mund të më jetë thënë që të mbaj një qëndrim politik, unë kam mbajtur qëndrimin teknik. Pra, ju vetë e keni të provuar, po ashtu edhe zonja Vokshi më njeh, nga eksperiencia e punës sime në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale që kam mbajtur një qëndrim të mirëfilltë teknik, të cilin do të vazhdoj ta mbaj edhe tani.

Përsëri lidhur me besimin e publikut, në fakt, t'ju të them të drejtën, prisja që ju, si anëtarë të nderuar të këtij Kuvendi, ta linit mënjane këtë lloj debati dhe të vlerësonit pse jo edhe punën që kam bërë si drejtuese e shërbimeve të Kuvendit në këta 4 vjet.

Më vjen mirë, që ju zoti Halimi, jo pak herë jeni referuar në mbledhjet e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në mbledhjet e Konferencës së

Kryetarëve duke thënë: “Pse nuk ju pëlqen kur Shërbimi Juridik i Kuvendit thotë një gjë që nuk ju pëlqen? e të tjerë me radhë”. Kjo do të thotë se në asnjë rast nga ana ime në kryerjen e detyrës funksionale nuk kam ndikuar mbi shërbimet për të pasur qëndrime politike, por thjesht qëndrime teknike.

Përsëri, për sa i përket besimit publik, besoj se kam ushtruar detyrën në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin si anëtare e KLD-së për këta 3 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka gjë, mund ta thoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Absolutisht jo, sepse janë rregulla të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit, që i keni miratuar ju vetë, ku keni thënë: “Kandidaturat për titullarë apo anëtarë të organeve të institucioneve kushtetuese mbështeten me 28 firma”. Çfarë do të thotë kjo, që ju këta njerëz i bëni pis në momentin që i mbështesni me firma? Absolutisht jo!

Besimi i publikut...

Flamur Noka – Ju lutem, flisni për vete, jo të bësh gjyq këtu.

Vasilika Hysi – Zoti Noka, mbledhjen e drejtoj unë këtu, nuk e drejtoni ju, ju lutem.

Albana Shtylla – Besimin te publiku besoj se e tregon karriera ime e gjatë, që pavarësisht se kush ka qenë në pushtet, një maxhorancë apo një tjetër më kanë vlerësuar besoj. Mendoj se e kam merituar dhe ju falënderoj edhe ju zoti Halimi që e thatë, sepse kam treguar me profesionalitet të ushtror detyrën sipas Kushtetutës dhe ligjit.

Lidhur me situatën e fundit që përmendët, për sa i përket vrojtimit, në fakt, edhe herën e kaluar unë e përmenda se që prej datës 3 mars, për shkak të këtij kandidimi, kam bërë delegim të detyrës së sekretarit të Përgjithshëm për ata komponentë menaxherial organizativ, që lidhen me mbështetjen e organeve, të cilat do të përzgjedhin anëtarët e organeve të vetingut, kështu që besoj se jam në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin për këtë çështje.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Zoti Noka, të lutem, dua të bëj një sqarim edhe për publikun që po na ndjek nëpërmjet medias. OMN-ja në raportin mbi rekomandimet që i ka paraqitur komisionit, në faqen 17 “Vrojtime të tjera”, e ka trajtuar problemin e aplikantes Albana Shtylla, ku ka kërkuar që ajo të tërhiqet nga pozicioni i saj ose të delegojë një rol në menaxhimin administrativ dhe është e vërtetë që zonja Shtylla e ka deleguar. Ne në komisionin e verifikimit e verifikuam në Fletoren Zyrtare, vendimin e delegimit, prandaj ky është edhe një sqarim për kolegët. Ju lutem, kush e dëshiron vendimin, mund t’i vihet në dispozicion kopja e

Fletores Zyrtare, ku është botuar delegimi i këtij pozicioni dhe kjo është thënë qartë edhe në raportin e OMN-së.

Së dyti, e kam procedurale, kërkoj shumë ndjesë, e bëme te zonja Shtylla, të mos e përsërisim me të tjerët. Ne duhet t'i dëgjojmë dhe secili prej nesh ka të drejtën e një vote dhe t'i votojmë kandidatët, por kurrësi t'i cenojmë në integritetin e tyre apo karrierën, aq më tepër kur kandidatët kanë punuar me ju dhe zonja Shtylla që nga viti 1992 ka punuar me të gjitha qeveritë.

Ndjesë dhe nuk do të bëjmë komente, sepse neve nuk na lejohej që të bëjmë komente për kandidatët. Ne do të bëjmë pyetje, një pyetje nga krahu i majtë dhe një pyetje nga krahu i djathtë, dhe pasi të mbarojmë radhën e pyetjeve do t'i rikthehem, por nuk mund të bëjmë komente dhe diskutime lidhur me përgjigjet që na japin kolegët. Këtë e thashë para zonjës Shtylla, por unë dua që të jemi shumë të kujdesshëm me të gjithë kandidatët e tjerë.

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Kam diçka për procedurë, sepse pyetjet për zonjën i mbarova. Është shumë e rëndësishme që qytetarët të dëgjojnë mendimet dhe qëndrimet e palëve politike. Unë e thashë para se të vinin kandidatët, që është shumë e rëndësishme që anëtarë të komisionit të zgjidhen njerëz që nuk janë të afilacionit tonë dhe as të afilacionit tuaj. Unë ju ftoj që të gjithë ata kandidatë që do të vijnë këtu, në qoftë se ju mendoni që është i afilacionit politik të PD-së përjashtojini dhe unë do t'ju mbështes, sepse votimi është i mbyllur dhe nesër do të dalin rezultatet, do të dalin rekordet.

Zoti Noka ju bëri një sfidë dhe ne tani nuk mund të jemi ndryshe, sepse duhet të jemi koherentë. Unë e bëra shumë të qetë, sepse nuk kam fare dëshirë që të merrem as me zonjën Shtylla dhe as me të tjerët.

Zonja Shtylla e di, unë kam pasur qëndrimet e mia koherente, unë kam dalë në konferencë për shtyp disa herë dhe kam thënë, anëtare, pa shkuar fare, është sekretarja e Përgjithshme. Anëtarët e KQZ-së që braktisën KQZ-në ishin kamikazë politikë. A është profesioniste me integritet profesional? Po, është. Po, e them se ka qenë, ka punuar në ministri në kohën e PS-së, në kohën e PD-së, por kjo nuk do të thotë absolutisht se duhet të ketë besimin në publik. Zoti Noka shprehu mendimin që ju do ta votoni. Dakord, votojeni, por ama me qytetarët duhet të jemi të sinqertë, sepse kështu është ndarja që të jenë të qarta qytetarët. Ne nuk do të jemi dakord me PS-në për të zgjedhur anëtarët, sepse procesi i votimit është shumë i thjeshtë, secili nga anëtarët do të votojë një. Së pari, nuk ka dakordësime se duhet të biem dakord ne e duam apo nuk e duam Albanën. Por ne duhet të biem dakord vetëm për një gjë: do të ishte shumë mirë që ata kandidatë, të cilët ju mendoni se janë të afilacionit

tuaj apo të afilacionit tonë politik, duhet t'i përjashtoni. Këtë gjë kisha për sa i përket procedurës.

Lidhur me pyetjet dhe përgjigjet unë mbarova, por nëse ajo do të bëjë replikë, unë nuk do të merrem me Albanën, sepse nuk ka vlerë tani kjo gjë.

Albana Shtylla – Zoti Halimi, unë nuk do të bëja replikë me ju, por thjesht dua t'ju them që të mos bëni ndarje, sepse e kam merak se do ta thoni përsëri... Ne nuk duhet të etiketohemi, sepse procedura parashikon fshehtësi. Shpresoj që të më votoni ju, të them të drejtën.

Vasilika Hysi - Atëherë, do t'ju sjell në vëmendje ligjin dhe Rregulloren e Kuvendin, si dhe rregulloren e miratuar me vendimin e posaçëm nr. 40/2017 lidhur me zhvillimin e seancave dëgjimore: “Çdo anëtar i komisionit ka të drejtë t'u bëjë pyetje kandidatëve. Anëtari i komisionit e merr fjalën për të bërë pyetje, pas dhënies së kësaj të drejte nga drejtuesi i seancës. Anëtari i komisionit që pyet nuk ka të drejtë të japë konkluzione gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.” Ju lutem, asnjëri prej nesh nuk ka të drejtë të japë konkluzione.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Jo, nuk është përrallë, por është ligj.

“Anëtarët e komisionit nuk kanë të drejtë të komentojnë njëri-tjetrin për karakterin e pyetjeve që u drejtohen kandidatëve. Drejtuesi i seancës i jep të drejtën e fjalës me radhë, një anëtari nga shumica parlamentare dhe një nga pakica. Anëtari ka të drejtën për të kërkuar sqarime dhe saktësime të mëtejshme vetëm pasi të ketë përfunduar radha për secilin nga anëtarët e tjerë.”

Unë kërkoj që ta respektojmë këtë nen të Rregullores. Në rast se Kuvendit të Shqipërisë, nga pikëpamja procedurale, i janë lënë disa kompetenca për të zgjedhur disa drejtues të institucioneve, mos i politizoni kandidatët. Ne zgjedhim Avokatin e Popullit, ne zgjedhim kryetarin e KLSH-së, ne zgjedhim edhe shumë drejtues të tjerë të institucioneve, ne do të zgjedhim anëtarët jogjyqtarë dhe joprokurorë të KLGJ-së dhe KLP-së dhe kjo nuk do të thonë se ata janë të majtë, të djathtë, të kuq, blu, të verdhë apo të zinj.

Unë do t'ju lutesha shumë të mos i politizoni, sepse jemi ne që kemi vendosur që çdo kandidat duhet të votohet në këtë komision, jemi ne që kemi vendosur që një anëtar apo një kryetar i një institucioni të pavarur duhet të marrë 28 firma mbështetëse. Nëse nuk doni, ejani ta ndryshojmë Rregulloren, do të bëjmë reformën kushtetuese pas zgjedhjeve, do të bëjmë reformën zgjedhore dhe do t'i rregullojmë.

Ju lutem, në cilësinë e kryetares së komisionit, por edhe si kolege, sepse jemi live dhe nuk do të doja të lëndonim kandidatët që kanë ardhur këtu.

Eduard Halimi – Vasilika, mos na bëni recitime.

Vasilika Hysi – Nuk është recitim, thamë se do të jemi të kujdesshëm.

(Diskutime pa mikrofon)

Kush ka pyetje për zonjën?

Po, zoti Noka

Në fillim zoti Bushati, më pas ju zoti Noka.

Flamur Noka – Ma dhatë mua në fillim fjalën.

Vasilika Hysi – Jo, sepse është me radhë, një nga maxhoranca dhe një nga opozita.

(Diskutime pa mikrofon)

Ervin Bushati – Si fillim kam një vërejtje për procedurë, se kemi shumë kandidatë dhe po të vazhdojmë me këtë ritëm, nuk do të jemi produktivë.

Në radhë të parë, për procedurë, të mos paragjykojmë një njeri që punon dhe mbrohet nga parlamenti, sepse nesër i bie që asnjë qytetar shqiptar nuk duhet të aplikojë për asnjë post publik, por edhe kjo pjesa që meqenëse keni punuar këtu apo aty dhe jeni emëruar nga parlamenti nuk ka sens.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, sepse atëherë nuk do të vijë më asnjëri që të aplikojë.

Pyetja ime është: a keni qenë ndonjëherë me ndonjë parti politike? A keni tester partie? Kaq ishte, pse e sqaroni kaq gjatë.

Albana Shtylla – Asnjëherë dhe as nuk kam aspiruar ndonjëherë. Këtë gjë e kam thënë edhe herën e kaluar.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Flamur Noka – A mundem të bëj një pyetje?

Vasilika Hysi – Po, zoti Noka.

Flamur Noka – Meqenëse i ke marrë me emocion diskutimet e mia, unë të këshilloj t'i marrësh më lehtë, që të mos ngarkoheni emocionalisht.

Zonja Shtylla, e vlerësojmë shumë punën tuaj profesionale në administratën e Kuvendit dhe do të donim që të vazhdonit edhe më tej, sepse është aq e mirë sa do të na vinte keq që të shpëruleshe nga administrata e Kuvendit.

Pyetja ime është: në momentin që ju dhatë dorëheqjen nga KQZ-ja, sepse thatë se keni dhënë dorëheqje individuale, dorëheqja juaj a erdhi para thirrjes së Edi Ramës për të braktisur KQZ-në, apo pas thirrjes së tij për ta braktisur KQZ-në?

Vasilika Hysi – Po, zonja Shtylla.

Albana Shtylla – Edhe tani nuk kam dëshirë, siç e thashë nuk kam afilim politik dhe nuk e ndjek politikën, kështu që edhe në atë kohë nuk e kam ndjekur pjesën e deklarimeve që mund të ketë bërë në atë kohë lideri i opozitës. Kështu që nuk mund të përgjigjem nëse ka qenë para apo pas, por di që e kam marrë atë vendim në mënyrë individuale, me vullnet të plotë, të vlerësuar maksimalisht sipas bindjes sime të brendshme.

Flamur Noka – Faleminderit!

Kam edhe një pyetje tjetër, nëse mundem.

Ju thatë se e keni dhënë dorëheqjen në mënyrë individuale. A quhet dorëheqje individuale kur japin dorëheqje 3 anëtarët e opozitës? Se jeni juriste. Apo quhet dorëheqje kolektive?

Albana Shtylla – Atëherë, aktet janë individuale, depozitohen individualisht. Unë nuk kontrolloj askënd që bën një veprim të ngjashëm me mua para apo pas. Kjo është përgjigja që kam për të dhënë. Kështu që, kam dhënë akt individual dorëheqjeje nga detyra e anëtarit të KQZ-së.

Flamur Noka – Edhe një pyetje tjetër. Mundem?

A mund të bëjë karrierë në sistemin e drejtësisë një individ, i cili në një moment shumë kritik ka braktisur detyrën? Si e gjykoni ju?

Albana Shtylla – E sqarova pak edhe herën e kaluar. Nuk e konsideroj braktisje detyre. E thash edhe pak më parë, e konsideroj akt përgjegjshmërie dhe përgjegjësie...

Flamur Noka – Ti mund ta konsiderosh akt përgjegjshmërie, por kjo ishte braktisje detyre.

Albana Shtylla – E konsideroj akt përgjegjshmërie dhe përgjegjësie, që do të thotë se, normalisht, nuk mund të bëhet kurrë fjalë për braktisje detyre. E thashë, nuk jam vënë përpara asnjë lloj presioni politik. Nuk kam pasur asnjëherë në jetën time mëdyshje që për shkak të presioneve, ndërhyrjeve, të merrja veprime të motivuara politikisht. Ishte akt përgjegjshmërie dhe përgjegjësie për atë që po ndodhte në tryezën e KQZ-së.

Flamur Noka – Faleminderit!

Edhe një pyetje tjetër kisha. A mund të quhet akt përgjegjshmërie braktisja e detyrës, zonja Shtylla?

Kaq kisha. Pyetje po bëj.

Albana Shtylla – Nuk besoj se ka nevojë ta ripërsëris: jo. Përgjegjshmëri dhe përgjegjësi për zbatimin e Kushtetutës dhe ligjit nuk do të thotë braktisje.

Flamur Noka – Suksese në përgjegjshmërinë tuaj!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Shtylla!

Albana Shtylla – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Ju urojmë ditë të mbarë!

Atëherë, kalojmë te kandidatura tjetër, zonja Alma Faskaj Vokopola, e cila konkurren për të gjitha pozicionet.

Përshëndetje, zonja Faskaj!

Kolegët, anëtarët e komisionit kanë përpara dosjen tuaj. Ju keni pasur edhe një intervistë në Komisionin e Verifikimit.

Do të donim të na thoshit se përse ne, 1 nga 6, duhet t’ju votojmë juve? Çfarë mund të ofroni ju më shumë se kandidatët e tjerë për t’u zgjedhur në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit?

Alma Faskaj Vokopola – Përshëndetje!

Ju falënderoj që më jepni këtë mundësi në këtë seancë dëgjimore!

Në fakt, nuk do të doja ta krahasoja veten time me të tjerët. Unë nuk e di se çfarë kanë të tjerët, realisht, por di se çfarë kam vetë dhe se çfarë ofron eksperiencia ime.

Unë kam 22 vjet eksperiencë si juriste. E kam filluar si gjyqtare dhe më pas si pedagoge e brendshme e Fakultetit të Drejtësisë, ku ka filluar edhe jeta ime akademike, e cila vazhdon. Kam 6 vjet që jam pedagoge e jashtme e Shkollës së Magjistraturës dhe jam një nga trajneret e trajnimit vazhdues, po kështu, dhe të formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Për sa u përket, le të themi, cilësive, do të thosha që si person kam pasur sfida shumë të rëndësishme në jetë, në fakt. Kam pasur shumë sfida personale, të cilave besoj se ua kam dalë shumë mirë. Përpos kësaj kam pasur edhe sfida profesionale. I kam vlerësuar të gjitha gjerat me vlerën e duhur. Çdo gjëje i kam dhënë rëndësinë e duhur në momentin e duhur.

Për sa i përket anës profesionale, besoj se fakti që kam 22 vjet në punë... Sot jam me një status nëpunësi civil. Jam me një titull “Doktore shkencash”. Besoj se integriteti është një element tjetër shumë i rëndësishëm imi dhe besoj që organet e rivlerësimit e kanë si një komponent shumë të rëndësishëm të tyre.

Pra, paralelisht do të thosha se ana profesionale imja, ana akademike, një investim i gjatë në fushën e s[ë Drejtës Administrative dhe proceset... Në fakt, organet e rivlerësimit kanë në bazën e tyre, komisioni, po kështu edhe kolegji, procesin administrativ, ku të drejtat e palëve, realisht, duhet të respektohen dhe dëgjohen, si dhe vendimi përfundimtar të jetë dhe të merret në bazë të provave dhe të një analize të thellë të tyre.

Mendoj se kam eksperiencën dhe ekspertizën e duhur ligjore për të arritur në konkluzion të drejtë dhe për të bërë një proces sa më të drejtë dhe dinjitoz.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Faskaj!

Ka pyetje kolegë?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Ne e kemi CV-në tuaj të pasur.

Ka një shqetësim nga ana e opozitës, që 99% e atyre që marrin pjesë sot në intervistë janë me afilacion politik, janë të lidhur me politikën.

Ju, a jeni e lidhur me politikën?

Alma Faskaj Vokopola – Absolutisht jo!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Ua bëjmë të gjithëve këtë pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Faskaj!

A ka pyetje, kolegë?

Atëherë, faleminderit!

Ju do të njoftoheni për votimin.

Kalojmë në kandidaturën tjetër. Është zoti Ardian Hajdari, i cili konkurren për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Je pa mikrofon.

Po. Do të bëjmë pyetje dhe nuk do të komentojmë.

Atëherë, mirë se erdhët, zoti Hajdari!

Ju konkurren për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe për pozicionin e komisionarit publik. Në këtë komision ju do të intervistoheni për pozicionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Ne kemi përpara dosjen dhe CV-në tuaj.

Patëm mundësinë t'ju dëgjonim (një pjesë e kolegëve). Tani, do të doja të dija, çfarë mund të jepni ju? Përse duhet t'ju votojmë në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit?

Çfarë ofroni ju që ne t'ju votojmë në këtë kolegji?

Ardian Hajdari – Ju falënderoj dhe ju përsëndes!

Unë jam prezantuar edhe në Komisionin e Verifikimit, por edhe përpara jush si komision përzgjedhës.

Unë vij nga Shkodra, nga një familje e varfër me prindër punëtorë. Kam kryer fakultetin e drejtësisë në Shkodër. Fillimisht jam emëruar si ndihmësgjyqtar. Kam punuar 5 vjet si ndihmësgjyqtar. Që në fillim kam krijuar afeksion për ligjin dhe të drejtën, për shtetin

e së drejtës. Kam aspiruar dhe aspiroj, edhe si avokat mbas vitit 2000 dhe në vazhdim, duke pasur si pasion ligjin dhe të drejtën, dëshirën për të qenë pjesë e vënies së drejtësisë.

Për atë pjesën e vuajtjes, në aspektin e punës që kam bërë, për shkak të stigmatizimit të sistemit të drejtësisë, në fakt, gjithmonë kam qenë sensibil kur njerëzit, klientët, qoftë edhe palët, gjatë kohës që isha ndihmësgjyqtar, shanin drejtësinë, gjyqtarët, prokurorët. Kërkoja që të ishin më të sigurt te drejtësia që merrnin.

Me aneksin e Kushtetutës, në fakt, kam gjetur veten. Kam parë që duhet të bëj diçka. Unë jam pjesë e këtij sistemi, e kësaj drejtësie, të aneksit kushtetues dhe të ligjit nr. 84. M'u duk se kam diçka për të dhënë dhe besoj që me figurën time dhe me profesionalizmin tim, me punën time... Kjo më ka shtyrë të aplikoj dhe të paraqes interes.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Hajdari!

A ka pyetje, kolegë?

Po, zoti Bushati...

Ervin Bushati – A keni ndonjë lidhje me politikën?

Ardian Hajdari – Asnjë lidhje. Absolutisht, asnjë lidhje!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Ardian Hajdari – Asnjëherë nuk kam pasur.

Vasilika Hysi – A ka pyetje të tjera? A t'ju bëj unë një pyetje?

Ardian Hajdari – Po, faleminderit!

Vasilika Hysi – Një nga kërkesat e ligjit është që në përzgjedhjen e kandidatëve, sidomos në këto institucione, duhet të merret parasysh jo vetëm përmbushja e kriterëve formale, por edhe një listë e kriterëve të tjera, si: titujt shkencorë, përvoja e veçantë e kandidatit në fushën e së drejtës, vjetërsia në profesion, kualifikimet brenda dhe jashtë vendit.

Mund të na thoni diçka më shumë për grupin e dytë të kriterëve që parashikohen në ligj?

Ardian Hajdari – Faleminderit!

Faktikisht nuk kam asnjë titull të mbrojtur. Nuk i gëzoj këto... Nuk është se më mungojnë, por nuk i kam. Disa kualifikime si avokat i kam bërë, por... Kaq.

Eduard Halimi – Kam një pyetje.

Vasilika Hysi – Po.

Eduard Halimi – Sa vjet kishe avokat, Ardian?

Ardian Halimi – Qysh në vitin 2000, në maj të vitit 2000. Afërsisht 17 vjet.

Eduard Halimi – Afërsisht, sa çështje mbroni ju?

Ardian Halimi – Urdhëro?

Eduard Halimi – Sa çështje keni mbrojtur afërsisht? A keni ndonjë numër? 100, 200... Sa?

Ardian Hajdari – Më shumë. Unë s'i kam numëruar, por besoj se 100 çështje janë në vit.

Eduard Halimi – A keni mbrojtur çështje në Gjykatën e Lartë?

Ardian Hajdari – Po, në Gjykatë të Lartë po.

Eduard Halimi – Sa? Apo edhe ato nuk ... Ka një numër?

Ardian Hajdari – Ato janë më të kufizuara. Ndoshta 10,15,20...

Eduard Halimi – Në vit?

Ardian Hajdari – Që të mos... Për të qenë i sinqertë me ju, gjithsej.

Eduard Halimi – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Keni pyetje, kolegë?

Faleminderit, zoti Hajdari!

Ardian Hajdari – Faleminderit juve!

Vasilika Hysi – Do të njoftoheni nëpërmjet medias për seancën e votimit.

Ardian Hajdari – Ju faleminderit!

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit!

Atëherë, ftojme kandidaten tjetër, zonjën Brunilda Bekteshi Vasha, e cila konkurren për të gjitha pozicionet.

Mirë se erdhët, zonja Bekteshi Vasha!

Brunilda Bekteshi Vasha – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Anëtarët e komisionit kanë përpara dosjen me CV-në tuaj. Do të doja të dija, se përse duhet t'ju votojmë juve për Kolegjin e Posaçëm të Apelit?

Brunilda Bekteshi Vasha – Mendoj që eksperiencia ime në fushën e drejtësisë ka një përvojë të veçantë lidhur me mbulimin e disa aspekteve po të veçanta në fushën e drejtësisë, duke prekur gjykatën në përfaqësim, prokurorinë në çështjet penale, të drejtën tregtare. Nisur nga eksperiencia ime 15-vjeçare dua të kontribuoj për të qenë anëtare e Kolegjit të Apelit.

Vasilika Hysi – A ka pyetje, kolegë?

Po, zoti Bushati...

Ervin Bushati – CV-në e kemi përpara, por është një pyetje që ua bëjmë të gjithë të intervistuarve, a keni lidhje me politikën?

Brunilda Bekteshi Vasha – Jo. Aspak.

Vasilika Hysi – Po, zoti Halimi...

Eduard Halimi – Zonja Bekteshi, kam një pyetje. Unë shikoj në CV që ju keni... Sa vjet keni tek OSHEE-ja?

Brunilda Bekteshi Vasha – 15 vjet.

Eduard Halimi – 15 vjet.

Brunilda Bekteshi Vasha – Më shumë, 16 vjet...

Eduard Halimi – Atëherë, si mendoni ju? Ju keni 16 vjet si juriste në OSHEE. A mendoni që një juriste me 16 vjet në OSHEE duhet të bëjë vetingun e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese?

A ka aftësinë për të analizuar cilësinë e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese një juriste e OSHEE-së?

Brunilda Bekteshi Vasha – Po, unë mendoj...

Eduard Halimi – Sepse ju merreni (për sa njoh unë, se jam vetë jurist) vetëm me faturat, me gjyqet dhe me faturat, ndërkohë që Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese ka gamë pafundësisht.

Ju, ndonjë çështje penale, ndonjë çështje pronash... Një juriste e OSHEE që kërkon të analizojë vendimet e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese?! Këtë keni ju, 16 vjet juriste në OSHEE. Apo jo?

Ashtu tha, 16 vjet në OSHEE. Apo jo?

Brunilda Bekteshi Vasha – Po, po.

Vasilika Hysi – Jo, ka punuar edhe në Ministrinë e Jashtme.

Po. Mund të thoni diçka më shumë, ju lutem?

Brunilda Bekteshi Vasha – Sektori publik, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në veprimtarinë e tij prek shumë marrëdhënie biznesi, civile, penale dhe tregtare. Unë mendoj që pozicioni dhe angazhimet e mia në këtë detyrë, sikurse dhe e thashë, prekin shumë fusha të së drejtës, të cilat i kam kryer gjatë gjithë eksperiencës sime 15- vjeçare. Nuk është se merrem vetëm me fatura, por kam qenë në përfaqësimin e çështjeve civile, në prokurori. Aktualisht jam në komisionin për ndarjen e kësaj shoqërie në kuadër të liberalizimit të tregut dhe mendoj se kam eksperiencën e mjaftueshme për të qenë anëtare e Kolegjit të Apelit.

Eduard Halimi – ... se nuk e gjej dot. Kur e keni mbrojtur anglishten?

Brunilda Bekteshi Vasha – Unë kam bërë një kurs në '99, fill mbas shkollës kam bërë kualifikimin.

Eduard Halimi – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Kam një pyetje, zonja Bekteshi.

Të jesh anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është përgjegjësi shumë e madhe. Anëtari është në nivelin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili do të shqyrtojë të gjitha ankesat e komisioneve të tjera.

Brunilda Bekteshi Vasha – Po.

Vasilika Hysi – Ligji ka vendosur disa kritere lidhur me formimin, jo vetëm juridik, por edhe me formimin profesional. Do të doja diçka më shumë lidhur me kualifikimet, punën kërkimore-shkencore, me praktikën e të drejtave të njeriut, kritere që i ka neni 6, pika 2 e ligjit, ku thuhet: “...përvoja studimore profesionale jashtë shtetit, tituj shkencorë në fushën e së drejtës, përvoja e veçantë e kandidatit në sfera të caktuara të së drejtës”, përveç punës që ju keni bërë.

A keni diçka më shumë për të shtuar?

Brunilda Bekteshi Vasha – Po. Unë kandidoj për të qenë anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me CV-në, me eksperiencën time, duke nisur që nga mbarimi i studimeve të larta për drejtësi në vitin '99, që me ligjin “Për arsimin” ekuivalimi i masterit njihet, sepse janë 4 vjet akademikë. Sikurse thashë edhe më parë, në angazhimet e mia profesionale kam prekur shumë çështje të veçanta të sferës të së drejtës dhe mendoj se përmbush një nga pikat e nenit 2, të eksperiencës, që është përvojë e veçantë. Ky është kualifikimi im.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Brunilda Bekteshi Vasha – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Ditën e mirë!

Atëherë, ftojme zotin Elvis Zaimi, i cili përsëri konkurren për të gjitha pozicionet. Përpara keni CV-në dhe dosjen përkatëse.

Mirë se erdhët, zoti Zaimi!

Elvis Zaimi – Mirëdita të gjithëve!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Për ju është intervista e dytë, por tashmë përpara një komisioni tjetër. Unë do të doja t’ju bëja një pyetje në emër të të gjithë kolegëve të komisionit, pastaj kolegët kanë pyetje të veçanta, se përse duhet t’ju votojmë juve për në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit?

Elvis Zaimi – Atëherë mendoj që procesi i rivlerësimit, procesi i vetingut është një proces që ngrihet mbi prezumimin që sektori, pushteti gjyqësor ka **nevojë** për reformim. Ky proces do të bëhet në 3 komponentë të tij. Do të bëhet në komponentin e vlerësimit profesional, në komponentin e vlerësimit të legjitimitetit të pasurive, domethënë jo thjesht të

ligjshmërisë, të justifikimit formalo-ligjor të pasurisë. Do të bëhet edhe në komponentin tjetër të vlerësimit të kontrollit të figurës. Specifika e këtij procesi është që të gjitha subjektet do të kenë të drejtën të ankohen dhe në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo nënkupton se vendimet që duhet të marrin organet e pavarura, që ka parashikuar Kushtetuta, duhet të jenë vendime që merren në bazë të parimit të drejtësisë të individualizuar. Domethënë që për çdo objekt rivlerësimi të respektohet ajo që është kriteri themelor, kriteri i objektivitetit dhe i proporcionalitetit. Domethënë, në qoftë se do të më lejoni të përdor një metaforë, duhet ndarë gruri nga egjra në çdo rast individual të veçantë, duke respektuar në analizë të fundit procesin e rregullt ligjor dhe dinjitetin e çdo subjekti të rivlerësimit. Domethënë kërkojmë “shëndoshjen e pushtetit gjyqësor”, nuk kërkojmë stigmatizimin e individëve të veçantë.

Pra, procesi duhet të jetë i paanshëm, sa më objektiv dhe sa më profesional. Ata që do të jenë të angazhuar në këto struktura do të gjykojnë, do të kenë një qasje të skepticizmit profesional që të dikton vetë konfigurimi kushtetues në konsensusin që është arritur, që ngrihet mbi një prezumim që ky pushtet, kështu siç është, nuk është në lartësinë e standardeve demokratike. Duke qenë se është një nga shtyllat kryesore të demokracisë nuk i shërben popullit, nuk i shërben kombit që është mbartës i sovranitetit. Prandaj unë mendoj që kam njohuri të thelluara, karriera dëshmon që kam njohuri të thelluara në kontrollin e pasurive. Pra, kam njohuri të posaçme që kanë të bëjnë me vetë natyrën e eksperiencës sime unike si jurist në Bankën Qendrore.

Kam pasur në të shkuarën edhe përgjegjësi të tjera të rëndësishme. Për shembull, kam qenë juristi që jam kujdesur për investimin e rezervave valutore të Bankës së Shqipërisë në kontratat derivative që janë instrumente tepër specifike. Janë instrumente me shumë risk dhe ia kam dalë mbanë. Kam drejtuar sektorin e çështjeve bankare në kohët e krizës së madhe financiare. Aty kam qenë draftues i shumë ndryshimeve, i ligjit aktual për bankat, i shumë akteve ligjore, nënligjore. Domethënë të vendimeve të marra mbi bazën e një vlerësimi objektiv të rrethanave specifike të rastit dhe kam qenë i suksesshëm. Po ashtu dhe karriera ime e dëshmon këtë gjë, është shquar për korrektesë, për profesionalizëm, për paanësi. Kam qenë i punësuar me konkurrim publik, të hapur, transparent në bazë të nenit 107 të Kushtetutës që garanton aksesin e barabartë në administratën publike. Për të gjitha praktikatat e mia profesionale, që janë kaluar nga unë, asnjëherë nuk ka pasur vërejtje për to qoftë edhe nga institucione që kryejnë kontrollin e jashtëm administrativ dhe gjyqësor të institucionit. Përkundrazi, janë konfirmuar si tepër korrekte.

E njoh mënyrën se si funksionon gjykimi kushtetues. Vetëm vitin që kaloi kam qenë i pajtuar si ekspert. Sapo ka dalë në publik një botim, një përmbledhje e kauzës dhe e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut. Njoh edhe standardet mbi të cilat Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut arrin drejtësinë e individualizuar qoftë në procesin delikat të marrjes së provave, që është kontestuar dhe çështja shkoi në Gjykatën Kushtetuese, qoftë në vendosjen e balancës së drejtë, balancës së duhur ndërmjet respektimit të së drejtës së individit, të subjektit të rivlerësimit dhe respektimit të atij që është objektivi i këtij ligji, që është shëndoshja e gjendjes në pushtetin gjyqësor. Pra, një drejtësi që funksionon në mënyrën e duhur, një drejtësi e vërtetë, e pavarur, e paanshme nga çdo lloj ndikimi.

Vetë kam qenë një nga juristët e angazhuar në argumentimet përpara Gjykatës Kushtetuese kur është sfiduar kontrata e kredisë si titull ekzekutiv. Me argumentet që kemi dhënë kemi arritur ta bindim Gjykatën Kushtetuese që nuk ka shkelje të parimit të barazisë së palëve, por diskriminimi pozitiv ishte në funksion të mbrojtjes së një interesi publik, të stabilitetit, të sistemit bankar dhe financiar.

Vasilika Hysi – Zoti Zaimi, pak më shkurt ju lutem, se ne e kemi dosjen tuaj përpara.

Elvis Zaimi – Për ta përmbledhur, ajo që është specifike e punës që kam bërë është se kam qenë jurist. Gjithmonë jam nisur, kam gjykuar nga nisur faktet. Përvoja profesionale-studimore që kam pasur qoftë dhe jashtë shtetit, di me çfarë standardesh operojnë ato gjykata ku ne duam që gjykatat të shkojnë.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Ka pyetje? Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – A keni lidhje me politikën? Kjo është një pyetje që ua bëjmë të gjithëve.

Elvis Zaimi – Unë nuk kam kurrfarë lidhjeje me politikën.

Ervin Bushati -Ju keni një investim në Bankën e Shqipërisë, me sa shoh unë në CV-në tuaj. Pra, dhe një orientim drejt këtij institucioni që ka të bëjë me monetarizmin, me bankën, me financat. Çfarë ju bëri të ndryshoni drejtim në vitin 2016? Vazhdon në Bankën e Shqipërisë?

Elvis Zaimi – Jo, nuk jam më.

Ervin Bushati – Unë thashë se nga viti 2003, në korrik deri në janar të vitit 2016, keni qenë në Bankën e Shqipërisë. Çfarë ju bëri që të ndryshoni orientim, drejtim profesional? Nuk thashë pse keni ikur.

Elvis Zaimi – Unë mbylla një cikël, por fakti që unë nuk jam i punësuar në Bankën e Shqipërisë, nuk do të thotë që unë nuk jam pjesë e komunitetit të juristëve, të specialistëve, të së drejtës bankare dhe financiare. Unë jam vazhdimisht pjesë e atij komuniteti dhe besoj se do të ngelem për një kohë të gjatë.

Vasilika Hysi – Po, zonja Vokshi.

Albana Vokshi – Ku punoni aktualisht, se nuk e gjej në CV-në tuaj.

Elvis Zaimi – Aktualisht nuk kam marrëdhënie të punës së varur që rregullohet nga një kontratë pune, por kam konsulenca, ekspertizë. Sapo e përmenda një.

Albana Vokshi – Është deri në gusht të vitit 2016. Kjo thjesht për saktësim.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Për ditën e votimit do të njoftoheni nëpërmjet medias.

Kalojmë te kandidatura tjetër. Zonja Emira Koçu Deçka.

Mirë se erdhët zonja Ermira! Mund të flisni shumë shkurt, pasi kolegët, anëtarët e komisionit e kanë përpara dosjen tuaj, CV-në. Pra, e kanë studiuar në mënyrë të detajuar. Pse duhet t'ju votojnë juve për në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit? Ju keni konkurrar vetëm për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

Ermira Koçu Deçka – Mendova se kjo do të ishte pyetja e fundit që do të më bëhej. Unë kam konkurrar vetëm për Kolegjin e Apelimit, sepse jam e vendosur dhe e guximshme për të marrë përsipër përgjegjësi që lidhen absolutisht me fatin e kombit në fushën e drejtësisë, por edhe të gjeneratave që do të vijnë më pas. Dhe them se diferenca në këtë pjesë është guximi im, për pjesën e integritetit profesional dhe moral, por gjithashtu edhe guximi për ta çuar përpara këtë si proces, për ta bërë ashtu siç duhet.

Vasilika Hysi -A mund të thoni diçka më shumë, me formimin tuaj, kualifikimin, si mund të kontribuoni? Kjo, sepse kolegët duhet të binden për këtë gjë. Pse duhet t'ju votojnë juve? Jo thjesht integriteti. Ligji ka disa kritere, kushte.

Ermira Koçu Deçka – Absolutisht integriteti ishte njëra prej tyre. E para që rendita është tek integriteti profesional dhe jo ai moral. Kam mbaruar Fakultetin e Drejtësisë në vitin 2000. Më pas kam kryer master shkencor lidhur me të drejtat e njeriut, në Francë, që është shoqëruar më pas me praktikë në organizata të tjera ndërkombëtare.

Kam pasur nderin të punoj në një proceset e fillimit të integritetit europian, ndër stafet e para në vitin 2001 për të cilën përveç faktit që jam krenare, ndihem dhe shumë e motivuar për të vazhduar më pas me një proces të ri, siç është ky i vlerësimit të prokurorëve dhe të gjyqtarëve. Më pas karrierën time profesionale e kam vazhduar me përkushtim dhe devotshmëri pranë Organizatës për “Siguri dhe Bashkëpunim në Europë”, si këshilltare

ligjore për çështjet e pronave dhe jo vetëm. Më pas, pas një procesi të gjatë rekrutues, kam punuar dhe vazhdoj aktualisht të punoj pranë Agjencisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik si drejtuese projekti.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati - Unë kam një pyetje që ua bëjmë të gjithë kandidatëve. A keni lidhje me politikën?

Ermira Koçu Deçka – Jo, nuk kam asnjë lidhje.

Ervin Bushati - Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit! Ditë të mbarë!

Kalojmë te kandidatura tjetër. Etleva Papekaj.

Zonja Papeka kandidon për të gjitha pozicionet.

Mirë se erdhët, zonja Papeka!

Anëtarët e komisionit e kanë përpara dosjen e depozituar, sjellë nga Avokati i Popullit. E kanë studiuar dosjen tuaj. Dua shumë shkurt të thoni diçka më shumë për t'i bindur anëtarët e komisionit për t'ju votuar ju për një nga pozicionet. Ne votojmë për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Ndërsa për pozicionet e tjera do të intervistoheni, do të votoheni në komisionin tjetër.

Etleva Papekaj - Faleminderit!

Unë kam 17 vjet eksperiencë. Po e nis me edukimin.

Kam mbaruar Universitetin Luigj Gurakuqi, sistemi 4-vjeçar, me 240 kredite me mesatare 9,1.

Në vitet 2009-2011 jam regjistruar me konkurs pranë Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë, për master, ku kam mbaruar masterin me mesatare 9,7 dhe kam mbrojtur temën e doktoraturës me titull: “Qeverisja elektronike dhe modernizimi i administratës publike”, nga ku rekomandimi i komisionit ka qenë për t’u botuar. Vlerësimi ka qenë që masteri ishte në nivel doktore.

Në tetor të vitit 2012 kam regjistruar studimet e doktoraturës dhe dje kam mbrojtur tezën e strukturës së doktoraturës pranë Universitetit të Prishtinës. Tema është: “Dinamika dhe rishikimi i Kushtetutës për stabilitet të qëndrueshëm”, aspekte krahasuese.

Gjatë periudhës tetor-nëntor 2016 për punë kërkimore kam qenë pranë Universitetit të Harvard-it për një muaj në kuadër të temës së doktoraturës. Në fund të qershorit do të shkoj për 5 javë pranë Universitetit Princeton në vazhdim të studimeve të doktoraturës.

Përsëri për sa i përket edukimit, në prill të vitit 2017 kam paraqitur pranë Konferencës së Përgjithshme të Oslos një abstrakt. Atje u paraqitën 3300 abstrakte, dhe abstrakti im doli fitues.

Në shtator të vitit 2017 do të mbaj një referat mbi temën: “Çfarë do të thotë të bësh politikë jashtë politikës”, ku do të jem dhe presidentja e panelit.

Në lidhje me eksperiencën në punë, gjatë viteve 2000-2001 kam qenë asistent-avokate. Gjatë periudhës 2002-2004 kam qenë juriste dhe koordinatorë pranë Fondacionit “Shpresë për votën”. Gjatë periudhës 2004-2009 kam qenë juriste pranë Fondacionit “Shpresë për Votën” dhe kam jetuar në Amerikë për 6 vjet.

Në vitin 2009 kam filluar punë në administratën publike pranë këshillit të qarkut Shkodër. Kam filluar si përgjegjëse e urbanistikës ligjore. Në vitin 2010 kam qenë drejtoreshë e Drejtorisë së Hartimit dhe e Monitorimit të Projekteve. Në vitin 2016 kam qenë sekretare e Përgjithshme pranë institucionit të këshillit të qarkut Shkodër. Siç e shikoni dhe nga materiali i paraqitur, kam qenë dhe kryetare në një sërë komisionesh, që nga komisioni i censusit të popullsisë, të banesave, kam qenë kryetare e sekretariatit të Njësisë së Përgjithshme të Bujqësisë dhe të Blegtorisë. Kam botuar një sërë punimesh shkencore si në Shqipëri ashtu edhe jashtë. Pra, botime në gazeta, revista kombëtare dhe ndërkombëtare.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

A ka pyetje? Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati - Unë kam një pyetje që ua bëjmë të gjithë kandidatëve. A keni lidhje me politikën?

Etleva Papekaj - Jo, nuk kam asnjë lidhje me politikën.

Vasilika Hysi – Një pyetje kam dhe unë. Ju thatë që keni jetuar Amerikë. Keni qenë për arsye pune apo ...

Etleva Papekaj - Vizita ka filluar për arsye mjekësore. Pastaj kam punuar si juriste pranë Fondacionit “Shpresë për Votën”.

Vasilika Hysi – E bëra pyetjen zonja Papeka, pasi në CV-në tuaj nuk e gjej një periudhë bosh dhe nuk dilte e qartë periudha që ju sapo e përmendët. Nuk rezulton që ju keni punuar, keni ushtruar profesionin, prandaj dhe ju pyeta.

A ka pyetje të tjera? Nuk ka. Faleminderit!

Ftoj zonjën Fatmira Luli. Mirë se erdhët, zonja Luli!

... jeni para komisionit *ad hoc* për përzgjedhjen dhe votimin e anëtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Ju keni aplikuar për të gjitha pozicionet. Ne jemi të interesuar të dimë

diçka më shumë se dosja dhe CV-ja juaj. Pra, pse ne duhet t'ju votojmë ju për anëtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Fatmira Luli – Unë që kur kam aplikuar kam menduar se i plotësoj kriteret dhe kushtet e nevojshme, kam eksperiencën dhe motivimin që ta bëj këtë detyrë, për faktin se kam punuar dhe e njoh shumë mirë sistemin gjyqësor. Kam punuar në të gjitha fushat e sistemit gjyqësor si gjyqtare, kam punuar si pedagoge lektore, si dhe në kontrollin e gjyqësorit në Ministrinë e Drejtësisë në pjesën e procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe i kam të tëra kualitetet e nevojshme që të vazhdoj dhe ta bëj këtë punë. Jam e motivuar edhe për faktin se i njoh problemet që ka sistemi gjyqësor për shkak të punës që kam bërë këto vite në avokati dhe di se ku çalojnë problemet, kështu që për këtë shkak gjykoj se do t'i jap një shërbim këtij aktiviteti për reformimin e sistemit gjyqësor.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Luli!

A ka pyetje?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Ne e kemi CV-në dhe eksperiencën tuaj në gjyqësor dhe për këtë arsye kam një pyetje, të cilën ua bëjmë të gjithë kandidatëve: a keni lidhje me politikën?

Fatmira Luli – Nuk kam pasur dhe nuk kam asnjë lidhje. Nuk jam aktivizuar asnjëherë në asnjë forum, në asnjë funksion si këshilltare apo shefe kabineti dhe nuk kam pasur kurrë lidhje me politikën.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Vasilika Hysi – A kanë pyetje kolegët? Nuk kanë.

Faleminderit, zonja Luli dhe ditën e mirë!

Ftojme zonjën Firdes Shuli.

Mirë se erdhët zonja Shuli!

Ju keni aplikuar për të gjitha pozicionet. Ne jemi komisioni, i cili do të dëgjojë, do të përzgjedhë dhe do të votojë anëtarin që do t'i sugjerojmë seancës për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Përpara kemi CV-në dhe dosjen tuaj. Unë dhe zoti Noka kemi pasur mundësinë t'ju dëgjojmë edhe në një seancë të mëparshme, prandaj do doja shumë shkurt pse ky komision duhet t'ju votojë juve për në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit?

Firdes Shuli – Faleminderit!

Unë jam diplomuar në Universitetin Shtetëror të Tiranës në vitin 1988 si juriste dhe jam emëruar direkt në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë si gjyqtare, ku kam punuar për një periudhë 7-vjeçare si gjyqtare në këtë gjykatë, ku për një afat prej 3 vjetësh kam qenë edhe

kryetare e kësaj gjykate. Në vitin 1995, pasi jam liruar nga sistemi gjyqësor me kërkesën time për arsye shëndetësore kam marrë licencën e avokates dhe kam punuar 1 vit si avokate dhe në vitin 1996 deri më sot jam anëtare e Dhomës së Noterëve të Gjirokastrës, ku ushtroj profesionin e lirë të noterës. Gjatë kësaj periudhe për 3 vjet kam dhënë mësim si pedagoge e jashtme në universitetin “Eqerem Çabej” të Gjirokastrës. Dy legjislaturat e fundit kam qenë anëtare e Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe në legjislaturën e fundit jam zgjedhur në kryesinë e Dhomës Kombëtare të Noterëve të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë këtyre 28 vjetëve që kam punuar në sistemin e drejtësisë mendoj dhe jam e bindur se i kam kryer detyrat që më janë ngarkuar me sukses, me eficiencë dhe efektivitet të plotë, e distancuar rreptësisht ndaj çdo lloj individi apo subjekti, nga çdo lloj veprimi apo mosveprimi, të cilat mund të komprometonin sadopak veprimtarinë time qoftë gjatë gjyqimit të çështjeve në periudhën që kam qenë gjyqtare, si dhe gjatë periudhës ku kam ushtruar detyrën e noterës në redaktimin e akteve noteriale. Pra, mendoj se e gjithë kjo periudhë prej 28 vjetësh që unë kam punuar në sistemin e drejtësisë ka bërë që unë të përfitoj eksperiencën dhe një përvojë profesionale të mjaftueshme, për të më krijuar mundësinë për shqyrtimin, analizimin, gjykimin, mbledhjen, grumbullimin e provave në gjykimin e një çështjeje konkrete për marrjen e një vendimi përfundimtar të bazuar në prova dhe në ligj.

Më falni, nëse më lejoni, doja të shtoja, pasi kam lexuar me vëmendje ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve” kam konstatuar dy gjëra të rëndësishme:

E para, rëndësinë e jashtëzakonshme që ka ky ligj në rivendosjen dhe në garantimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë, në ngritjen e një sistemi drejtësie të lirë dhe të pavarur nëpërmjet shqyrtimit të subjekteve të së drejtës që janë gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët vijnë nga një eksperiencë e gjatë jetësore, kanë dhënë kontributin e tyre dhe vazhdojnë ta japin në sistemin e drejtësisë dhe do të jenë këto institucione, të cilat do të vendosin përfundimisht në bazë të kriterëve që ligji përcakton nëse këta gjyqtarë apo prokurorë do të vazhdojnë të jenë pjesë e këtij sistemi apo do të largohen përfundimisht nga ky sistem. Ajo që mua më ka bërë përshtypje te ky ligj janë përgjegjësitë rigoroze shumë të forta për anëtarët e këtyre institucioneve, sidomos neni 16 i këtij ligji, i cili përcakton...

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni! Ndoshta nuk është e domosdoshme...

Vasilika Hysi – Unë kam përpara orën, zonja nuk e ka bërë ende minutazhin, prandaj po e kontrolloj vazhdimisht celularin.

Firdes Shuli – Më falni! Ajo që doja të thosha është se jam e bindur se të qenit pjesë e këtyre institucioneve, për mua personalisht është një sfidë goxha e vështirë që kërkon një përgjegjshmëri të lartë njerëzore, kërkon një profesionalizëm të lartë, integritet etik, moral dhe profesional, të cilat nëse unë do të jem pjesë e këtyre institucioneve besoj se do t'i kem.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Shuli!

Mos u shqetësoni për kolegët, ju keni shpenzuar vetëm 3 minuta kohë. A ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Kisha një pyetje, të cilin ua bëjmë të gjithë kandidatëve: a keni ju lidhje me politikën?

Firdes Shuli – Absolutisht jo. Kam qenë gjithmonë e distancuar dhe e painteresuar në të gjithë jetën time në politikë.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Firdes Shuli – Këtë e them me bindje absolute.

(Diskutime pa mikrofon)

Absolutisht, jo.

Vasilika Hysi – Kolegë, ju lutem, shakatë politike t'i bëjmë mes nesh në pushimin e kafesë dhe jo me kandidatët. A keni pyetje të tjera? Nuk ka.

Faleminderit, zonja Shuli!

Ditë të mbarë!

Firdes Shuli – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Radhën e ka zoti Genc Bilali. Në fakt, zoti Bilali jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është kontaktuar dhe e ka të pamundur për të ardhur për intervistë.

Kalojmë në kandidaturën tjetër, zonja Genta Tafa Bungo.

Mirë se erdhët zonja Tafa!

Ju keni konkurruar për të tria pozicionet. Ne jemi komisioni, i cili do të dëgjojë dhe do të votojë për në listën për votim vetëm për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Dosjen dhe CV-në tuaj e kemi, unë dhe zoti Noka ju kemi dëgjuar, prandaj diçka shumë shkurt për pjesën tjetër të komisionit. Nëse keni diçka tjetër për të shtuar është: pse duhet t'ju votojmë juve për të qenë anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit?

Genta Tafa Bungo – Faleminderit!

Unë jam juriste që nga viti 1993. Aktualisht kam gradën Profesor i Asociuar dhe jam e specializuar në fushën e tatimeve si pedagoge e së drejtës financiare dhe bankare që nga viti

1996 e deri më sot. Aktualisht kam një studio përmbarimore dhe kam licencën e përmbaruesit. Pra, pse duhet të më zgjidhni mua? Është organ kolegjal dhe unë i vlerësoj të gjithë kandidatët e tjerë, ku gjithsecili do të sjellë vlerat e veta, por ajo që sjell unë në këtë organ kolegjal, së pari është integriteti që është pjesë e pandashme e karakterit tim dhe kush më njeh e ka shumë të qartë.

Së dyti, personalisht mendoj se duhet të jem pjesë e Kolegjit të Apelit kryesisht për këto arsye:

Duke qenë se vij nga bota akademike jam specializuar në fushën e vlerësimit të dijeve dhe të njohurive të tjerëve, pra të studentëve.

Së treti, duke qenë se jam e specializuar dhe kam doktoraturë në fushën e tatimeve të dyfishta dhe në fushën e së drejtës financiare, jam gjendje të lexoj shumë mirë deklaratat e të ardhurave, pagesat e tatimeve, kontratat e kredive bankare e të tjera të kësaj fushe që mbulojnë të drejtën financiare dhe bankare.

Së katërti, mendoj se puna ime si përmbaruese prej 4 vjetësh më ka bërë të njoh shumë mirë praktikën, të kuptoj si funksionojnë disa mekanizma të mbidheshëm dhe të nëndheshëm, prandaj mendoj se jam një kandidatë shumë e mirë që meritoj besimin tuaj dhe të publikut.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Tafa!

A ka pyetje, kolegë? Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Pyetjen që ua bëjmë të gjithë kandidatëve: a keni ju lidhje me politikën?

Genta Tafa Bungo – Jo, nuk kam lidhje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Tafa!

A ka pyetje të tjera?

Zoti Halimi, thotë se e ka pasur pedagoge, ndërsa unë e kam pasur...

Genta Tafa Bungo – Ju më keni udhëhequr në diplomën e fakultetit në vitin 1993.

Vasilika Hysi – Nuk kam asnjë pyetje dhe koment.

Faleminderit, zonja Tafa!

Ditën e mirë!

Genta Tafa Bungo – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Mirë se rierdhët, zonja Rama! Jeni përpara komisionit, i cili do të dëgjojë dhe do të bëjë votimin për në seancë të anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit. Ne kemi para dosjen dhe CV-në tuaj. Unë dhe zoti Noka kemi pasur mundësinë t'ju kishim edhe në një seancë tjetër dëgjimore, prandaj doja të dija shumë shkurt pse ne

duhet t'ju votojmë ju për të qenë anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit? Pra, do të doja diçka më shumë seç keni në dosje.

Ina Rama – Në fakt, do të thosha se pse unë kam shfaqur interes për të qenë pjesë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndërsa më pas në vendimmarrjen për përzgjedhjen, arsyet do t'i keni dhe do t'i rendisni ju, nuk besoj se unë mund të jap informacion ose ndonjë detaj në lidhje me këtë.

Unë besoj se shprehja ime e interesit për të qenë anëtare e këtij kolegji lidhet me eksperiencën time, me investimin tim profesional dhe jetësor, duke qenë shumë e ndërgjegjshme për të gjithë përgjegjësinë e ushtrimit të funksionit të anëtarit të Kolegjit të Posaçëm. E shoh si një moment shumë të rëndësishëm për zhvillimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe mendoj që kontributet jetësore dhe profesionale ma lejojnë, ma justifikojnë dhe ma bëjnë të mundur ta shpreh këtë interes.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

A ka pyetje kolegë? Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Kam një pyetje, të cilën unë të paktën ua bëj të gjithë kandidatëve: a keni lidhje me politikën?

Ina Rama – Jo, nuk kam asnjë lidhje me politikën.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Po, zoti Noka.

Flamur Noka – Po vazhdoj me një pyetje, të cilën e kemi lënë përgjysmë radhën e kaluar. E gjithë karriera është e ndërtuar dhe ka funksionuar në vitet e mëparshme deri më sot në sistemin e drejtësisë, siç e kam thënë dhe po e përsëris ju keni mjaft akuza politike në drejtimin suaj gjatë karrierës suaj dhe gjatë kulmit të karrierës suaj, por pyetja që unë kam konsiston këtu, e shihni veten se mund të ndërtoni drejtësi të re ndërkohë që vini nga ajo që Kryeministri e quan “drejtësia e kalbur”?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Noka!

Ju lutem, mos i fusni kandidatët në debate politike, në fushatë jemi ne, nuk janë kandidatët në fushatë.

Ju lutem, zonja Rama!

Ina Rama – Në fakt, siç tha edhe zoti Noka, meqë unë një përgjigje koncize të pyetjes e dhashë në seancën tjetër, më duhet ta elaboroj tani. Unë e shoh veten, zoti Noka, sinqerisht, në pjesën e shëndetshme të sistemit të drejtësisë për të gjithë kohën që kam qenë pjesë e tij. E shoh këtë, sepse ushtrimin e detyrave të mia e kam bërë me përkushtim të plotë, me ndërgjegje edhe në përputhje me ligjin. Gjithashtu, e shoh edhe për faktin sepse nuk

gjykoj dhe nuk mendoj se i gjithë sistemi i drejtësisë është një gjë e kalbur, sistemi i drejtësisë ka personazhe, individë me integritet, ka grupime shumë të mira, sigurisht siç ka edhe problematikat e tij. Të qenurit në sistemin e drejtësisë deri në ditën që unë kam punuar nuk do të thotë të ndihesh keq, nuk do të thotë që të bëhesh pjesë e pjesës ku të gjithë faktorët po e konsiderojnë si një pjesë që duhet rivlerësuar, duhet apo nuk duhet konfirmuar në detyrë. Sigurisht, e shikoj veten time si pjesë, ose të paktën unë shpreh interes për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, siç jua thashë edhe seancën e kaluar, jo vetëm si anëtare e institucioneve të rivlerësimit në qoftë se ky është një proces që mund të rezultojë i suksesshëm nën drejtim tim, por edhe si një gjyqtare në gjykatën ku unë duhet të kthehem për shkak të zbatimit të një vendimi gjyqësor.

Pra, pa shtigje të tjera daljeje unë e shoh veten vetëm një sistemin e drejtësisë personalisht, patjetër e shoh veten edhe në drejtësinë e re në këtë formë ose në një formë tjetër, duke qenë gjyqtare në sistemin e drejtësisë.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Rama!

A ka pyetje të tjera? Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Kam dy pyetje për zonjën Rama. E para, ju keni qenë 5 vjet prokurore e Përgjithshme, apo jo, ndërsa këtu pretendoni që të jeni anëtare e komisionit të rivlerësimit të prokurorëve që do të fusë në karantinë në mos gaboje 300 prokurorë, diçka e tillë...

Ina Rama – 330 duhet të jenë.

Eduard Halimi – Pra, do të fusë në karantinë 330 prokurorë. Gjatë 5 vjetëve që ju ishit në detyrë, a e bëtë këtë karantinë? E kishit mundësinë ta bënit edhe kompetenca ekskluzive kishit, gjithashtu. Sa prokurorë propozuat te Presidenti i Republikës për t'u shkarkuar? Sa shkarkuat ju, sepse e kishit në dorë këtë gjë? Kjo ka të bëjë me besimin e publikut, zonja Rama, pra për njerëz që u është dhënë një herë mundësia për ta bërë një gjë të tillë. Kur ju u emëruat atëherë, besoj se me këtë qëllim vajtët, apo jo, me qëllimin të përmirësimit të sistemit të prokurorisë edhe pjesën tjetër, apo jo?

Së dyti, ne do t'i përzgjedhim kandidatët dhe do të votojmë secili me nga një votë për të zgjedhur nga një anëtar në Komisionin e Apelit. Ju a mendoni mendoni se ndonjëri nga ne të tre mund t'jua japë votën?

Ina Rama- Sigurisht që e mendoj, pse jo?

Eduard Halimi- Të mbaroj pyetjet njëherë.

Ina Rama – U përgjigja, meqë e pata për kollaj përgjigjen e kësaj pyetje.

Eduard Halimi- A mendoni se ndonjëri nga ne të tre do të votojë për ju? Apo mendoni të votojnë këtej nga krahu tjetër?

Ina Rama- Unë mendoj se edhe nga ju mund të më votojnë. Pse jo? Ky është mendimi im.

Kjo ishte përgjigjja e pyetjes së dytë.

Përgjigjja e pyetjes së parë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, unë nuk kam kapur asnjë njeri për këtë proces, zoti Halimi. Unë absolutisht që nuk e shikoj veten të përjashtuar nga vota e anëtarëve të opozitës. Parimisht flasim, sepse nuk gjykoj se kam motive të qenësishme për ta përjashtuar veten, pastaj se si do t'i përzgjidhni ju, kjo është një gjë krejtësisht në diskrecionin e anëtarëve të komisionit dhe të Kuvendit, në do të votohem ose jo.

Në lidhje me pyetjen e parë, unë dua t'i thërras kujtesës sime për t'iu përgjigjur saktë pyetjes suaj. Më falni, nëse unë gaboj në shifra, por parimisht, unë dua t'ju them se i gjithë procesi nga i cili kontrolloheshin prokurorët në atë kohë, ose startoheshin procedimet disiplinore për shkak të të cilave Prokurori i Përgjithshëm propozonte shkarkimin e prokurorit, ndërtohej mbi një legjislacion të ndryshëm nga ligji për procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kriteret për shkelje disiplinore ishin krejtësisht të ndryshme, pra operonim në një kontekst ligjor krejtësisht të ndryshëm, ndërkohë që ky është një proces i posaçëm verifikimi i të gjithë atyre që janë në detyrë, gjyqtarë dhe prokurorë. Kështu që unë i shikoj si dy procese të ndara parimisht. Prokurori i Përgjithshëm nuk ishte në detyrë për të bërë procesin e rivlerësimit, ndërkohë që anëtarët e institucioneve të vetingut emërohen posaçërisht për të bërë këtë proces, orientohen në mbështetje të një legjislacioni të ndërtuar posaçërisht për këtë proces dhe suportohen nga të gjitha institucionet e tjera, sepse nuk është një proces që bëhet më vete. Sigurisht nuk mund të bëhet më vetëm nga një individ, por do të bëhet nga e gjithë trupa e institucionit të vetingut. Kështu e shikoj unë në parim.

Për sa i përket përgjigjes se pyetjes se çfarë kam bërë unë kur kam qenë Prokurore e Përgjithshme, ndoshta unë gabohem, të ma falni për gabimin e shifrës, por unë besoj se duhet të kem kërkuar ose propozuar shkarkimin e 6-7 prokurorëve, të cilët janë shkarkuar nga Presidenti i Republikës me dekret dhe të gjithë janë rikthyer në sistem me vendimin e gjykatave përkatëse. Kjo ka qenë ndër betejat që ka bërë institucioni...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Rama!

A ka pyetje nga kolegët?

Eduard Halimi – Unë kam vetëm një shpjegim të vogël. E bëra çështje pjesën e besimit publik për faktin se juve ju është dhënë njëherë mundësia për të bërë vettingun, jo për pasurinë, sepse atë e ka pasur dhe e ka ILDKP-ja, por për sa i përket performancës, cilësisë së vendimeve dhe ecurisë së punës së prokurorëve. Ka qenë ligji i tillë. Ky komision ka rekorde të debateve që edhe ne bashkë kemi pasur, ju në detyrën e Prokurores së Përgjithshme dhe unë bashkë me ministrin e Drejtësisë. Unë bëja inspektimet dhe sillja dosjet, këtu janë rekordet, unë kërkoja shkarkimin e 10 prokurorëve ose 15 prokurorëve sipas rretheve, të cilët nuk i arrestonin personat në kërkim dhe ju nuk i shkarkonit. Pra, kemi pasur një debat të tillë, prandaj u kujtova. Të dyja pyetjet kishin lidhje me këtë. Ne kemi pasur një debat bashkë, përveç atyre që thotë Flamuri dhe që ka votën e tij. E kemi pasur një debat bashkë, ju e keni pasur këtë mundësi. Unë jua kam dhënë votën për t'u bërë Prokurore e Përgjithshme. Jua kam dhënë një herë këtë mundësi. Pra, ne kemi pasur një debat, sepse ju nuk i shkarkonit prokurorët. Ne kërkonim t'i shkarkonit prokurorët pa pasur lidhje fare me atë çfarë ndodh. Prandaj ta bëra pyetjen, jo për të vazhduar me retorikë.

Ina Rama – A mund të përgjigjem?

Vasilika Hysi- Ju lutem, kolegë bëni pyetjet, por nuk keni të drejtë as të komentoni, as të sillni këtu konkluzione.

Fjala e fundit, zoti Halimi, ishte konkluzion. Ju lutem, na lini ne ta gjykojmë në kishte të drejtë ministri i Drejtësisë apo ish- Prokurorja e Përgjithshme dhe ta vendosim me votë.

Ju lutem, kaloni direkt në pyetje pa komente!

Zoti Noka e keni ju fjalën.

Flamur Noka - Ju lutem, mos qani Vasilika!

Vasilika Hysi - Po zonja Rama.

Ina Rama- Zonja Vasilika e sqaroi. Për të folur për rastet që ju përmendët duhet të diskutojmë për rastet dhe për të thënë se cili nga qëndrimet është i drejtë.

Vasilika Hysi – Zoti Noka.

Flamur Noka- Edhe një herë do t'ju formuloj një pyetje të përafërt me atë që bëra pak më parë.

Zonja Rama, Kryeministri e ka akuzuar sistemin e drejtësisë, ku bën pjesë edhe prokuroria, të cilën ju e keni drejtuar, me të njëjtën organikë, me të njëjtët individë, si sistem i kalbur, ju a bëni pjesë të ky kalbëzim, apo jeni e paprekur nga kalbëzimi?

Ina Rama- Unë u përgjigja...

Vasilika Hysi – Zonja Rama, përsëriteni për të disatën herë përgjigjen e kësaj pyetjeje.

Ina Rama – Nuk bëj pjesë te pjesa e kalbur, jam jashtë kalbëzimit, në vlerësimin tim.

Flamur Noka- Nuk ju ka prekur **krimbi**?

Ina Rama – Jo, nuk më ka prekur.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Rama!

Ju urojmë një ditë të mbarë!

Radhën e ka zonja Irena Nino.

Të njoftohet Klara Mullai.

Mirë se erdhët zonja Nino!

Ju jeni para komisionit, i cili do të votojë dhe do të propozojë listën e kandidatëve për anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Ndërkohë ju keni kandiduar për të gjitha pozicionet. Ne kemi dosjen përpara. Do t'ju lutesha që për anëtarët e komisionit të shpjegoni diçka më shumë se ju keni për të thënë nga CV-ja dhe materialet që keni depozituar, dhe për të na argumentuar pse duhet t'ju votojmë.

Irena Nino – Unë mendoj se duhet të më votoni, sepse mendoj se i ka aftësitë profesionale për të kryer këtë detyrë, meqenëse kam punuar 20 vjet në sistemin e organit të prokurorisë, në Prokurorinë e rrethit Shkodër, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Prokurorinë e rrethit të Tiranës.

Së dyti, kam përkushtimin për ta kryer këtë detyrë.

Së treti, mendoj se kjo është hera e duhur që drejtësia, pasi të bëhen këto reforma, të zërë vendin që i takon.

Vasilika Hysi- A keni pyetje?

Ervin Bushati- Pyetja e parë, që ia bëjmë të gjithë kandidatëve, a keni ju lidhje me politikën?

Irena Nino- Jo, nuk kam pasur asnjëherë.

Ervin Bushati – Nga viti 2004, me çfarë shoh në CV-në tuaj, jeni larguar nga prokuroria.

Irena Nino– Po kam ikur me dëshirën time.

Ervin Bushati – Cila është eksperiencia juaj nga viti 2004?

Irena Nino - Kam marrë licencën e avokatit, por nuk e kam ushtruar detyrën.

Vasilika Hysi- A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Faleminderit, zonja Nino!

Kalojmë te zonja Lindita Blinishti.

Mirë se erdhët, zonja Blinishti!

Është intervista e dytë që ju do të bëni. Jeni para komisionit i cili do të përzgjedhë dhe do të votojë kandidatët për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Kemi dosjen tuaj përpara. kemi edhe CV-në tuaj. Do të doja më shumë argumente lidhur me faktin pse ju mendoni se i plotësoni kushtet dhe kriteret për të qenë anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Ndërkohë, ju keni kandiduar për të gjitha pozicionet.

Lindita Blinishti – Unë jam notere. Kam një punë të qetë dhe të rehatshme. Këtë pozicion e shoh si sfidë dhe kontribut në sistemin e drejtësisë. Kam ëndërruar të bëhem gjykatëse, por nuk arrita, pasi gjykatat ishin të mbushura me kursantë kur dola unë. Më pas aplikova disa herë, por përsëri nuk arrita. Tani jam këtu dhe e shoh si mundësi për të hyrë në gjyqësor.

Vasilika Hysi – A ka pyetje për zonjën Lindita Blinishti?

A ka pyetje kolegë për zonjën, zoti Bushati.

Ervin Bushati - Kisha një pyetje që ua bëjmë të gjithë kandidatëve. A jeni ju e lidhur me politikën?

Lindita Blinishti – Jo, aspak.

Vasilika Hysi – Po, zoti Noka.

Flamur Noka – Në çfarë niveli jeni në njohjen e gjuhës angleze?

Lindita Blinishti – Kuptoj, por nuk e flas lirshëm.

Flamur Noka – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Kemi edhe ne të tjerët pyetje.

Zonja Blinishti, një nga kërkesat e ligjit është që kandidatët, sidomos për këto tri institucione shumë të rëndësishme...

Flamur Noka – Më falni, këtë kërkesë mos ia bëni zonjës, këtë çështje duhet t'ia ngrini Avokatit të Popullit.

Vasilika Hysi – Ju lutem, nuk ju lejohet të bëni komente për pyetjet e kolegëve!

Përveç kriterëve të mësipërme, në nenin 6 të ligjit, paragrafi 2 në të cilin thuhet se kandidati vlerësohet duke marrë në konsideratë në veçanti të dhënat e mëposhtme: titujt shkencorë në fushën e së drejtës, përvojat studimore dhe profesionale jashtë shtetit, përvojat e veçanta të kandidatit në sfera të caktuara. Do të doja të dija pak më shumë, sepse nuk e gjeta në dosjen tuaj, ndoshta...

Lindita Blinishti – Mesataren e kam mbi 8-të.

Vasilika Hysi – Mesataren e kemi llogaritur, por do të doja të dija në lidhje me titujt shkencorë, për kërkimet dhe studimet. Çfarë keni bërë nga viti 1995, që jeni diplomuar e deri më sot?

Lindita Blinishti – Në fakt, noteria nuk është se të jep shumë hapësirë, pasi ka konkurrencë të paktë, por gjithsesi unë kam punuar me përkushtim dhe çdo punë që më jepet e bëj 100% të saktë dhe me ndershmëri.

Vasilika Hysi – A ka pyetje? Jo.

Faleminderit dhe ditë të mbarë, zonja Blinishti!

Nëse zonja Klara nuk ka ardhur ende, kalojmë te kandidati tjetër, zoti Luan Daci.

Përshëndetje, zoti Luan!

Mirë se erdhët!

Ju keni kandiduar për të gjitha pozicionet. Ne kemi para CV-në dhe dosjen tuaj të plotë, të përcjellë nga Avokati i Popullit. Jeni para komisionit, i cili do të bëjë vlerësimin dhe votimin tuaj për të qenë në listën e kandidatëve që i propozohet seancës plenare për anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Do të donim diçka më shumë lidhur me plotësimin e kriterëve profesionale dhe radhë të dytë të pjesës së meritës, atë çka kërkon neni 6 i ligjit, paragrafi 2, titujt shkencorë, përvoja e posaçme, vjetërsia, përvoja studimore dhe profesionale jashtë shtetit shqiptar, kërkimi shkencor dhe të tjera.

Faleminderit!

Luan Daci – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë,

E ndiej veten të vlerësuar që thirrem nga komisioni parlamentar i ngritur posaçërisht për kryerjen e vetingut, të reformës gjyqësore pas gjithë këtij angazhimi politik nga parlamenti shqiptar. Për t'ia shpjeguar qartësisht komisionit dhe për t'i bërë të qartë edhe motivet se pse unë kam aplikuar për të marrë pjesë në këto organe të vetingut, i deklaroj komisionit të nderuar se duke parë gjithë këtë angazhim, gjithë këtë shqetësim, njëkohësisht edhe të institucioneve ndërkombëtare në lidhje me reformimin e sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të popullit te ky sistem, unë mendoj se i plotësoj kriteret si kuadër që kam qenë, por edhe si avokat për arsye se, së pari, kam mbaruar gjimnazin e Tepelenës me mesatare 9,4. Kam mbaruar Fakultetin e Drejtësisë me mesatare 8,4, kam mbaruar masterin shkencor në Fakultetin e Tiranës me mesatare 8,7 në të drejtën kushtetuese dhe në procesin e rregullt ligjor, pra në Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun. Mendoj se rezultatet e

kam pozitive, po kështu kam një angazhim që nga viti 2000 deri në ditët e sotme në sistemin e drejtësisë nëpërmjet aplikimit të funksionit të avokatit.

Jam treguar shumë korrekt, zonja kryetare, si me palët, ashtu edhe me sistemin e drejtësisë, si me gjyqtarët dhe prokurorët. Unë e vlerësoj edhe figurën morale, megjithëse ju i keni të gjitha organet kompetente ku mund t'i vlerësoni. Jam familjar, kam 2 fëmijë, jetoj në Tiranë, kam një apartament 1 dhomë dhe 1 kuzhinë. Kam pasur plot mundësi që të punoja si në administratë, edhe në drejtësi. Ju premtoj juve të nderuar, anëtarë të komisionit parlamentar, që duke parë gjithë këtë angazhim politik dhe moral të popullit shqiptar, të parlamentit shqiptar, si dhe të institucioneve ndërkombëtare, ju garantoj se në qoftë se do më vlerësoni pozitivisht, duke menduar se i plotësoj kriteret, duke qenë një kuadër tepër korrekt para shtetit shqiptar për të garantuar pikërisht qëllimin e këtij ligji.

Pra, në cilindo që ju do të më vlerësoni, unë do t'ju nderoj duke i zbardhur faqen si vetes, ashtu edhe juve.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Daci!

A ka pyetje? Po.

Ervin Bushati – Kam dy pyetje. E para, pyetja që ua bëjmë të gjithë kandidatëve, a keni ju lidhje me politikën?

Luan Daci – Jo.

Ervin Bushati – Datat këtu nuk janë shumë të qarta, a mund të na thoni shkurtimisht nga cili vit në cilin vit keni punuar, në çfarë pozicioni, gjithmonë avokat, por nga cili vit?

Luan Daci – Kam punuar avokat, zoti anëtar i nderuar i komisionit, që nga data 20.03.2000 kur kam marrë licencën e avokatit me autorizim të ministrit, zotit Ilir Panda, i cili më ka bërë edhe karakteristikën dhe për motive të aftësive të mia profesionale...Madje, zoti Panda më ka përjashtuar edhe nga provimi, duke vlerësuar aftësitë e mia morale, aftësitë profesionale, figurën time dhe më ka akorduar. Kam marrë licencën e avokatisë, ushtroj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro?

Ervin Bushati – Para kësaj date?

Luan Daci – Përpara kësaj date, para vitit 2000?

Ervin Bushati – Po.

Luan Daci – Kam punuar gjyqtar në Gjykatën e Tiranës.

Ervin Bushati – Nuk janë datat këtu, prandaj.

Luan Daci – Janë në CV

Vasilika Hysi – Jo.

Luan Daci – Na është kërkuar vetëm vjetërsia. Kam marrë vërtetimet dhe duhet të jenë edhe aty.

Vasilika Hysi – Zoti Daci, ju jeni diplomuar në vitin 1993.

Luan Daci – Në vitin 1994 dhe ju keni qenë anëtare e komisionit.

Vasilika Hysi – E di që kam qenë anëtare e komisionit, por CV-ja juaj, ndryshe nga ato që po thoni, ka disa..., prandaj po ju pyesim. Ju e keni shkruar CV-në, nuk e kemi bërë ne dhe keni shkruar që jeni diplomuar në vitin 1993 me mesatare 8,24. Pyetja ime është: Sa vjet keni punuar si gjyqtar dhe pse jeni larguar nga sistemi gjyqësor dhe keni kaluar avokat? Dhe për rekorde, kur keni filluar?

Luan Daci Zonja kryetare, kam filluar në shtator të vitit 1993, fillimisht kam qenë si ndihmës gjyqtar, kur kemi dhënë diplomën para komisionit shtetëror, dy ditë pas dhënie së diplomës unë jam emëruar gjyqtar në Gjykatën e Tiranës, madje jam emëruar edhe nënkryetar në Gjykatën e Tiranës dhe vendi për arsye ekonomike është suprimuar, nuk e di, kanë ndjekur një model tjetër, nuk kam pasur ndonjë problem, dhe deri më 24 dhjetor të vitit 1997 unë kam qenë gjyqtar në Gjykatën e Tiranës. Ashtu sikurse po del një ligj për vetingun, atëherë doli një ligj për riorganizimin e sistemit të drejtësisë. Çfarë kemi kontestuar ne si shoqatë e gjyqtarëve?

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Zonja kryetare, të nderuar anëtarë, ne donim atë që na garantonte ligji, që ne të regjistroheshim në Shkollën e Magjistraturës, sepse e kishim kursin të plotë, por të ishte edhe i përshpejtuar. Atëherë, nuk u zbatua nga qeveria e kohës ai urdhër ligjor i Shkollës së Magjistraturës, ku ne, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët duhet të regjistroheshim në Shkollën e Magjistraturës, zonja kryetare. Pra e keni ligjin. Ne e kontestuar këtë ligj thjesht për këtë pikë, pra kërkuam të regjistroheshim në Shkollën e Magjistraturës, ashtu sikurse ky ligj tani, me shumë objektivitet, për gjyqtarë të caktuar dhe prokurorë, të cilët mund t'i vlerësojë Komisioni i Vetëingut, supozojmë 50% të paaftë ose pa arsimim të plotë, i jep të drejtën dhe ju ia keni dhënë këtë të drejtë të regjistrohen në Shkollën e Magjistraturës me pagë 75%, por ne e kishim ligjin më të angazhuar në favorin tonë. Çfarë ndodhi? Nuk na regjistronin në Shkollën e Magjistraturës. Ne organizuam një protestë jashtë ambienteve të gjykatës, pavarësisht se është shkruar në ambientet e gjykatës, jo, ne nuk e kemi bërë në ambientet e gjykatës, sepse e njihnim ligjin shumë mirë dhe as kemi penguar punën e gjykatës, as kemi krijuar problem me palët dhe as me shtetin.

Vasilika Hysi – Në vitin 1997 jeni larguar, keni ikur apo ju kanë hequr?

Luan Daci – Unë kam ikur me dorëheqje, sepse nuk na lejuan të regjistroheshim.

Vasilika Hysi – Nga viti 1997-2000 me çfarë jeni marrë?

Luan Daci – Më ndonjë punë çfarë të kisha mundësi.

Vasilika Hysi – Dakord.

Luan Daci – Pastaj iu futa avokatisë, sepse duhet të angazhohesha.

Vasilika Hysi – Dakord, sepse në CV kishte një vakum.

Luan Daci – Doja t’u angazhohesha në administratë ose me ndonjë rrugë jashtë shtetit. Jashtë shtetit nuk kisha mundësi të shkoja dhe në vitin 2000 kam marrë licencën e avokatisë, të cilën ma ka dhënë direkt ministri, duke më vlerësuar.

Flamur Noka – Kam një kërkesë. Po munde, riplotësoje dhe ribëje CV-në, dorëzoje, sepse nuk e ke të plotë. Vetëm kaq.

Faleminderit! Nuk kemi pyetje të tjera.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Daci!

Radhën e ka zoti Lulëzim Hamitaj, pastaj të njoftohet zonja Tasi.

Lulzim Hamitaj – Mirë se ju gjeta!

Vasilika Hysi- Ju jeni para komisionit *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët do të votohen dhe do i sugjerohen seancës plenare për anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndërkohë keni konkurruar për të gjitha pozicionet. Anëtarët e komisionit kanë dosjen dhe CV-në tuaj. Ju do të prezantoheni shkurtimisht, 3 minuta, do të shtoni çfarë keni për të shtuar më shumë se ç’keni thënë në dosjen tuaj. Kryesisht ky komision vlerëson meritokracinë, jo thjesht kriteret juridiko-formale, të cilat i ka parë komisioni i verifikimit. Dua të ndalemi dhe të dëgjojmë pak më shumë lidhur me kualifikimet shkencore, titujt, formimin tuaj studimor profesional brenda dhe jashtë vendit, ose ndonjë përvojë të veçantë, që ne të bindemi dhe të themi pse duhet t’ju votojmë.

Faleminderit!

Lulzim Hamitaj- Shumë faleminderit!

Pikërisht po e nis nga formimi im profesional, por dua të nënvizoj edhe diçka tjetër. Unë jam larguar nga Shqipëria që pas shkollës së mesme dhe kam krijuar të gjithë karrierën time në qytetin e Romës, Itali. Kam kryer studimet në universitetin “La Sapienza”. Gjithashtu, kam bërë specializimin në fushën e së drejtës penale, përveç studeve të tjera të parashikuara për sa i përket stazhit, marrjes së titullit avokat dhe fillimit të aktivitetit tim nëpër zyra të tjera ligjore të nivelit të lartë dhe një shkëputje si punë autonome në bashkëpunim me kolegë të tjerë në Itali. Për disa vite karriera ime ka pasur një zhvillim edhe në Spanjë, ku edhe atje kam marrë titullin e avokatit. Gjithashtu, jam në përfundim të doktoratës, në vitin e

fundit, gjithmonë në të drejtën penale, specifíkisht në të drejtën e ekstardimit; kam bërë master profesional, përveç atij shkencor të mbaruar në kohën e duhur, gjithmonë për sa i përket kriminalitetit.

Dua të shtoj që pozicioni im, ndoshta në veçanti nga kolegët e mi, edhe pse nuk i njoh, por thjesht nga këndvështrimi se si po më vrojtoni, jam një figurë e papërzier me Shqipërinë në gjithë këto vitet e demokracisë, pasi kam ikur në vitet 1991-1992.

Dua të shtoj që ideja dhe objektivi im për të cilin ndodhem këtu, sigurisht nuk është aspekti ekonomik, pasi, falë Zotit, kam arritur një rezultat profesional dhe nuk kam pikësynimin e gjetjes së një vendi pune, ose kërkimin e një pune me të ardhura më të mëdha nga ato që kam aktualisht, përkundrazi. Por arsyeja e vërtetë është ajo që, pas shumë vitesh të parë në distancë Shqipërinë dhe më në fund arriti një moment i një reforme të thellë në drejtësi, ku nëpërmjet jush kërkohet edhe kontributi i atyre personave që mund të japin një ndihmë ose kontributin e vet në realizimin e objektivave të kësaj reforme kaq të thellë. Dy vjet më parë, kur jehona, edhe pse e zbehtë e kësaj reforme, arriti deri në Itali, unë mora kontaktet e para dhe ndoqa hap pas hapi zhvillimet e kësaj reforme, duke kërkuar, pas thuajse 24-25 vjetësh që nuk kisha marrëdhënie kontakti ose profesionale me Shqipërinë, përveç rastit të ndonjë klienti, t'i afrohesha botës shqiptare. Kam dy vjet që po punoj si pedagog i jashtëm në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë dhe këtë e kam përdorur si një kontakt më të afërt me aq sa mundesha, edhe pse kisha impenjimet e mia profesionale në Itali, vija këtu sipas orëve të organizuara të leksioneve për t'u njohur me botën shqiptare, intelektualët, me ata që ishin në botën akademike të Shqipërisë, për të pasur idetë më të qarta për sot.

Nuk di çfarë të them tjetër. Personaliteti im profesional dhe personal është krijuar dhe kristalizuar në një botë perëndimore dhe në një mënyrë të të parit të gjërave në atë këndvështrim, ku do të jetë edhe pikësynimi i reformës në drejtësi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Hamitaj!

Zoti Bushati ka një pyetje.

Helidon Bushati- Kam dy pyetje.

Në radhë të parë, dua t'ju falënderoj që merrni pjesë dhe më vjen mirë që jehona ka shkuar edhe në Itali. Kemi edhe një aplikant nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kjo tregon se shqiptarët besojnë në drejtësi. Ky është një proces shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Personalisht ju falënderoj si deputet i Kuvendit të Shqipërisë!

Pyetja e parë është: A keni ndonjë lidhje me politikën, të paktën në Shqipëri, sepse jua bëjmë të gjithëve këtë pyetje?

Lulzim Hamitaj- S'ka problem.

Faleminderit për vlerësimin tuaj, është kënaqësi!

Helidon Bushati – A keni ndonjë lidhje me politikën në Shqipëri?

Lulzim Hamitaj – Absolutisht, jo! Jo vetëm kaq, por dua të them se nuk kam votuar kurrë, sepse prezenca ime, rezidenca ime dhe të gjitha të drejtat e mia kanë qenë në Itali.

Helidon Bushati – Pyetja e dytë. Ju keni një pikë të fortë, që jeni i pakontaminuar nga ajo që ne duam të reformojmë, e cila është drejtësia shqiptare, por që mund të jetë edhe pikë e dobët, sepse mund ta njihni pak sistemin dhe nuk keni eksperiencë në Shqipëri. Cili është argumenti juaj, çfarë keni pikë të fortë dhe si mund të operoni më mirë, apo si mund ta ktheni këtë në një avantazh të krahasuar?

Lulzim Hamitaj –Pikë së pari, kuptohet se në momentin që interesi im ishte për të arritur në këtë ditë dhe në këtë pikë, siç jua thashë edhe vetë spontanisht, në dy vjetët e fundit kam pasur jo vetëm kontakte nëpërmjet universitetit, por edhe një studim të thellë të legjislacionit shqiptar, ku kam vërejtur me një kënaqësi personale, që kodet e Shqipërisë janë shumë të ngjashme, për të mos thënë të njëjtë, me ato të Italisë. Kështu që, nga ky këndvështrim, nuk shoh asnjë lloj problematike teknike.

Për sa i përket ambientimit, kontaktimit ose, si të thuash, të mënyrës të të bërit të gjërave me Shqipërinë, kam kërkuar të shfrytëzoj në maksimum, për aq sa profesioni im ka lënë hapësira, kontaktet me akademikët e Universitetit të Tiranës.

Vasilika Hysi –Faleminderit!

Po, zoti Noka.

Flamur Noka – Zoti Hamitaj, duke parë aftësitë tuaja, a besoni në vetvete ju se mund të bëni reformën e drejtësisë dhe mundësinë për drejtësinë e duhur në këtë vend?

Lulzim Hamitaj – Faleminderit për pyetjen!

Unë nuk dua që të lë një përshtypje të mbivlerësimit të vetvetes, ky do të jetë vlerësimi juaj, por në bindjen time të thellë, ashtu siç jua thashë në fillim, arritja ime deri në këtë pikë ka qenë një pritje ose “prishmëri” 25-vjeçare, dhe çerek shekulli nuk është pak.

Më jepet mundësia për të shtuar edhe diçka tjetër. Unë kam ardhur rreth dy vjet më parë, gjithmonë në fazën e fillimit të afrimit tim me botën shqiptare, ku kam marrë titullin e avokatisë në Tiranë, por mund të verifikohet nga komisioni, që s'kam bërë asnjë çështje, pavarësisht ofertave që mund të më jenë bërë dhe kontakteve që unë mund të kem pasur nëpërmjet universitetit, pikërisht për të mos pasur atë kontaminimin ose për këtë, që në mendjen e dikujt të mos arrihej dhe të thuhej sot se edhe ky ka bashkëpunuar në këtë gjyq.

Flamur Noka- E kuptoj se ke pritur që të vije drejtësinë e reformuar.

Lulzim Hamitaj – Dua të them se interesi ose distanca ime me këtë botë, ka qenë pikërisht, ajo që pikësynimi mund të ishte një ditë...

Flamur Noka – Drejtësia e kalbur nuk mund të ishte pjesë e jotja dhe ke pritur drejtësi tjetër. E kuptoj këtë dhe besoni te vetvetja se mund të ndryshoni drejtësinë rrënjësisht.

Lulzim Hamitaj – Kjo pastërti është ruajtur, pikërisht për të dhënë kontributin tim, dhe kuptohet që një njeri i vetëm nuk mund ta bëjë, por nëse realizimi i reformës do të bëhet ashtu siç është parashikuar, me hollësi, që unë i kam studiuar me kujdes, pse jo dhe ...

Flamur Noka – Kam edhe një pyetje tjetër.

Vasilika Hysi – Po, zoti Noka.

Flamur Noka – Kush u bë shkak për ju emocionalisht dhe shpirtërisht, që ju motivoi të vini dhe të kandidoni këtu? Kush ju bëri thirrje?

Lulzim Hamitaj - E them pa dyshimin më të vogël, se ka qenë patriotizmi dhe dëshira që Shqipëria më në fund, pas çerek shekulli, të ndryshojë rrugë dhe gjithsecili nga ne, që mund të ketë një formim, qoftë këtu ose jashtë, të japë kontributin e vet për pastërtinë e Shqipërisë.

Flamur Noka – Faleminderit, zoti Hamitaj!

Vasilika Hysi –Faleminderit, zoti Hamitaj!

Komplimente edhe nga ana ime, që duke qenë jashtë shteti, vini dhe kandidoni dhe doni të kontribuoni në reformën në drejtësi.

Ju uroj një ditë të mbarë!

Dua të sjell në vëmendje dhe e kam për të gjithë kandidatët që kanë ardhë nga jashtë vendit...

Flamur Noka – Ju uroj suksese. Qenkeni kolegë me Vasilikën.

Vasilika Hysi – Nga CV-ja del që jemi kolegë, por që nuk njihemi. Jemi në të njëjta fusha të kërkimit shkencor.

Lulzim Hamitaj – Unë nuk njoh asnjë koleg këtu, por mund të jenë me mijëra.

Vasilika Hysi –Kolegu e ka fjalën si kolegë, sepse edhe unë jam kriminologe, penalistë, jemi në fushën e drejtësisë së të miturve

Flamur Noka – Thashë pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, në të njëjtin ku je edhe ti.

Vasilika Hysi – Nuk jam më pedagoge.

Zoti Hamitaj, dua të sjell në vëmendje për ju dhe për të gjithë kandidatët që vijnë nga jashtë se procedura parlamentare, Kushtetuta dhe ligji kanë kërkuar që brenda 30 ditëve

ne të mbyllim procesin, që do të thotë se, përveç intervistës që ju bëtë sot në komisionin tonë, ju do të keni një intervistë tjetër në zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që do të thotë se nuk duhet të lëvizni dhe të udhëtoni, sepse besoj se do të jetë shumë shpejt. Kjo për qëllim që mos të na krijojë probleme nga ana e stafit për njoftimet që kanë për kandidatët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flamur Noka – Po ju jep urdhër që të mos bëni gabim, por të jeni në gatishmëri. Si kolegë ajo që ju ka paracaktuar, po ju paralajmëron.

Vasilika Hysi – Zoti Noka, në radhë të parë, njihemi për herë të parë me zotërinë, por më ka dalë një shqetësim nga një kandidate që ka njoftuar stafi i Kuvendit, e cila ka udhëtuar pas intervistës që bëri **në Komisionin e Verifikimit**.

Mos harroni që kemi kandidatë nga Kanadaja, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Italia dhe nga vende të tjera dhe nuk është...

Flamur Noka – Kanë ardhur edhe dy nga Marsi dhe një nga Hëna..

Vasilika Hysi – Ju lutem, se nuk është dinjitoze dhe ne duhet t’ua bëjmë transparente dhe të qartë, meqenëse po flet për transparencë, kandidatëve afatet dhe procedurat. Pra, shumë shpejt do të keni një intervistë tjetër, ndoshta në fillim të javës tjetër në komisionin tjetër. Është mirë që kandidatët, që janë nga jashtë, ta dinë për të rregulluar axhendën e tyre në vendin e punës që kanë. Kjo është e para.

E dyta, për transparencë, meqenëse zoti Noka kërkon transparencën e procedurave...

Faleminderit të gjithëve!

Flamur Noka – Transparencën e kam pikë të dobët...

(Diskutime pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Ju lutem, mbledhjen e drejtoj unë! E mbyllëm intervistën me ju!

Lulzim Hamitaj – Më fal, po ju kërkoj leje 10 sekonda, nëse është e mundur, për t’ju falënderuar për përkujdesjen tuaj. Gjithsesi, ishte dhe është interesi im për të përgatitur axhendën time, duke u vënë në dispozicion...

Për sa i përket zotit Noka, unë dua t’i them se, përpara se të bëjë paragjykime, do të ishte mirë të bënte një vlerësim më të qetë dhe më afatgjatë, sepse nuk shoh asnjë arsye.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit! Ditë mbarë!

Flamur Noka – Ju falënderoj! Por nuk kisha asgjë me ty, e kisha me Vasilikën.

Lulzim Hamitaj – Kur ju thoni që ka vendosur, unë nuk e di se kush ka vendosur...

Vasilika Hysi – Zoti Hamitaj, ju nuk na njihni, por kjo është politika shqiptare. Nuk më njihni mua, nuk njihni zotin Noka, por do të keni mundësi...

(Diskutime pa mikrofon.)

Flamur Noka – Është njeri shumë i mirë Vasilika, ta dish!

Vasilika Hysi – Radhën e ka zonja Mimoza Tasi.

Mirë se erdhët, zonja Tasi!

Mimoza Tasi – Mirë se ju gjeta!

Vasilika Hysi – Ju jeni para komisionit, i cili do të vlerësojë dhe do të votojë listën e kandidatëve për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Ne e kemi dosjen tuaj. Kemi bërë një intervistë, ku kemi qenë unë dhe zoti Noka. Do të doja të shtoni diçka shkurtimisht, nëse keni, në lidhje me CV-në tuaj dhe me faktin pse ne duhet t’ju përzgjedhim ju në Kolegjin e Apelimit. Ndërkohë, ju keni edhe një intervistë tjetër për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerin Publik.

Fjala është për ju, keni tri minuta kohë.

Mimoza Tasi – Më 7 korrik të këtij viti bëj 24 vjet që kam filluar punë në Kuvendin e Shqipërisë. Sikurse e keni parë edhe nga CV-ja ime, kam punuar pothuajse në të gjithë sektorët e Shërbimit e Legjislativ të Kuvendit të Shqipërisë. Kam krijuar eksperiencë të bollshme dhe të mjaftueshme në çdo pozicion pune. Kam punuar më përgjegjshmëri të lartë. Krahas punës, kam punuar edhe për përgatitjen time akademike dhe profesionale. Pra, këto kanë ecur paralelisht.

Puna prej 22 vjetësh në Komisionin e Ligjeve ka qenë edhe shkollë për mua. Kjo më ka dhënë mundësi të punoj dhe të studioj njëkohësisht, duke arritur edhe kualifikimet pasuniversitare. Pse kandidoj?! Pyetja është e thjeshtë, por është edhe e vështirë. Motivet janë të thjeshta dhe të rëndësishme. Fakti që kam punuar pa ndërprerje në Komisionin e Ligjeve, ku pjesë e fushës së përgjegjësisë së tij është edhe drejtësia, më ka bërë të jem sa afër, aq edhe larg sistemit të drejtësisë dhe të njoh aspekte të ndryshme të funksionimit të tij qoftë penale, qoftë civile, të jem prezente dhe të punoj për përgatitjen e Komisionit të Ligjeve si për raportime për sa i përket kontrollit parlamentar të institucioneve kushtetuese, si Prokuroria e Përgjithshme, ashtu edhe për procesin legjislativ për hartimin e kodeve të procedurës penale, civile etj. Gjithashtu, puna në komision më ka dhënë mundësi të njihem me personalitete, me autoritete dhe me ekspertë të fushës së të drejtës, vendas e të huaj, të cilët kanë qenë motiv frymëzimi për mua. Me kryerjen e reformës kushtetuese dhe legjislative në sistemin e drejtësisë nga njëra anë, jam në një moshë që mund të marr një drejtim tjetër profesional në jetën time. Vlerësoj qëndrueshmërinë në profesion prej më se 24

vjetësh. Mendoj se integriteti im moral dhe profesional, aftësitë e mia profesionale janë një armë e fortë që më bënë mua të mendoj të zhvilloj karrierën time profesionale në një drejtim tjetër. Kuptohet, pastaj është vlerësimi juaj, por këto kanë qenë disa nga motivet që më kanë shtyrë të kandidoj.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Tasi!

A ka pyetje?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Në fakt, kemi fatin ta njohim, ta respektojmë dhe ia vlerësojmë punën, kështu që kanë të drejtë kolegët. Kam një pyetje të shkurtër që ua bëjmë të gjithë kandidatëve. A keni lidhje me politikën?

Mimoza Tasi – Të them të drejtën, unë kam lidhje me të gjithë politikën, pasi puna ime mes të gjitha grupeve parlamentare për zbatimin dhe respektimin e Rregullores më bën të jem sa pranë, por aq edhe larg politikës. Kjo më ka bërë që ju të më doni, pra njëherë njëra palë dhe njëherë pala tjetër. Kështu që, në qoftë se kjo do të quhet afërsi me politikën, unë e kam këtë të metë.

Ervin Bushati – Pra, nuk keni përkatësi politike.

Mimoza Tasi – Absolutisht asnjëherë nuk kam qenë anëtare e asnjë partie politike.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Tasi!

Ditë të mbarë!

Ju lutem, ftoni zonjën Natasha Mulaj!

Mirë se erdhët, zonja Mulaj!

Natasha Mulaj – Përshëndetje të gjithëve!

Vasilika Hysi – Është intervista e dytë për ju. Ju keni kandiduar për të tria pozicionet. Kjo intervistë është vetëm për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Ne e kemi CV-në tuaj, dosjen tuaj. Kolegët duan të dëgjojnë diçka më shumë për ju, për meritokracinë për të qenë anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit.

Ju lutem, keni tri minuta kohë në dispozicion, me qëllim që t'ju japim mundësi kolegëve për pyetje, nëse do të kenë.

Natasha Mulaj – Faleminderit!

Unë kam kandiduar për të tria pozicionet, për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për Komisionerin Publik. Kështu që ju falënderoj shumë që kam arritur deri në këtë pikë. Mendoj se për sa i përket etikës morale dhe profesionale, që besoj se është e para, të subjektivit mendoj se jam në standardet e duhura. Karriera ime profesionale mendoj se është shumë e

pastër. Kam punuar gjithmonë në gjyqësor. Si fillim kam punuar ndihmësgjyqtare, pastaj gjyqtare, pastaj kam punuar ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë. Kam kandiduar edhe për anëtare të Gjykatës së Lartë. Jam përzgjedhur si një nga juristët më të mirë nga Presidenti i Republikës. Pastaj pas këtyre ndryshimeve politike, siç i dimë të gjithë, kam qenë në pritje deri më sot. Tani doli rregulli i ri për sa i përket vetingun. Jam shumë e lumtur që kam arritur deri në këtë standard dhe shpresoj të shkoj edhe më tej.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Mulaj!

A ka pyetje?

Po, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Faleminderit! Kam një pyetje të shkurtër që ua bëjmë të gjithë kandidatëve. A keni lidhje me politikën?

Natasha Mulaj – Jo, zotëri!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Ju keni lënë detyrën e këshilltarit të Gjykatës së Lartë në vitin 2013, nga viti 2013 dhe deri tani me çfarë jeni marrë?

Natasha Mulaj – Singërisht, kam qenë në pritje gjithmonë.

Vasilika Hysi – Keni qenë në pritje për t'u votuar...

Natasha Mulaj – Si pjesëtar i KLD-së kam qenë dhe gjithmonë kam bërë kërkesa të vazhdueshme, por shansi... Nuk e di.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Ju uroj ditë të mbarë!

Intervista për komisionet e tjera është në komisionin tjetër!

Natasha Mulaj – Faleminderit! Ditën e mirë!

Vasilika Hysi – Kandidati tjetër është zoti Olsin Tomici.

Mirë se erdhët, zoti Olsi!

Olsi Tomici – Ju keni kandiduar për të gjitha pozicionet! Intervistën sot e keni si kandidat për anëtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Ne e kemi para dosjen tuaj, CV-në tuaj.

Për tri minuta na thoni diçka për pjesën e meritokracisë, pra të kërkesave që ka pika 2 e nenit 6 të ligjit, që ju i plotësoni, që keni një vlerë të shtuar dhe që i përmbushni të gjitha kriteret që ka parashikuar legjislacioni.

Fjala është për ju.

Olsi Tomici – Faleminderit!

Mendoj se jam kandidat potencial për një vend si anëtar në Kolegjin e Apelimit për shkak të eksperiencës sime të konsiderueshme në disa institucione të administratës shtetërore. Theksoj se kam qenë pjesë e strukturave në disa institucione të administratës shtetërore, në strukturat audituese, kontrolluese, si në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në sektorin e kontrollit tekniko-ligjor, në ish-Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ku kam qenë jurist në Sektorin e Kontrollit Tekniko-Ligjor. Kam qenë kryetar i komanduar i Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për një periudhë disamujore në qarkun e Tiranës. Kam qenë pjesë e Agjencisë së Trajtimin të Kredive, nomenklaturë e ministrit të Financave, për një periudhë pothuajse 7-vjeçare me një eksperiencë të konsiderueshme nga specialist-jurist deri në zëvendës drejtor i përgjithshëm, pozicion e kam mbajtur për një periudhë pothuajse 3-vjeçare. Gjithashtu, kam qenë edhe ekspert i jashtëm në grupin task force të ngritur nga Kryeministri për verifikimin e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme shtetërore tek të tretët në zonën Vlorë-Sarandë. Kam qenë edhe avokat për një periudhë prej 1 viti, duke përfaqësuar klientë të ndryshëm në disa shkallë të gjyqimit. Aktualisht punoj tek ALUIZNI. E gjithë eksperiencia ime në këto struktura audituese-kontrolluese më bën një kandidat potencial. Gjithashtu, kam qenë një element shumë i rëndësishëm dhe përcaktues në analiza të ndryshme ligjore dhe në hartimin e akteve të ndryshme administrative nënligjore dhe ligjore në të gjitha institucionet ku kam punuar.

Vasilika Hysi – Pyetje?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Kam një pyetje të shkurtër që ua bëjmë të gjithë kandidatëve. A keni lidhje me politikën?

Olsi Tomici – Jo, nuk kam lidhje me asnjë forcë politike.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Fjalën e ka zoti Halimi.

Eduard Halimi – Ju jeni emëruar nga Kryeministri në vitin 2014 si ekspert ligjor...

Olsi Tomici – I jashtëm...

Eduard Halimi – I emëruar nga Kryeministri; punëdhënësi Kryeministria. Mirë, nga Niko Peleshi.

Kur ka qenë konkursi, ku ju jeni përzgjedhur si ekspert nga Kryeministri? A ka pasur ndonjë konkurs?

Olsi Tomici – Unë jam përzgjedhur nëpërmjet CV-së. Po ta shikoni CV-në, unë kam një eksperiencë goxha të konsiderueshme në fushën e pronave. Kam punuar, siç e theksova edhe më parë, në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në ZRPP, në zyrën

qendrore, në ish-Komitetin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Jam përzgjedhur nëpërmjet CV-së dhe një interviste të thellë profesionale si ekspert.

Eduard Halimi – A ka pasur konkurs?

Olsi Tomici – Jo me konkurs, por me intervistë të thellë profesionale.

Eduard Halimi – Sa konkurrentë ishin?

Olsi Tomici – Unë nuk mund të them sa ishin, por ishin goxha dhe unë isha njëri prej tyre.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Halimi!

Po, zonja Vokshi.

Albana Vokshi – Çfarë pune bëni aktualisht, sepse këtu në CV thoni se jeni avokat që nga maji i vitit 2016, ndërkohë sikur dëgjova që thatë se aktualisht jeni të ALUIZNI?

Olsi Tomici – Aktualisht jam tek ALUIZNI.

Albana Vokshi – Tani, ka disa kohë që kam filluar.

Eduard Halimi – Me çfarë konkursi jeni emëruar atje? Kur është zhvilluar konkursi për të filluar atje?

Olsi Tomici – Kam filluar me urdhër të Kryeministrit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Pse nuk janë përditësuar CV-të?

Vasilika Hysi – Zonja Vokshi, këto janë dosjet që përcjell Avokati i Popullit në momentin e aplikimit. Qëllimi i intervistave është pikërisht për ta plotësuar atë, prandaj unë bëj pyetjen nëse ka diçka që ka ndryshuar, pra a është shtuar diçka. Për këtë arsye kemi pasur intervistë edhe në komisionin e verifikimit dhe përzgjedhjeve.

Albana Vokshi – Zonja Hysi, e kuptoj, por kur thotë “disa kohë”, do të thotë disa muaj, dhe Avokati i Popullit CV-në e fundit fare e ka dërguar para një muaji. Domethënë, CV-ja ose prezanton realitetin ose... Nuk e kuptoj pse...

Vasilika Hysi – Procedura tek Avokati i Popullit ka filluar në muajin janar. Ka pasur një proces të gjatë, të cilin ju e dini, pra u kthye nga Kuvendi. Është një procedurë e gjatë që ka marrë kohën e saj.

Albana Vokshi – Ndërkohë ka marrë edhe urdhrin nga Kryeministri...

Vasilika Hysi – Mos harroni që për shkak të “çadrës” dhe të 90 ditëve të bojkotit, **ne nuk kemi pasur** mundësi, të bëjmë këto seanca, do t’i kishim bërë që në muajin maj.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Çfarë lidhjeje ka çadra, nuk ka lidhje fare.

Olsi Tomici – Faleminderit! Punë të mbarë!

Vasilika Hysi – Zoti Pal Shkambi.

Pal Shkambi – Përshëndetje!

Vasilika Hysi – Mirë se erdhët, zoti Pal!

Pal shkambi – Mirë se ju gjeta!

Vasilika Hysi – Ju lutem, zini vendin!

Ju keni aplikuar për të gjitha pozicionet. Ne jemi komisioni *ad hoc* i ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë për të bërë intervistat dhe për të votuar, me qëllim që t'i kalojmë seancës, si kandidatë, anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit. Përpara kemi dosjen, kemi CV-në tuaj, do të donim diçka më shumë lidhur me meritën që ju keni dhe përmbushjen e kriterëve të meritokracisë dhe të profesionalizmit, që kërkon të qenurit anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit.

Fjala është për ju, keni 3 minuta kohë për t'ua lënë radhën kolegëve deputetë që të bëjnë pyetje.

Pal Shkambi - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit të gjithëve!

Unë jam Pal Shkambi, nga Shkodra, lindur më 24.08.1963, i martuar me tre fëmijë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare. Kam aplikuar këtu duke parë që Shqipëria ka shumë nevojë për një demokraci dhe një drejtësi ndryshe. Sigurisht edhe më parë, me mundësitë e mia, kam dhënë kontribute për një demokraci ndryshe dhe kam shpalosur disa koncepte të rëndësishme, që sot po përfaqësohen nga partitë politike dhe politika shqiptare në përgjithësi, të cilët dua t'i falënderoj!

Sot jam këtu para jush për të kontribuar në reformën në drejtësi.

Në radhë të parë, e ndiej veten qytetar të lirë të këtij vendi, të pakapur nga skllavërimi, as nga oligarkia, një qytetar që do të japë kontribut, me mish dhe me shpirt, si për familjen time. Këtë gjë e kam shprehur publikisht para të gjithë shqiptarëve, duke shkuar fshat më fshat dhe zonë më zonë. Sot jam këtu, përpara jush, për të shprehur vullnetin tim, që jam i gatshëm të kontribuoj me mish e me shpirt, me të gjitha njohuritë e mia intelektuale dhe shpirtërore, për një Shqipëri ndryshe.

Jam i diplomuar në tri fusha: jam jurist, ekonomist, financier kontabilist, psikolog klinik, kam edhe master shkencor, të cilin nuk e kam paraqitur në dokumentacion, sepse ende nuk kam mbrojtur diplomën. Mes të tjerave, profesorëve të mi në Shkodër ju kam thënë kështu: “Libra bëni dhe nuk jeni të zotë për t'i shpjeguar librat, teste bëni, por jo teste inteligjence, dhe mundësisht vlerësimet i keni të njëanshme, vetëm për ato grupe shoqërore

që ju afrojnë para dhe pushtet”. Domethënë, e kam diplomën më të mirë se sa ata në Shkodër, por ma kanë shtyrë dhe kam kryer masterin shkencor të psikologjia klinike.

Sigurisht, unë jam këtu sot mundësisht për të sjellë shpresën, sepse kam shprehur publikisht se është koha që shqiptarët të bashkohen si vëllezër, pa dallim feje, ideje, race e krahine dhe të bëjnë një besëlidhje për të shpëtuar Shqipërinë. Nuk kemi pse të rrimë në këtë gjendje, duke skllavëruar njëri-tjetrin, në një kohë që është koha të bashkohemi dhe zgjidhim më të mirën, ashtu siç vlerësojmë familjet tona, të vlerësojmë mbarë Shqipërinë, sepse kjo është shtëpia jonë e madhe, sikur kemi bërë një shtëpi të vogël dhe nga një familje të vogël.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Ka pyetje?

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – A keni lidhje me politikën? Kjo është një pyetje që ua bëjmë të gjithëve.

Pal Shkambi – Pa diskutim, unë e thashë edhe më parë, por e kam deklaruar edhe aty, jam drejtues i një partie dhe ajo parti ka marrë përsipër të denoncojë publikisht politikën shqiptare. E kam denoncuar me të gjithë ata njerëz që kanë ardhur pas meje, publikisht të gjithë politikën shqiptare, si një politikë që nuk ka bërë më të mirën e mundshme. Nuk kam qenë asnjëherë në pushtet, nuk kam përfituar nga ajo politikë asnjë qindarkë, as dhe një flet formati A4, as edhe një stilolaps, përveçse kam shitur truallin tim, aty ku sot është oborri i shtëpisë, për të bërë këtë gjë, për t’i shërbyer Shqipërisë, për të dhënë modelin e gjithëpërfshirjes. Jam sot këtu, sepse Shqipëria nuk ka gjithëpërfshirje, përveçse teorikisht; nuk ka një konkurrencë të ndershme, përveçse monopol; nuk ka mundësisht përfaqësim etnik, përveçse një grusht njerëzish, që kanë uzurpuar pushtetin politik dhe ekonomik. Kjo nuk është hera e parë, sepse e keni edhe në Televizionin Publik Shqiptar dhe në videot e vitit 2013 e në vazhdimësi, ku më kanë lejuar të shprehem me sinqeritet dhe vullnet, për një model totalisht të ri, për një demokraci të re, të ndershme dhe të moralshme, për një Shqipëri ndryshme, për një drejtësi, që të përpiqemi të plotësojmë njëri-tjetrin, sepse, veçse duke pranuar dhe respektuar njëri-tjetrin, duke qenë empatikë, jo me u këput gjuhën njerëzve... Edhe në këtë reformë unë vij...

Vasilika Hysi – Ju lutem, zoti Shkambi! A keni mbajtur pozicione drejtuese në këta 10 vjetët e fundit në partitë politike?

Pal Shkambi - E kam ndërtuar vetë një parti politike, ajo parti e ka emrin Partia Popullore Kristian Demokrate Shqiptare, modeli gjerman i Helmut Kolit, sot Angela Merkel,

një model bashkimi dhe vëllazërimi, një model mundësisht për një Shqipëri, ku të përfaqësohen njerëzit e ndershëm. Kam dal me intelektualë në të gjithë territorin shqiptar dhe mundësisht me intelektualë, ku jam gjobitur 80 milionë lekë, kështu si skllav. Unë nuk kam asnjë lloj konflikti interesi që të diskutohet sot, përveçse të më thuhet se kam dhënë një kontribut të mirë dhe të besueshëm, para këtij komisioni të nderuar, të jem i besueshëm edhe për reformën në drejtësi. Sigurisht, nëse nuk pranojmë, nuk më mbetet fare hatri, sepse bashkë me ju do të jem, sa të kem frymë dhe shpirt, për kontributin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve i patundur dhe i pathyeshëm, nuk më thyen as leku, as frika, as interesi, nuk më tremb as frika, përveçse dua të kontribuoj për Shqipërinë dhe shqiptarët. Ky është Pal Shkambi.

Vasilika Hysi – Zoti Shkambi e bëtë fushatën. Dua t'ju bëj një pyetje, a jeni drejtues i kësaj partie?

Pal Shkambi – Pa diskutim që jam drejtues dhe e kam shënuar, që sapo të pranojmë do të jap dorëheqjen dhe do të përkushtohem në këtë institucion kushtetues me mish dhe me shpirt. Mundësisht dhe të jap modelin më të mirë jo duke shembur dhe shkatërruar, por, në radhë të parë, do të parandaloj dhe do të ndëshkoj ata të ndëshkuarit dhe të ndëshkuarve.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Shkambi, dhe ju urojmë një ditë të mbarë!

Pal Shkambi – Faleminderit dhe ju uroj punë të mbarë, suksese për një Shqipëri ndryshe, të gjithë së bashku si vëllezër dhe motra!

Shumë faleminderit dhe respektet më të mira!

Mirupafshim!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pa diskutim që votoj nr. 6, nuk ka mëdyshje ajo punë, sepse nr. 6 votoj, sepse jam i persekutuar. Zotëri kot pa ma thua këtë gjë, sepse jam i persekutuar dhe i diskriminuar.

Vasilika Hysi – Ju lutem, zoti Pal!

Pal Shkambi – Kam edhe një fjali. Në këtë Shqipëri sa të jetë një pluralizëm komunist, jo një pluralizëm gjithëpërfshirës nga të gjitha shtresat, demokraci në Shqipëri nuk ka.

Duhet të gjitha shtresat e shoqërisë, sepse është marrë modeli, largimi i njerëzve më të ndershme komunistë dhe mundësisht në vend të tyre janë vënë kriminelë dhe rrugaçë. Është koha të bashkohen vëllezër dhe motra shqiptar nga të gjitha shtresat e shoqërisë, dhe mundësisht të thërrasim edhe emigrantët e huaj të kontribuojnë për këtë Shqipëri dhe të kërkojmë një Shqipëri të ndershme.

Vasilika Hysi – Zoti Shkambi, jemi në komisionin *ad hoc* dhe një nga kërkesat e Kushtetutës në nenin “c” është: “Kandidati nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratë publike dhe funksione drejtuese në partitë politike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”. Unë nuk e shikoj ta keni shkruar këtë në CV-në tuaj.

Pal Shkambi – Pa diskutim aty e keni, shikojeni se nuk e keni përpara.

Vasilika Hysi – CV-në tuaj e kam përpara.

Pal Shkambi – Pa diskutim që e kam shënuar, në qoftë se nuk e kam shënuar, atëherë gjithçka është kot.

Vasilika Hysi – CV-në tuaj e kam këtu, e kam marrë nga dosja dhe ky është një kriter skualifikues.

Faleminderit!

Pal Shkambi – E kam shënuar dhe kam thënë se jam drejtues i partisë, e kam për nder që kam dhënë kontribute. Edhe sikur sot të më mbarojë jeta e kam për nder që kam dhënë kontribut për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Faleminderit dhe suksese!

Sigurisht, gjithëpërfshirja duhet të jetë në çdo institucion.

Vasilika Hysi – Zoti Pal, ju keni punuar edhe në Policinë e Shtetit dhe e njihni disiplinën e ushtarakut. Unë e kam mbyllur intervistën me ju dhe komisioni u nënshtrohet rregullave të Kuvendit. Ne ju thamë faleminderit, ditë të mbarë! Nuk lejohet këtu në parlament të bëjmë politikë.

Pal Shkambi – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Ju lutem, a mund të mbyllni mikrofonin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të nderuar kolegë, prandaj kanë vlerë intervistat!

Kandidatura tjerë është zonja Pamela Qirko, e cila kandidon për të gjitha pozicionet.

Mirë se erdhët, zonja Qirko!

Në fakt, ju kandidoni për të tria pozicionet. Kjo është intervista juaj e dytë tashmë para një komisioni, i cili përzgjedh dhe voton për t’i kaluar seancës anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Kolegët kanë përpara dosjen tuaj, CV-në tuaj, ky është një komision, i cili përzgjedh në bazë të kriterëve juridike, Kushtetuese, por edhe kriterëve profesionale dhe meritokracisë për të bërë dallimin midis 34 kandidatëve. Duam të dëgjojmë diçka më shumë lidhur me formimin profesional, kualifikimet tuaja brenda dhe jashtë vendit, pra çfarë keni ju për të

shtuar në krahasim me atë që keni në dosje. Ju lutem, 3 minuta, pasi më pas kolegët deputetë kanë pyetje!

Faleminderit!

Pamela Qirko – Jam Pamela Qirko, kam studiuar në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë. Në vitin 2001 kam mbaruar studimet, prej asaj kohe kam filluar të punoj si juriste. Në vitin 2004 kam marrë licencën e avokatisë dhe prej 13 vjetësh ushtroj profesionin tim, ku përballem me të gjitha shkallët e gjyqësorit çdo ditë. Domethënë, jam avokate aktive, sepse nganjëherë ngatërrohet kur themi juriste, thuhet është juriste dhe nuk është, por unë jam avokate aktive në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Kam punuar dhe vazhdoj të punoj për një kompani telekomunikacioni ndërkombëtare prej 16 vjetësh tashmë. Në kompaninë në quhem *signor lawyer*, që është niveli më i lartë i avokatisë. Kandidova për organet e vetingut në janar, duke dëgjuar thirrjet që u bënë nga aktorë të ndryshëm, duke kërkuar kandidatë, sepse, sinqerisht kam qenë gjithmonë partizane e kësaj reforme, por nuk e kisha menduar ndonjëherë të kandidoja. Duke qenë se nuk kishte kandidatë dhe duke u përballur përditë me problematikat e gjyqësorit, duke u përballur me palët që ne përfaqësojmë, që nuk arrijmë dot t'ua shpjegojmë, pse gjyqësori çalon, çalon për shkak të korrupsionit, çalon edhe për shkak të paaftësisë, duke qenë se i plotësoja të gjitha kriteret ligjore, e pashë me vend të kandidoja për të tria pozicionet,

Kjo është një përmbledhje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Qirko!

Ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – A keni lidhje me politikën?

Pamela Qirko – Jo, nuk kam.

Ervin Bushati - Faleminderit!

Vasilika Hysi – A ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A keni lidhje politike?

Pamela Qirko – Jo, nuk kam, por nuk e di cila parti është, sepse jam totalisht jashtë politikës.

Vasilika Hysi – Kam unë një pyetje zonja Qirko!

Pamela Qirko – Po.

Vasilika Hysi - Kryesisht ju keni punuar si avokate në sektorin e AMC-së, në Albtelecom, Telekom e të tjerë. Në nenin 6, në paragrafin 2, ligji kërkon që kandidati të

vlerësohet jo vetëm për faktin që ka jo më pak se 15 vjet punë si jurist, si avokat e të tjerë, por ka edhe disa kritere të tjera, kualifikimet shkencore, master doktoraturë, punime, formime profesionale brenda dhe jashtë vendit, sepse do të shkoni të vlerësoni vendimet që do të jepen për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, të cilët kanë një standard.

Çfarë aktiviteti kërkimor shkencor, profesional, përveç punës në AMC ose Albtelecom, keni?

Pamela Qirko – Atëherë, mendoj se pak rëndësi kanë titujt shkencor, pasi për shkak të moshës dhe për shkak të detyrës që kam pasur deri tani dhe të ngarkesës nuk jam investuar në këtë pikë. Kam filmuar një master në Cornell University në New York dhe shpresoj që këto tituj t’i fitoj me eksperiencën time dhe me kalimin e kohës. Kurse për sa u përket standardeve të gjyqtarëve, ngelet për t’u diskutuar.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Pyetje kolegët nuk kanë.

Ditë të mbarë!

Pamela Qirko – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Ju lutem, ftoni zonjën Rezarta Tahiraj.

Mirë se erdhët, zonja Tahiraj!

Rezarta Tahiraj – Mirëdita!

Vasilika Hysi – Ju jeni para një komisioni, i cili dëgjon dhe do të përzgjedhë nëpërmjet votës për të kaluar si propozim në seancë plenare anëtarët e Kolegjit të Apelit. Ju keni kandiduar vetëm për Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nëse jam e saktë?

Rezarta Tahiraj - Po.

Vasilika Hysi - Ne kemi CV-në tuaj, të gjithë kolegët e komisionit kanë dosjen përpara. Brenda 3 minutash na thoni diçka më **shumë lidhur jo vetëm kriteret formalo-juridike, të cilat i ka parë edhe** komisioni i mëparshëm, por anën profesionale, meritokracinë. Pse ne duhet t’ju votojmë juve për të qenë anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit?

Faleminderit!

Rezarta Tahiraj – Faleminderit, e nderuar!

Faleminderit, anëtarë të komisionit!

Faleminderit edhe medias, që ndodhet këtu sot prezent!

Do ta përmbledh shumë shkurt të gjithë eksperiencën time rreth 18-vjeçare për t’iu përgjigjur pyetjes që më drejtuat, në cilësinë e kryetares së këtij komisioni. Unë besoj shumë te roli i paanësisë, i cili ka një kapacitet shprehës maksimal në pushtetin gjyqësor, dhe ofroj

kontributin tim, eksperiencën që unë kam maturuar gjatë këtyre 18 vjetëve në fushën e studimeve juridike, jo vetëm në aspektin akademik dhe të kërkimit shkencor, ku edhe aktualisht punoj në universitetin publik “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan. Atje kam jo vetëm rolin e Profesorit të Asociuar, por edhe të drejtueses së Departamentit të së Drejtës pranë Fakultetit Ekonomik të këtij universiteti, si dhe kam një eksperiencë të maturuar edhe në aspektin profesional në ushtrimin e detyrës sime si avokate brenda dhe jashtë Shqipërisë, ku dua të theksoj, njëkohësisht, edhe aspektin akademik, që është jo vetëm në nivel nacional dhe ndërkombëtar në formimin që unë kam në drejtimin e fushës “E drejta tatimore europiane”, në studimet që unë kam ndjekur në doktoraturë në Shkollën e Doktoraturës për të Drejtën Tatimore Europiane në Universitetin e Bolonjës, si dhe eksperiencën të tjera të maturuara në këtë drejtim, si në universitetin e Strasburgut dhe në universitete të tjera, siç është ai i Castilla-La Mancha-s në Spanjë, ku jam përballur me shkëmbimin e eksperiencave, ideve dhe opinioneve në fushën e së drejtës së vendeve anëtare të Bashkimit Europian, të vetë së drejtës europiane dhe të drejtës ndërkombëtare.

Së fundi, dua të theksoj edhe një eksperiencë që unë e kam fituar ndër vite, duke filluar nga viti 2010, kontribut që e kam ofruar edhe në drejtim të përballjes me betejat me karakter ndërkombëtar në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe mbrojtjes së mjedisit, si presidente e shoqatës “AKREP”. Pikërisht këtu dua të theksoj se kjo shoqatë ka vepruar vetëm mbi bazën e ideve dhe aksioneve, pasi nuk administron para, por ide dhe aksione, është bërë shumë aktive në çështje të cilat kanë qenë sensibilizuese, me karakter ndërkombëtar në komunikimet që i janë drejtuar si përfaqësueses së lartë të Bashkimit Europian për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë, të nderuarës Federica Mogherini, njëkohësisht edhe në komunikimet që janë realizuar me ministrin e Drejtësisë të qeverisë hungareze.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Tahiraj!

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Kemi një pyetje që ua drejtojmë të gjithë kandidatëve: a keni ju lidhje me politikën? A jeni marrë me politikë?

Rezarta Tahiraj – Jo, aspak. Gjithmonë i jam dedikuar aspektit akademik dhe shoqërisë civile.

Vasilika Hysi – Ka pyetje të tjera nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit!

CV-në e kemi përpara bashkë me gjithë dokumentacionin.

Faleminderit, zonja Tahiraj! Ditë të mbarë!

Ju lutem, të njoftohet zoti Roland Ilia.

Mirë se erdhët, zoti Ilia!

Ju keni kandiduar për anëtar të Komisionit të Pavarur të Kualifikimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, jeni para komisionit *ad hoc* të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë për t'u përzgjedhur, për t'u votuar dhe për t'u dërguar në seancë plenare nëse ju merrni votat për pozicionin anëtar i këtij Kolegji.

E kemi dosjen tuaj përpara dhe CV-në, ndaj do të doja, ju lutem, brenda tri minutash të flisni diçka më shumë lidhur me meritokracinë, kriteret profesionale, vlerat që ju keni krahas kriterëve formalo-juridike.

Roland Ilia – Po.

Nga viti 1996, kur kam mbaruar studimet, dhe deri sot jam pedagog në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër. Për njëzet vjet jap mësim pranë katedrës të së drejtës civile, për shtatëmbëdhjetë vjet kam dhënë të drejtën romake, ndërsa tani jap të drejtën civile.

Gjatë periudhës 1999-2000 kam shkuar në Gjermani, në institutin për të drejtën e linjës në Këln, dhe kam studiuar në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në periudhën 2001-2002 kam qenë student po prapë në Universitetin e Këlnit dhe kam ardhur në shtator të vitit 2002 me gradën “Magister Legum” ose master i ligjeve në po atë universitet. Ndërsa gjatë periudhës 2008-2009 kam kryer dy semestra për lirinë e fesë në Universitetin e Hamburgut dhe qysh nga vitet 2009-2010 e këtej vazhdoj doktoraturën në Universitetin e Giessen-it, ku kam përfunduar tashmë disertacionin dhe kam provimin me zë.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Ilia!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Kam një pyetje që ua drejtojmë të gjithë kandidatëve: a jeni i lidhur me politikën?

Roland Ilia – Jo.

Vasilika Hysi – Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Kur e keni mbrojtur gjuhën angleze?

Roland Ilia – Anglishten?

Eduard Halimi – E keni të mbrojtur, apo jo?

Roland Ilia – Nuk e mbaj mend. Kam dhënë një provim të TOEFL-it dikur, por anglishten e di shumë mirë.

Eduard Halimi – TOEFL-in keni?

Roland Ilia – Po, TOEFL-in: Test of English as a Foreign Language.

Eduard Halimi – Ke diplomë, apo jo?

Ervin Bushati – Është ndërkombëtare.

Eduard Halimi – Ke diplomë, apo jo, ke certifikatë?

Roland Ilia – Nuk e di a e kam në dosje, por anglishten e di shumë mirë.

Vasilika Hysi – Po, normal, gjithë këto rrugë jashtë shtetit dhe kualifikime...

Ka pyetje të tjera, ju lutem?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka.

Faleminderit, zoti Ilia!

Roland Ilia – Ju falënderoj edhe unë! Gjithë të mirat dhe punë të mbarë!

Vasilika Hysi – Ju lutem, kjo intervistë është vetëm për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, sepse nëse ju nuk votoheni nga ne, do të keni një intervistë edhe te Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve. Pra, nuk është e njëjta intervistë, është komision tjetër.

Roland Ilia – Jam i qartë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Dakord. Jua thashë, sepse nuk do të doja të kishim probleme.

Roland Ilia – Ju falënderoj! Ditën e mirë!

Vasilika Hysi – Gjithë të mirat!

Vazhdojmë me kandidatën e radhës, zonjën Shpresa Beçaj.

Shpresa Beçaj – Përshëndetje!

Vasilika Hysi – Mirë se erdhët, zonja Beçaj!

Ju keni kandiduar për anëtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky është komisioni i cili bën përzgjedhjen dhe votimin për t'ia dërguar seancës plenare kandidatët për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

Ne kemi dosjen tuaj përpara, kemi CV-në. Unë dhe zoti Noka kemi pasur mundësinë t'ju dëgjojmë edhe në Komisionin e Përzgjedhjes. Ju lutem, brenda tri minutave, na thoni diçka më shumë për meritokracinë, për kërkimin shkencor, punën dhe formimin profesional, sepse pjesën tjetër e dimë të gjithë.

Shpresa Beçaj – Faleminderit një herë që jam këtu përpara jush!

Në përgjithësi, unë nuk e kam shumë të lehtë që të flas për veten time, por detyra duhet kryer.

Në vitin 1983 kam përfunduar studimet në degën shkenca politike-juridike, pra jam diplomuar dhe menjëherë kam filluar punë në Gjykatën e Rrethit të Gramshit. Atje...

(Diskutime në sallë.)

Vasilika Hysi – Ju lutem, kolegë, fiken mikrofonin, sepse e pengoni zonjën Beçaj pa dashje!

Shpresa Beçaj – Nga viti 1983 deri në vitin 1987 kam punuar në Gjykatën e Rrethit Gramsh në pozicionin e kryesekretares dhe pastaj këshilltare ligjore.

Në vitin 1987 jam emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gramsh dhe në vitin 1990 jam transferuar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ku kam punuar deri në vitin 1994. Prej këtij viti dhe deri në vitin 2004 kam qenë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në mars të vitit 2004 jam emëruar gjyqtare në Gjykatën e Lartë.

Në tetor të vitit 2008 jam emëruar kryetare e Gjykatës së Lartë.

Në mars të vitit 2013 kam përfunduar mandatin dhe nga marsi i këtij viti deri në mars të vitit 2016 jam trajtuar me ligjin “Për sigurimet shoqërore” me pagë kalimtare.

Nga marsi i vitit 2016 dhe deri tani, për një periudhë prej gati 9-10 muajsh, kam hapur një studio ligjore dhe para një muaji e kam pezulluar.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Shpresa, të gjithë ju njohim!

Ka pyetje? Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Kam një pyetje që ua bëjmë të gjithë kandidatëve: a keni lidhje me politikën?

Shpresa Beçaj – A kam lidhje me politikën? Jo, nuk kam lidhje me politikën.

Vasilika Hysi – Kriter është që nuk duhet të jeni anëtare apo të keni pozicione drejtuese nëpër parti, se lidhje me politikën është tjetër pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zonja Vokshi.

Albana Vokshi – Jo, sepse, meqenëse jemi në fushatë zgjedhore dhe dimë se vajza e zonjës Beçaj është kandidatja e parë e një partie politike në qarkun e Kukësit, apo jam gabim Vangjel...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A mendoni ju se kjo pjesëmarrje në këtë nivel do të ndikojë në vendimet e ardhshme, nëse ju përzgjidheni? Pra, a do të ketë kontradiktë midis vajzës suaj në politikë,

apo edhe influencë ndaj detyrës suaj në komisionin ku ju keni aplikuar, pra si anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit?

Shpresa Beçaj – Mendimi im është absolutisht jo, gjithnjë në qoftë se doni të dini mendimin tim.

Albana Vokshi – Për tuajin po pyesim.

Shpresa Beçaj – Po pra, mendimi im është absolutisht jo!

Në qoftë se doni të them arsyet sipas bindjes sime...

Albana Vokshi – Po, po, çfarëdo që mund të na shpjegoni.

Shpresa Beçaj – Arsyet sipas bindjes sime, në qoftë se vajza ime ka kandiduar për një parti politike, kjo nuk ka fare lidhje, sepse ju thoni në të ardhmen.

Vasilika Hysi – Zonja Beçaj, faleminderit! Ju nuk jeni e detyruar t'u përgjigjeni pyetjeve...

Albana Vokshi – Atëherë...

Vasilika Hysi – ...që dalin jashtë...

Albana Vokshi – O Vasilika...!

Vasilika Hysi – Jo, do t'ju lutesha...

Albana Vokshi – Nëse ju nuk na lejoni të bëjmë pyetje...

Vasilika Hysi – Ju lejova.

Albana Vokshi – ...dhe nuk e lejoni zonjën të përgjigjet, atëherë na thoni që ta mbyllim këtu.

Vasilika Hysi – Ja, ta mbaroj fjalinë, se ma latë në mes: një nga kriteret që parashikon Kushtetuta është që kandidati...

Albana Vokshi – Atëherë, ta mbyllim, të mos bëjmë fare *hearing* sot?

Vasilika Hysi – ...nuk duhet të ketë funksione drejtuese në partitë politike gjatë dhjetë vjetëve të fundit. Pra, mund të jetë edhe anëtar partie, por nuk duhet të ketë funksione drejtuese.

E bëra këtë ndërhyrje për qartësim, sepse duke i bërë pyetje për fëmijën, vjehrrin, vjehrrën, krushkun, krushkën a ku ta di unë, ne dalim jashtë kërkesave...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndjesë, se nuk e kam për juve!

Albana Vokshi – O Vasilika, pyetja ime ishte...

Vasilika Hysi – Por për sqarim, se krijohet një përshtypje...

Albana Vokshi – A mund të ketë konflikte nesër, pasnesër, vendimmarrjeje apo influencë?

Vasilika Hysi – Ç’lidhje ka komisioni i vetingut me politikën?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nuk e kupton ti?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eduard Halimi – Për procedurë.

Albana Vokshi – Çdo gjë në këtë listë është e orientuar politikisht, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E tha edhe kolegu im, Noka, më përpara: 99% e listës është e orientuar politikisht, e orientuar nga Partia Socialiste politikisht. Këtë e dimë të gjithë. Telefonatat i dimë, prandaj ka pasur edhe interes shumë të ulët të profesionistëve shumë të mirë. Ju thatë që duhet të jenë më të mirët e të mirëve. Ne nuk i zgjedhim dot më të mirët e të mirëve, sepse lista është e përzgjedhur paraprakisht nga ana juaj dhe e Partisë Socialiste, pra e përzgjedhur politikisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Absolutisht, nuk e kam me anën profesionale!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, është tjetër diskutim!

Shpresa Beçaj – E nderuara zonja...

Albana Vokshi – Zonja Beçaj, është tjetër diskutim, nuk e kam për ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, s’është me juve, është përtej jush.

O na lini të...

Vasilika Hysi – Jemi në fushatë ne përfaqësuesit e partive këtu, prandaj, ju lutem...!

Eduard Halimi – Për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana, të lutem!

Shpresa Beçaj – Zonjë e nderuar...

Eduard Halimi – O zonjë, prisni, se e kemi ne, flasim ne!

Kur të bëjmë pyetje...

Vasilika Hysi – Zoti Halimi, fjalën jua jap unë!

Eduard Halimi – Për procedurë.

Vasilika Hysi – Po, për procedurë dhe të flasim me radhë.

Eduard Halimi – Jam për procedurë, jam nënkryetar i komisionit!

Tani, edhe një herë, të jetë hera e fundit që i ndërpret deputetët!

Mbret i pyetjes është deputeti. Kandidatja atje apo kushdo të jetë atje, është mbret i përgjigjes. Dakord? Mos i ndërprit më kolegët kur bëjnë pyetje!

E dyta, mos dil kaq hapur, sepse sa herë vjen një kandidate, për të cilën ju e keni ndarë mendjen se do t'ia jepni votën, ju filloni të ndërhyni për të ndihmuar kandidatët. Mos dilni kaq hapur! Mirë? As mos i orientoni kandidatët, sepse dilni keq publikisht. Nuk ju shkon as juve, as të tjerëve. As pyetjet hipokrite: “Ke apo nuk ke lidhje me politikën?” Jurist i emëruar nga Kryeministri personalisht, pa konkurs. “Ke lidhje politike? Jo, nuk kam”. Ja, pra nuk paska lidhje me politikën.

Vasilika Hysi – Ç’lidhje ka kjo?

Eduard Halimi – Gjithë jetën jurist në OSHEE, i emëruar pa konkurs.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

“A ke lidhje? Jo, nuk kam lidhje me politikën”. Ja, pra, nuk ka lidhje me politikën; jurist tek ALUIZNI. “A keni lidhje me politikën? Jo, nuk kam lidhje me politikën”.

Ndaj le ta lëmë farsën, të dëgjojmë. Secili nga deputetët është mbret i pyetjes dhe secili nga kandidat është mbret i përgjigjes. Kaq.

Ju lutem, edhe një herë, mos guxoni t'ia ndërprisni më fjalën anëtarëve të komisionit!

Vasilika Hysi – Ju lutem!

Mbledhjen e drejtoj unë dhe po sjell në vëmendjen tuaj nenin 7 të rregullores, nuk dua ta rilexoj për herë të dytë, se si zhvillohet seanca dëgjimore dhe kush ka të drejtë t’jua japë fjalën, si dhe kush nga ju nuk ka të drejtë të ndërhyjë: nuk keni të drejtë të ndërhyni kur flet kandidati, nuk keni të drejtë ta bëni kandidatin pjesë të debatit politik, madje asnjë kandidat! Këtu do të jem e fortë dhe do të vazhdoj.

Në rast se ne do të bëjmë politikë, meqenëse jemi në fushatë, nuk kemi të drejtë të bëjmë pjesë të këtij debati kolegët.

Tani e ka kërkuar fjalën zoti Tavo.

Albana Vokshi – A mund të sqaroj vetëm diçka?

Vasilika Hysi – Ka një radhë.

Albana Vokshi – Se ishte pjesa e kësaj.

(Deputeti Halimi flet pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Anëtari ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe saktësime pasi të ketë...

Albana Vokshi – Atëherë, zonja Hysi...

Vasilika Hysi – Jo, jo, pasi të ketë përfunduar radha për secilin nga anëtarët e tjerë. Pra, do t’ju vijë radha...

Albana Vokshi – E kisha në vijim të pyetjes sime.

Vasilika Hysi – Jo, më falni, neni 7, zonja Vokshi...!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Atëherë, meqenëse jemi këtu për të qartësuar...

Vasilika Hysi – Po jua lexoj rregulloren: “Anëtari ka të drejtë të kërkojë sqarime...

Albana Vokshi – O zonja Hysi!

Vasilika Hysi – ...dhe saktësisht vetëm pasi të ketë përfunduar radha për secilin prej anëtarëve të tjerë”.

(Deputeti Noka flet pa mikrofon.)

Të flasë anëtari tjetër dhe pastaj do të flisni ju.

(Deputetja Vokshi flet pa mikrofon.)

Flamur Noka – O Vasilikë, se nuk dua të ndërhyj, të lutem, vetëm kasetën mos!

(Deputetja Hysi flet pa mikrofon.)

Vangjel Tavo – Unë, në fakt, edhe pse jemi pothuajse në fund, kanë ngelur shumë pak kandidatë, e kërkova fjalën për procedurë.

Duhet të kemi parasysh referencën ligjore. Ligjvënësi kur e miratoi ligjin kishte parashikuar faktin nëse kandidatët janë pjesë e forumeve drejtuese dhe jo, madje as anëtarë partie, se kështu i bie që, nëse dikush ka një vajzë, një djalë apo një kushëri, apo një krushkë, ta pyesim: për kë voton Shpresa? Nuk ka kuptim, apo jo? Mendoj se duhet të jemi të kujdesshëm me pyetjet që bëjmë. Nuk duhet të bëjmë pyetje që ligji nuk i parashikon, sepse kalojmë në denigrim të personit. Referencat kryesore janë aftësitë profesionale, gjë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket pyetjes nëse keni lidhje me politikën, ne sot dëgjuam...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ka lidhje me politikën, i bie që ne t’i referohemi gjithmonë ligjit. Pra, t’i bëjmë pyetjet brenda kornizës ligjore.

Albana Vokshi – Ashtu është, por po flet për anën profesionale. Kur kanë dalë emrat, qoftë të kandidatëve për deputetë apo qoftë lista këtu, i gjithë publiku e ka parë në media që ka pasur...

Vangjel Tavo– Nuk ka lidhje kjo.

Albana Vokshi – Më lejo ta mbaroj. A jemi këtu për ta zhveshur mbase edhe zonjën Beçaj nga një akuzë apo kritikë që i është bërë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë le t'i themi. Çfarë problemi ka këtu?

Vangjel Tavo – Ky ligj është miratuar para hartimit të listave, apo jo? Ligjvënësi duhet ta kishte parashikuar edhe këtë dhe të thoshte që, kandidatët të cilët do të kenë nesër...

Albana Vokshi – Unë mendoj që ne po fryjmë një diskutim pa lidhje.

Vangjel Tavo – Ngaqë nuk duhet fryrë, unë mendoj që ta mbyllim dhe të vazhdojmë me procedurën.

Albana Vokshi – Nëse nuk ka asnjë lidhje, atëherë e lëmë këtu, por ngaqë ka diçka përtej kësaj...

Vangjel Tavo– Paraprakisht, nga ju apo zoti Halimi, u tha që ju i keni paracaktuar kandidatët.

Zoti Noka në fillim përmendi tre kandidatë, por zonja Beçaj nuk ishte në atë treshe.

Albana Vokshi – Zoti Tavo ju po i hidhni kot benzinë zjarrit, sepse kjo është për ta qartësuar. Zonja Beçaj e ka një mundësi për të zhvlerësuar të gjithë atë...

Vangjel Tavo – Unë nuk shquhem për t'i hedhur benzinë zjarrit, por jam gjithmonë ai që i hedh ujë në këto konflikte.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Faleminderit, zonja Beçaj dhe ju urojmë një ditë të mbarë!

Vazhdojmë me zotin Sokol Çomo.

Mirë se erdhët, zoti Çomo!

Sokol Çomo – Mirë se ju gjeta!

Vasilika Hysi – Jeni ftuar për t'u dëgjuar para komisionit ad hoc, i cili do të përzgjedhë dhe do të votojë për t'i dërguar seancës plenare anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ju keni kandiduar vetëm për të qenë anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Të gjithë kolegët e komisionit e kanë dosjen dhe jetëshkrimin tuaj. Na thoni diçka më shumë lidhur me përmbushjen e kriterëve që lidhen me profesionalizmin dhe meritokracinë, kërkesa këto të nenit 6, pika 2 të ligjit nr. 84\2016.

Faleminderit!

Ju lutem shprehuni për 3 minuta për t'u dhënë më pas mundësi kolegëve të bëjnë pyetje.

Sokol Çomo – Faleminderit!

Për të mos u zgatur, sepse besoj se CV-ja ka qenë e plotë, dua të them se kam kryer studimet në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë nga viti 1990 deri në vitin 1994. Në vitin 1995 kam filluar veprimtarinë time si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në muajin tetor të vitit 1998 kam marrë një ftesë nga Kryeministri i asaj kohe për të shërbyer në funksionin e zëvendësministrit të Drejtësisë, të cilin e kam ushtruar deri në muajin mars të vitit 2000. Më pas jam rikthyer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku kam vazhduar veprimtarinë time si gjyqtar dhe në të njëjtën si kryetar i kësaj gjykate deri në muajin janar të vitit 2006.

Kam qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga viti 2002 deri në vitin 2007. Nga viti 2006 e në vazhdim kam ushtruar profesionin si avokat, të cilin e kryej edhe aktualisht. Nga viti 2013 deri më tani, vazhdoj të përmbush detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Prej vitit 2001 e në vazhdim jam pedagog në Shkollën e Magjistraturës për lëndën e Procedurës Civile.

Nuk kam asnjë pengesë ligjore nga ato që ligji parashikon për kandidatët që duan të konkurrojnë për Kolegjin e Apelimit.

Sikurse edhe ju e thatë, kam konkurruar vetëm për pozicionin e anëtarit të Kolegjit të Apelimit, sepse është i vetmi organ i cili ka fizionominë e një gjykate dhe për shkak të veprimtarisë sime të mëparshme si gjyqtar dhe njohjes që kam për sistemin gjyqësor. Nuk mendoj se ndonjë gjë tjetër është e nevojshme.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Çomo!

Keni pyetje kolegë?

Po, zoti Noka!

Flamur Noka – Nuk e paragjykojmë aspektin profesional të zotit Çomo, sepse të gjithë e vlerësojmë aspektin profesional të tij, por ai përmendi një problem politik.

Fakti që ka qenë zëvendësministër në një qeveri socialiste, është problem moral. Angazhimi politik tregon që besueshmëria është e cenuar. Për sa i përket aspektit profesional nuk kemi vërejtje, por angazhimi politik humbet besueshmërinë dhe pranueshmërinë.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Noka!

Për transparencë, dua të sqaroj që ishte forca juaj politike, që pasi propozoi që të shtohet si kusht që kandidatët nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike në 10 vjetët e fundit, që e kundërshtoi me të madhe, madje e keni çuar në Gjykatën Kushtetuese, sepse e kam mbrojtur unë ligjin, dhe keni thënë që është shkelje dhe diskriminim i kandidatëve...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Jo, do të bëjmë sqarim publik për të gjithë pse kemi vënë kriter dhe i diskriminojmë njerëzit për karrierën e tyre. Madje, ju keni kërkuar ta hiqni afatit 10 vjeçar, jo më zoti Çomo që ka 17 vjet. Nuk e kam për zotin Çomo, por në parim.

Duhet të jemi korrektë për të gjitha kriteret, sepse krijojmë një imazh shumë negativ, aq më tepër që jemi në transmetim në media.

Kriteret kushtetuese janë: Kandidati duhet të ketë jo më pak se 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter dhe në 10 vjetët e fundit nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratë dhe funksione drejtuese politike.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Çomo.

Sokol Çomo – Dua të sqaroj diçka lidhur me shqetësimin që u ngrit nga anëtari i komisionit.

Është e vërtetë që para 19 vjetëve kam pranuar të ushtroj një detyrë, por në atë pozicion kam shkuar si një njeri teknik dhe pa qenë asnjë ditë të vetme anëtar i ndonjë partie politike.

Kjo do të thotë, që nuk kam shkuar aty për shkak të aktivitetit politik, por ka qenë një ftesë, të cilën, përsëri, edhe pas 19 vjetëve, ndoshta, pavarësisht nga persekucioni që mund të më ketë ndjekur në 19 vjet duke u perceptuar si i pozicionuar politikisht, do të thosha që e kam konsideruar si një shërbim që gjyqtarët e praktikës duhet të bëjnë në karrierën e tyre, qoftë duke shërbyer pranë Ministrisë së Drejtësisë apo edhe në institucione të tjera të drejtësisë për arsyen se këto institucione kanë nevojë që njerëzit e praktikës të çojnë aty kontributin e tyre. Marrja përsipër e atij pozicioni ka qenë thjesht vetëm në këtë kuadër.

E deklaroj me përgjegjësi të plotë, që jo vetëm në atë moment nuk jam përfshirë në ndonjë veprimtari politike ose të ketë edhe një deklaram të vetëm timin me kontekst politik, por vazhdimi i mëtejshëm i veprimtarisë gjyqësore besoj që e ka konfirmuar, që, fakti që kam ushtruar atë detyrë, nuk ka pasur asnjë ndikim sado të vogël në veprimtarinë time të mëtejshme.

Aktualisht, e them me përgjegjësi dhe bindje të plotë, nuk bëj pjesë në asnjë parti politike dhe nuk kam asnjë aktivitet që do të cenonte sado pak besueshmërinë lidhur me perceptimin që duhet të ketë publiku për kandidatët e këtyre organeve.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Çomo dhe ju urojmë një ditë të mbarë!

Radhën e ka zonja Suela Zhegu.

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Ishim në momentin e pyetjeve dhe bëre komente politike duke mashtruar opinionin publik. Mos e mashtro opinionin publik.

The që Partia Demokratike paska qenë dhe është e mendimit që të futen njerëz politikë dhe se ne na ardhka keq që përjashtohen njerëzit politik. Kjo është një mashtrim. Mos mashtro.

Nga dita e parë që ka filluar procesi i hartimit të ndryshimeve kushtetuese, kemi pasur qëndrim që të mbajmë jashtë njerëzit e politikës, të majtë apo të djathtë qofshin. Jo 10 vjet, por kemi kërkuar edhe 30 vjet.

Duhet të jemi koherentë, unë kam qenë koherent, anëtarët tanë kanë qenë koherentë me zotërinjtë që kemi pasur në seanca dëgjimore.

Kemi qenë dhe jemi të mendimit që të lëmë jashtë sistemit njerëzit që kanë shërbyer në funksione politike.

Kushtetuta ka vendosur afatin 10 vjet, e kemi votuar ne, por tani çështja shtrohet te besimi publik që kalon nëpërmjet deputetëve. A ka besimin publik të opozitës një person i cili ka kryer një funksion para 10 apo 20 vjetëve? Kjo është çështje e votimit. Prandaj e kemi bërë me votim dhe jo në ajër, si mendon Vasilika apo si mendon Halimi.

Së pari, mos gënje dhe së dyti, mos bëj komente. Dakord?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Halimi!

Së pari, ruani etikën.

Së dyti, më vjen keq, por ju u zëvendësuar në Komisionin e Reformës në Drejtësi, kurse unë jo. Është e vërtetë që ju kërkuat 10 vjet, por ata që ju zëvendësuan më pas, protestuan.

Lexoni pak pretendimet që keni depozituar në Gjykatën Kushtetuese. Qëndrimet brenda partisë suaj kanë qenë të ndryshme, por nuk është faji im që ju nuk merreni vesh me njëri-tjetrin.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Vazhdojmë me kandidaten Suela Zhegu

Zonja Suela, mirë se erdhët!

Më fal, Suzana...

Nuk është paraqitur zonja Suela Zhegu?

Flamur Noka – Aq shumë gënjeni dhe mashtroni saqë ngatërroni edhe emrat e kandidatëve.

Radhën e ka zonja Suzana Pasha Hoti.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Nuk zverdhem, sepse jam korrekte dhe konsistente në atë që them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Suzana, ju keni kandiduar për të gjitha pozicionet. Jeni këtu për t'u intervistuar për pozicionin e kandidatës për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Jemi komisioni i përzgjedhjes dhe votimit, që çon kandidaturat për në seancën plenare.

Ne e kemi dosjen dhe cv-në tuaj, por na thoni diçka më shumë lidhur me pjesën e kritereve që kërkon ligji “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pra, jo thjesht arsimin, sepse e kemi parë, por kualifikimet e mëtejshme dhe përvojën që keni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Suzana, ndizeni mikrofonin, sepse nuk është regjistruar asnjë gjë.

Suzana Pasha Hoti – Arsyeja kryesore që më shtyu të kandidoj, është fakti që unë kam punuar gjatë gjithë kohës, nga viti 1994 e deri sot në vitin 2017, në profesion. Kam punuar 6 vjet e gjysmë ndihmës gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe më pas avokate, gjë që e bëj edhe sot, me të drejtë përfaqësimi në ta gjitha nivelet e gjyqësorit.

Duke punuar në profesion, të nderuar anëtarë të komisionit, mendoj që i njoh konsiderueshëm problemet e gjyqësorit. Unë nuk kam qenë kurrë vendimmarrëse, për shkak se kam qenë ndihmëse gjyqtare dhe sot avokate, por mendoj se nëse do të më jepet mundësia për të qenë vendimmarrëse, unë do të jem një pjesë e shëndoshë e këtij komisioni për të çuar më përpara reformën dhe sistemin e drejtësisë.

Unë kandidova jo për arsyen se plotësoj kriteret, por sepse në një pjesë të ligjit, konkretisht e shtesës së Kushtetutës, ishte edhe pjesëmarrja e ndërkombëtarëve në këtë proces të rëndësishëm të reformës në drejtësi, të cilët kishin cilësinë e rekomanduesve.

Unë besoj që aftësitë e mia profesionale, integriteti im dhe fakti që kam punuar gjithmonë në profesion, janë arsyet që komisioni do ta vlerësoj pozitivisht kandidaturën time.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Pasha Hoti!

Keni pyetje kolegë?

Po, zoti Noka.

Flamur Noka – A keni dokument që e njihni gjuhën angleze?

Suzana Pasha Hoti – Po.

Flamur Noka - Çfarë niveli?

Suzana Pasha Hoti – Nëse e kam këtu, kryetar, ta jap.

Flamur Noka – Jo, jo, çfarë niveli?

Suzana Pasha Hoti – Nivelit “Mirë”.

Flamur Noka – Në universitet e keni mbrojtur?

Suzana Pasha – Në universitet.

Flamur Noka – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Pasha Hoti!

Ka pyetje?

Nuk ka pyetje.

Faleminderit, zonja Pasha dhe ju urojmë një ditë të mbarë!

Suzana Pasha Hoti - Faleminderit juve!

Vasilika Hysi – Vazhdojmë me zonjën Valbona Sanxhaktari.

Mirë se erdhët, zonja Sanxhaktari!

Kjo është intervistë përpara komisionit *ad hoc*, të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë, për të bërë përzgjedhjen dhe votimin për t’ia kaluar më pas seancës plenare kandidatët për anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ju keni kandiduar për të tria pozicionet?

Valbona Sanxhaktari – Për dy pozicione.

Vasilika Hysi – Për cilin keni kandiduar, ju lutem?

Valbona Sanxhaktari – Për kolegjin dhe komisionin.

Vasilika Hysi – Kjo do të thotë që do të keni intervista të veçanta për secilin pozicion.

Ne kemi dosjen dhe CV-në tuaj, por duam të na thoni diçka më shumë për kriteret që kanë të bëjnë me profesionalizmin, meritokracinë, kualifikimet tuaja brenda dhe jashtë vendit dhe jo thjesht detyrat që keni bërë për 15 vjet si avokate, gjyqtare apo juriste. Fjala është për ju!

Ju lutem, vetëm 3 minuta!

Valbona Sanxhaktari – Faleminderit!

Unë jam Valbona Sanxhaktari. Kam mbaruar studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1996. Aktualisht jam Doktore e Shkencave në shkencat juridike. Jam përpjekur gjatë gjithë jetës sime t’i azhurnoj dhe t’i freskoj dijet e mia, duke bërë kualifikime, studime etj. Kam një përvojë si juriste prej 19 vjetësh. Kam punuar kryesisht në administratën shtetërore. Kam punuar si eksperte ligjore me projekte të BB-së, dhe kam dhënë mësim në universitet për një kohë relativisht të gjatë. Mendoj që i plotësoj të gjitha kriteret për të cilat u bë shpallja. Kam një integritet të lartë moral dhe profesional. Nuk kam pasur asnjëherë funksione drejtuese apo funksione shumë të rëndësishme, pra kam

pasur gjithmonë pozicione teknike. Mendoj se jam një juriste e mirë në fushën time dhe i plotësoj të gjitha kriteret për të cilat u bë shpallja.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Sanxhaktari!

Kush ka pyetje?

Urdhëroni zonja Vokshi!

Albana Vokshi – Në CV-në tuaj shoh që nga muaji shkurt i vitit 2014 deri më sot ju jeni juriste në Njësinë e Legjislacionit dhe Akteve Ligjore në Kryeministri. Jeni pranuar me konkurs?

Valbona Sanxhaktari – Po, unë kam konkurruar. Në atë kohë ishte në fuqi akoma legjislacioni i vjetër për nëpunësin civil. Unë kam konkurruar për 5 vende dhe nga këto 5 vende ku kam konkurruar në 3 vende kam dalë absolutisht e para. Në dy të tjera kanë qenë të parat dy kandidatura të tjera. Në vendet ku unë kam konkurruar (mesa mbaj mend për ato vende ishin 30 aplikantë), nga të cilët kanë dalë 15 veta dhe unë kam qenë e para ndër të gjithë ata që kanë dalë. Është dashur rreth 1 muaj që të më zgjidhnin. E kam dashur gjithmonë pozicionin ku unë jam. Një nga pozicionet e mia të preferuara ka qenë ose zyra e legjislacionit në KM ose në Kuvend pranë Komisionit të Ligjeve, sepse mendoja se ishte një punë shumë pranë asaj që unë dija të bëja. Unë e ndjeja veten si specialiste të teknikës legjislative. Më morën në punë më 28 shkurt.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Kush ka pyetje të tjera? S’ka.

Faleminderit, zonja Sanxhaktari!

Ditë të mbarë!

Valbona Sanxhaktari – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Ju lutem, ftoni zotin Vojo Malo!

Mirëserdhët zoti Malo!

Ju keni kandiduar për të gjitha pozicionet.

Vojo Malo – Po.

Vasilika Hysi – Sot jeni para komisionit *ad hoc* të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë për të bërë përzgjedhjen dhe për të bërë votimin për ta çuar në seancë anëtarin e kolegjit të posaçëm të apelimit. Këtu kemi dosjen tuaj. Do të donim shumë shkurt, brenda 3 minutave të na jepnit diçka më shumë në lidhje me meritën, kualifikimin dhe profesionalizmin tuaj me qëllim që një nga 6 anëtarët e këtij komisioni t’ju votojë dhe t’ia propozojë seancës kandidaturën tuaj për në një nga organet më të rëndësishme që do të bëjë vlerësimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Vojo Malo – Faleminderit!

Besoj se edhe nga kandidatët para meje duhet ta keni dëgjuar shprehjen: “Unë jam më i miri, prandaj duhet të më zgjidhni mua”, por unë kam edhe një histori. që fëmijë, kur kam filluar të luaj volejball, trajneri im i parë (në atë kohë isha 15-16 vjeç), më ka dhënë një këshillë që më ka mbetur në mendje: sa herë që të futesh në një garë, duhet të mendosh që ti je më i miri. Kjo më ka udhëhequr gjatë gjithë jetës sime. Sot jam 59 vjeç dhe kam eksperiencën e mjaftueshme.

Kam kryer studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në vitin 1995 kam kryer një kurs pasuniversitar në Londër në *Queen Mary Westfield College* për të drejtën tregtare dhe kam që nga viti 1996, qëkur u ktheva nga Londra, që po punoj si avokat. Është gjithmonë në gjykimin e atyre që do të votojnë për mua, por unë kam eksperiencën dhe shembullin e Londrës. Kur aplikova atëherë dhe kërkova të merrja pjesë në atë kurs megjithëse isha mbi moshën e caktuar maksimale. Kur shkova në Londër, i pyeta pse më kishin zgjedhur mua nga 36 aplikantët shqiptarë, të cilët ishin brenda moshës së duhur. Aty pashë konceptin se si i vlerësonin ata kandidatët. Më thanë se isha i vetmi që përveç anës së mjaftueshme profesionale, që kisha vënë në CV hobi. Sigurisht, kisha disa hobi të mija sportive, muzikore etj.

Nëse doni detaje për punën time si avokat ose para kohës kur kam filluar punë si avokat, mund t’ju flas më me detaje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Malo!

Ju e keni arsimin, kualifikimin profesional dhe të tjerat.

Kush ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni zoti Bushati!

Zoti Bushati ka merak, nëse keni qenë pjesë e strukturave drejtuese të partive. Ai i pyet të gjithë për këtë.

Ju e keni vënë vetë në CV ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vojo Malo – Kam hobi të gjitha llojet e sporteve përveç skive, që nuk i kam ushtruar deri më sot.

Flamur Noka – Pra, përveçse jurist jeni edhe sportist.

Vojo Malo – Aktualisht unë jam kryetar i Komisionit të Etikës në Komitetin Olimpik Shqiptar. Kam qenë kryetari i Arbitrazhit Sportiv. Më parë kam qenë kryetar i Arbitrazhit në Ministrinë e Industrisë Ushqimore.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Malo!

Ditë të mbarë!

Ju lutem, të ftoni zonjën Xhensila Pine!

Mirëserdhët, zonja Pine!

Ju keni kandiduar për të gjitha pozicionet.

Kjo është një intervistë para komisionit *ad hoc* të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë për të bërë përzgjedhjen dhe për të çuar në seancë anëtarin e kolegjit të posaçëm të apelimit. Do të bëni tjetër intervistë për pozicionet e tjera. Kemi para CV-në dhe dosjen tuaj me të gjithë dokumentacionin e depozituar nga Avokati i Popullit.

Do të donim shumë shkurt, brenda 3 minutave të na thoshit diçka më shumë në lidhje me meritokracinë, me profesionalizmin tuaj. Pra, krahas kritereve juridiko-formale që i ka verifikuar komisioni i mëparshëm.

Nëse keni gjë për të shtuar, jeni e lutur ta thoni diçka më shumë për profesionalizmin tuaj, për formimin tuaj profesional brenda dhe jashtë vendit, që ne t'ju votojmë.

Faleminderit!

Xhensila Pine – Faleminderit!

Në lidhje me profesionalizmin mendoj se kjo është një nga pikat e mia më të forta, që më shtyu të aplikoj për këto pozicione. Mendoj se përvoja ime në institucionet e rëndësishme të veçantë siç është pastrimi i parave, si shefe e inspeksionit, më ka bërë një kandidatë të vlefshme në lidhje me faktet që do të diskutohen nga ligji i ri dhe me të gjitha procedurat, të cilat janë të ngjashme me procedurat e pastrimit të parave dhe kontrollit të pastërtisë së figurës dhe kontrollit të pasurisë së gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Vlen të theksohet se gjatë punës në ILDKPI, kam kryer trajnime të ndryshme jashtë vendit të organizuara nga *Federal Bureau of Investigation* (FBI-ja) dhe nga FinCEN-i, të cilat janë organizuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, në lidhje me çështjet e pastrimit të parave dhe luftimit të korrupsionit dhe të kriminalitetit në Shqipëri.

Vlen të theksoj dhe përvojën time si pedagoge e të drejtës kushtetuese për 10 vjet me radhë pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe atij të Shkencave Politike. Gjithashtu, kam përvojë pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut dhe mënyrën se si në një proces të caktuar ligjor apo administrativ duhet të kihen parasysh këto të drejta dhe liri.

Besoj se këto përvoja profesionale duke u shoqëruar me integritetin moral për të cilin do të doja të theksoja se nuk kam pasur asnjëherë masa disiplinore ose largime nga vendi i punës apo mënyra të ndryshme dhe në të gjitha vendet e punës ku jam punësuar u

jam nënshtruar konkurseve të rregullta, besoj se këto janë pikat e mia të forta të CV-së për pozicionet për të cilat kam aplikuar.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Pine!

Kush ka pyetje nga kolegët?

Zoti Bushati, keni pyetje! Nuk ka.

Faleminderit!

Kjo ishte intervista vetëm për kolegjin e apelimit.

Xhensila Pine – Faleminderit, juve!

Vasilika Hysi - Ditë të mbarë!

Ju lutem, ftoni zonjën Rezarta Shuts!

Ndërkohë janë dhe 2 kandidatë që nuk kanë ardhur.

Ju lutem, të verifikoni nëse kanë ardhur zonja Klara Mullai dhe zonja Suela Zhegu.

Përshëndetje, zonja Shuts!

Ju keni aplikuar për pozicionin e anëtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Ky është i vetmi pozicion. Jeni para komisionit *ad hoc* të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë për të bërë përzgjedhjen për t'u votuar dhe për të çuar në seancë anëtarin e kolegjit të posaçëm të apelimit. Kemi para CV-në dhe dosjen tuaj me të gjithë dokumentacionin.

Do të donim shumë shkurt, brenda 3 minutave, të na jepnit diçka më shumë në lidhje me pjesën e dytë të kërkesave që ka ligji, për meritokracinë, për profesionalizmin tuaj në lidhje në një nga fushat që kërkon ligji për fushën e të drejtës kushtetuese, kualifikimet brenda dhe jashtë vendit. Ju lutem, shkurt në mënyrë që t'u japim mundësi kolegëve për të bërë pyetje!

Faleminderit!

Rezarta Shyts - Faleminderit!

Besoj se përveç atyre që janë në dosje, desha të vë në dukje që kam praktikuar pjesë të ndryshme të ligjit si në Shqipëri dhe jashtë vendit. Një pjesë të përvojës sime profesionale 5-vjeçare e kam në të drejtën penale, pranë gjykatës hibride të UMNİK-ut në Kosovë për krimet e rënda. Kam dhënë mësim pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe pranë Shkollës së Magjistraturës në lëndë të ndryshme ndër të cilat: shkrim dhe arsyetim ligjor, të drejtë kushtetuese të krahasuar dhe në 7 vjetët e fundit, puna ime ka qenë e përqendruar kryesisht në reformën në drejtësi. Kjo është bërë në kontekstin e Maqedonisë, por në bazë të detyrimeve dhe angazhimeve që Maqedonia ka si anëtare e OSBE-së dhe e organizatave të tjera ndërkombëtare në të cilat është anëtare edhe Shqipëria

dhe të standardeve ndërkombëtare, të cilat janë të detyruara t'i përmbushin vendet që aspirojnë të futen në BE.

Në këto 7 vjet nëpërmjet projekteve që kam drejtuar dhe menaxhuar (një staf prej 17-30 vetash), kam punuar gjerësisht me gjyqësorin, me prokurorinë, me profesionet ligjore (kryesisht në Maqedoni), me të drejtën penale direkt me gjykatën penale dhe me reformën në drejtësinë penale, me të drejtat e njeriut, me krimet e urrejtjes, me antidiskriminimin dhe me fusha të tjera të të drejtave të njeriut. Besoj se të gjitha këto më kanë dhënë një formim profesional, që më jep mundësi t'i shoh gjërat në gjerësinë 360 gradë.

Në të njëjtën kohë, kam pasur përvojë në menaxhim stafi dhe të burimeve njerëzore që më ka dhënë një përvojë relativisht të mirë në kuptimin e dinamikave në zyrë, të menaxhimit të stafit, të sjelljes profesionale në zyrë dhe të punuarit me njerëz të spondeve të ndryshme kulturore, moshave të ndryshme etj.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Shuts!

Nuk e di nëse e shqiptova saktë mbiemrin.

Rezarta Shyts – Shyts.

Në fakt unë kam aplikuar me të dy mbiemrat, sepse mbiemri i burrit që është shumë i vështirë, ka humbur rrugës.

Vasilika Hysi - Kush ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Noka!

Flamur Noka – Nuk kam asnjë pyetje.

Unë gëzohem që po të shoh duke qeshur tani.

Kaq kisha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se kisha për ju, por për Vasilikën.

Vasilika Hysi – Zoti Noka, unë po qesh, sepse pata shansin të ushtroja të drejtën kushtetuese që me 4 vota së bashku me votat tuaja zonja Shuts të kalonte në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, me kërkesën e opozitës dhe me bashkimin e votave të kolegëve të opozitës me votën time, u mundësua kjo. Do të ishte mirë ta kishit vazhduar përzgjedhjen e kandidatëve, që të kemi kandidatë shumë të mirë.

Urdhëroni zonja Vokshi!

Albana Vokshi – Kisha një sqarim. Meqë përmendët mbiemrin tjetër, desha të dija nëse keni ndonjë lidhje familjare me persona që punojnë aktualisht në gjykatë?

Rezarta Shyts – Po, nusja e xhaxhait është gjykatëse në Vlorë. Të tjerë nuk kam.

Vasilika Hysi – Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Faleminderit, zonja Shyts!

Ditë të mbarë!

Rezarta Shyts – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi - Ju lutem!

Stafi të verifikojë nëse ka ardhur zonja Klara Mullai! Nuk është paraqitur. Po zonja Suela Zhegu a është paraqitur? Jo.

Zoti Genci Bilali është në Amerikë dhe nuk ka mundësi të paraqitet.

Të nderuar kolegë,

Ishte një ditë e gjatë, e lodhshme, me tensione edhe për shkak të ngarkesës që ka kjo periudhë. Këtu po e mbyllim seancën dëgjimore. Do të njoftoheni për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ne mbyllëm dëgjesat. U lutem këshilltarëve në lidhje me 3 kandidatët që nuk janë paraqitur, të cilët besoj se nuk kanë kërkuar seancë që të dëgjohen. E kam fjalën për 3 personat që nuk janë të ftuar.

Jonida Tafaj – Mënyra e njoftimit të kandidatëve ka qenë kjo: I kemi dërguar email personal secilit, që na e ka dhënë vetë në jetëshkrimin e tij. Këta tre persona që nuk u paraqitën janë:

zonja Klara Mullaj që kishte konfirmuar paraqitjen, ishte deri në njëfarë periudhe pastaj u largua;

zoti Genti Bilali që është në Nju Jork, ndaj nuk mund të paraqitej;

zonja Suela Zhegu, që i kemi dërguar email, e kemi marrë në telefon edhe dje, edhe sot, por telefonin e ka pasur të fikur. E kemi marrë në atë numër që ka pasur të shënuar në jetëshkrimin e vet.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Do të doja t'u sillja në vëmendje se komisioni e mbyll këtë seancë dëgjimore me kandidatët, por ne kemi edhe një detyrë tjetër: në bazë të nenit 10 të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve” komisioni ynë do të votojë dhe procedura e votimit do të bëhet nëpërmjet një sistemi elektronik, për të cilin ne u njohëm dhe u trajnuam. Ky sistem mundëson një votim të fshehtë, ku secili anëtar do të votojë vetëm për një kandidat dhe më pas do të votohet pa debat përmes një votimi të fshehtë elektronik, ku secili prej nesh

ka të drejtë të votojë vetëm për një kandidat. Anëtari i shtatë do të votohet me një votim të thjeshtë.

Ndërkohë, në rast se do të ketë balotazh, pra kandidati i shtatë do të marrë vota të njëjta, hidhet shorti. Staf i Kuvendit bën gati procedurën për votimin elektronik sa më shpejt të jetë e mundur për shkak edhe të angazhimeve që ne kemi, por mos harroni se duhet të funksionojë edhe komisioni tjetër, sepse ligji kërkon që fillimisht të zgjidhen anëtarët e Kolegji të Posaçëm të Apelit dhe më pas, ata që kanë votuar në dy pozicione, në qoftë se ne zgjedhim një anëtar, ato hiqen nga lista dhe sistemi rregullohet, formatohet, përditësohet për pjesën tjetër të anëtarëve që kanë mbetur dhe në varësi të votimit tonë varet shumë dita e votimit të komisionit tjetër.

Duke ju falënderuar shumë për durimin, pavarësisht diskutimeve dhe debateve që kemi bërë, ka qenë një periudhë e ngjeshur, e lodhshme dhe e gjatë dita e sotme dhe unë ju kam mirëkuptuar të gjithëve.

Ju falënderoj shumë, falënderoj edhe përfaqësuesit e medias, edhe gazetarët, edhe vëzhguesit nga koalicioni “Drejtësi për të gjithë”, nga misionet e tjera që janë të pranishme, nga OMN-ja, nga USAID-i edhe ju kolegë.

Faleminderit, ju këshilltarëve për të gjithë punën që keni bërë!

Urdhëroni, zoti Halimi!

Eduard Halimi – Ishte një ditë e gjatë dhe e ngjeshur. Të gjithë u munduam që të spikatnim kandidatë të vlefshëm, që do të votohen ditët në vijim, sapo të jetë gati edhe pjesa logjistike e Kuvendit. Ajo që biem dakord si para mbledhjes, pa i dëgjuar kandidatët, po aq më shumë pas mbledhjes, vihet re që për arsye edhe të konfliktit politik të muajve të fundit cilësia e kandidatëve lë për të dëshiruar. Besoj se të gjithë do ta kemi të vështirë për të zgjedhur kandidatë profesionistë, njerëz me karrierë të pastër dhe me integritet profesional, por edhe të paanatemuar politikisht nuk ishte mirë që për kandidatët, të cilët dihet qëndrimi i opozitës, juve të kishit bërë debate, se u konfliktuam pa arsye për kandidatë të tillë, jo sot që kandiduan në këto poste, edhe para 4 vjetësh, pra nuk përbën ndonjë risi qëndrimi i opozitës ndaj disa eksponentëve të drejtësisë, që kanë pasur detyra më parë. Pjesa tjetër do të jetë një proces me të vërtetë i vështirë dhe mirë është që u la kohë për të reflektuar në mënyrë që të shohin dhe të gjejnë nëse kemi mundësi që t’i japin votim dhe qytetarët nesër të thonë se gjetët vërtetë njerëz të cilët do të bëjnë kalimin në karantinë të gjyqtarëve të Shkallës së Parë, gjyqtarëve të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të asaj Kushtetuese. Pra, mendoni që pritshmëritë nga qytetarët janë shumë të mëdha, seancat ishin *live*, i dëgjuat vetë, pjesa më e madhe ishin juristë nëpër institucione publike, juristë nëpër detyra shumë sekondare të së

drejtës. Për mua që e njoh sistemin, për Vasilikën që ka qenë profesore dhe për të gjithë të tjerët do të jetë një proces, besoj, i vështirë për të gjetur kandidatët dhe shpresojmë që të dalim tej qendrimeve politike ndaj kandidatëve të anatemuar dhe këtë e kam shumë të sinqertë, prandaj ende pa ardhur lista e 34 personave, jua thashë se nëse ju mendoni që ndonjë nga kandidatët ka afilacion apo keni kundërshti se ky ndoshta afrohet me PD-në, më mirë thuajeni publikisht që edhe ne të reflektojmë dhe t'u themi qytetarëve që ne nuk e votuam këtë për afilacion politik.

Votimi do të jetë pa debat, por kur të dalë mirë është që si ju edhe ne të jemi aty dhe të themi se zgjodhëm 7 anëtarë, të cilët kanë besimin publik. Asnjëri nuk është i anatemuar as nga forcat politike, se kështu është i ndarë edhe opinionimi publik.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Ju uroj një ditë të mbarë!

MBLEDHJA MBYLLET